

I pranueshëm
njëri nga
propozimet
e Nimicit

Fq.3



SHKENCA
VS POLITIKA
"Ilinditase", term
i pakuptimtë në
gjuhën shqipe

Fq.4



Festë e madhe
në Tetovë,
Shkupi drejt Evropës

Fq.19



Koha

www.koha.mk

KOHA për
kulturë

Fq.13-15



E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3371 · E martë, 22 maj 2018

13°C | 24°C

15 DEN

EDITORIAL

Politika
në kurthet
e mosdijes
shkencore



Kur politika i shkel rregullat e gramatikës, kësaj të fundit s'i mbetet gjë tjetër pos të kërkoj azil diku larg ku jetohej pa rregulla gjuhësore. Po bëhen disa ditë që ekspertë të fushës së gjuhësisë po mundohen të bindin politikanët që të tregohen pak më modest në njohuritë e tyre linguistike dhe të heqin dorë nga eksperimentet e tyre politiko-gjuhësore. Mirëpo, politikanët jo vetëm që nuk po tregohen...

Fq.2

AKTUALE

"Master plani"
vetëm në letër

Fq.9

GLOBI

Kina blen
Europën

Fq.17

FORUM

E panjohura
"X"!

Fq.10



MISTERET E LIQENIT TË SMILKOVËS

PSE HESHTIN PRINDËRIT E TË VRARËRËVE?



Përmendja e shpeshtë e ish kryeparlamentarit Trajko Veljanovski, si një prej politikanëve që ka njohuri për vrasjen në Liqenin e Smilkovës, deri më sot fare nuk është hetuar nga organet e drejtësisë. Përveç Veljanovskit, si politikan tjetër i cili mendohet se posedon të dhëna për këtë rast vite me radhe përmende edhe ish-ministri i Transportit, Mile Janakievski. Vrasja e pesë të rinjve maqedonas, po ashtu është përfolur se ka pasur lidhje me aksionin policor "Detonator" i realizuar disa javë para 12 prillit të vitit 2012

Fq.5

Paga me oscilime të mëdha

Shkup, 21 maj - Paga mujore neto më e ulët e nëpunësve administrativ shtetëror në Maqedonisë është 13.148 denarë, kurse paga më të lartë neto marrin sekretarët shtetëror në vlerë prej 53.464 denarë. Kështu rezultojnë analiza e fundit e përgatitur në kuadër të projektit "Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë", financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me përkrahje të Ambasadës Britanike në

Shkup. "Rrogë më të ulët bruto marrin nëpunësit administrativë shtetëror në Sekretariatit për implementim të marrëveshjes së Ohrit në vlerë prej 18.174 denarë, ndërsa rrogë më të lartë bruto deri më 90.215, marrin të punësuarit në trupat rregullator të Republikës së Maqedonisë", thuhet në analizën "Lëvizja e pagave të disa institucioneve në administratën publike në Maqedoni" përgatitur...

Fq.6



EDITORIAL

POLITIKA NË KURTHET E MOSDIJES SHKENCORE



Emin AZEMI

Kur politika i shkel rregullat e gramatikës, kësaj të fundit s'i mbetet gjë tjetër pos të kërkoj azil diku larg ku jetohej pa rregulla gjuhësore. Po bëhen disa ditë që ekspertë të fushës së gjuhësisë po mundohen të bindin politikanët që të tregohen pak më modest në njohuritë e tyre lingvistike dhe të heqin dorë nga eksperimentet e tyre politiko-gjuhësore. Mirëpo, politikanët jo vetëm që nuk po tregohen modest në (pa)dituritë e tyre, por ata po mundohen të thonë se krejt ky kundërshtim shkencor po bëhet disi për inati.

Në fazat parapërgatitore të negociatave me Greqinë, rreth emrit të shtetit, kryeministri Zaev, siç bëjnë të ditur nga Qeveria, ka konsultuar njohës të fushave të ndryshme në Akademinë e Shkencave, ambasadorë, përfaqësues të diasporës dhe shoqata të ndryshme qytetare.

Kur jemi te Zaevi të citojmë edhe një deklaratë të tij të dhënë dje, pas interesimit të gazetarëve rreth problemeve të përkthimit të emrit të ri në gjuhën shqipe.

"Unë nuk do të jepja koment, dua t'i dëgjoj ekspertet... ata ta tregojnë si duhet të jetë dhe ashtu do të jetë", tha Zaev pasi doli nga seanca gjyqësore e rastit "Ryshfet".

Çka të thonë tani ekspertët dhe a është vonë për mendimet e tyre? Nëse kryeministri Zaev në fazën parapërgatitore të negociatave ka konsultuar ekspertë të ndryshëm, shtrohet një pyetje e logjikshme se kënd kanë konsultuar politikanët shqiptarë para se të vendosin për variantin "Ilinditase", një konstrukt ky i çoroditur, jo vetëm gramatikor, por edhe semantik. Por, edhe nëse kanë konsultuar ndonjë individë shqiptarë jashtë Maqedonisë, shihet se ai nuk e njeh natyrën e gjuhëve sllave, për arsye se gabimisht e ka veçuar rrënjën e fjalës Ilinden, duke vënë theksin te ILIN, që shqip i bie i/e Ilisë. Ai shqiptari jashtë Maqedonisë ja ka fut kot kur ka dhënë "ekspertizë" gjuhësore për fjalën e çuditshme "Ilinditase", që është asgjë tjetër pos një përkthim mekanik gjysmak i Ilindenit, duke e ndarë atë në ILIN - DITA.

Vetëmjaftueshmëria për t'u marrë me gramatikë në kohë të lirë, e deligjitimon edhe vetë qasjen politike ndaj këtij problemi mjaft problematik, siç është çështja e emrit të shtetit.

Ata që marrin përgjegjësi për të dëbuar shkencën nga politika, po japin një mesazh dekurajues për të gjithë njerëzit vullnetmirë, të cilët mund të jenë krah i fuqishëm i proceseve të cilat nuk janë thjeshtë politike, por edhe kulturore, shkencore, identitare etj. Mospërfillja e mendimit shkencor për një çështje kaq të rëndësishme, siç është çështja e emrit të shtetit, nuk është thjeshtë mungesë sensi, por edhe qasje joserioze në tryezën e negociatave, ku politika do të dukej shumë e varfër sikur të mos bashkëshoqërohej me njohuritë përcjellëse nga fusha përkatëse.

Ky mosbashkëpunim i politikës me mendimin shkencor mund të jetë edhe pasojë e një inercioni antiarsimor që ka prodhuar vetë politika, teksa në qarkullim kemi një mori antivlerash të stolisur me tituj të pamërituar akademikë. S'do mend se në një atmosferë të tillë refuzuese kulturore-arsimore, politika mund të ndjehet disi më komod që të zëvendësojë edhe mendimin kompetent shkencor, prandaj edhe këtyre ditëve na ra të dëgjojmë e lexojmë lloj-lloj arsytimesh amatore për një problem shumë të thjeshtë gjuhësor.

Kurthet e mosdijes shkencore mund të jenë të ndryshme, mirëpo kur ato mbërthejnë politikën, atëherë duhet ndërmarrë diçka që pasojat të mos jenë më të rënda. Në moralin e një politike të qytetëruar do të ishte që të dilet me një sqarim në formë ndjese, me çka do të dëshmohej se të gabosh është njerëzore, kurse rrugët e sigurta rrahen vetëm atëherë kur njihen paraprakisht.

FAIK KONICA DHE REPUBLIKA ILINDITASE

"Letra e Faik Konicës për ata që dëshirojnë ta zgjidhin çështjen e emrit:

I dashur mik,
Në bësh emrin me "Ilinden", shqiptarët do të thonë se nuk është përkthyer në shqip; në e bësh "Ilinditas", do të thonë se s'është përkthyer si duhet, është tallje; në e shtypsh me letra të holla do të thonë se s'këndohen dhe prishen sytë; në e shtypsh me letra të trasha, do të thonë se je "hamall" e kërkon të mbushësh vende.

Në shkroftosh toskërisht, do të thonë se s'është emër për gjithë shqiptarët; në shkroftosh gegërisht, prapë ashtu; në shkroftosh një gjuhë të përzierë me të dyja, do të thonë se s'di shqip; në shkroftosh gjysëm gegërisht, gjysëm toskërisht, do të thonë se është "çervish".

Aq për sot, se kam frikë mos të zerë gjumi. (Faik Konica, 1901)", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Xhelal Neziri.



EMRI DHE ANTI-PATRIOTËT

"Nëse ndryshimi i emrit do ti hapte perspektivat euroatlantike për Maqedoninë, rrjedhimisht me këtë mirëqenies ekonomike, demokracisë, lirive dhe të drejtave të njeriut, arsimit, shëndetësisë etj., atëherë kundërshtimi i kësaj në emër të (pseudo)nacionalizmit dhe ndonjë të "vërtete" historike nuk është gjë tjetër përpos një akt anti-patriotik. Për mua kanë rëndësi vetëm perspektivat", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti dhe profesori Murat Aliu.



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË DITËS SË ILAZIT!

"Eh kafe dynja, kush e ka menduar që një ditë Maqedonia do te quhet: "MAQEDONIA E DITËS SË ILAZIT!"

Emni i ILJAZ apo ILAZ përmendet ne dy sure te Kuranit, fjala është për profetin ILAZ (إِلْيَاز), i cili ne Bibel ka emrin ELIJAH ose ILIA (إِلْيَاز). Profeti biblik ILAZ te cilin popujt sllavoortodoks e quajne ILIA, ka jetuar ne fillim te sh. 9 dhe ka vdekur ne v. 852 para Krishtit! Mu kujtua një ILAZ që e kem pas kojshi, tash po me kujtohet qe shkiet e thërrisnin ILIA, e ne fëmijët e lagjes atëherë mendonim qe ILAZIN e thërrisnin ILIA, nga që ky nuk agjëronte Ramazanin dhe e hante burekun me mish derri! Nuk di, vërtetë keq janë përzier gjerat, janë bërë si puna e Sallatës Maqedone (Salade Macédoine)!

Nejse, sa i përket ILAZIT demek ILIJËS po m'duket arrita disi t'i ftilloj fajlat e trurit, por tash hiq s'po di si ta shpjegoj këtë përkthimin "REPUBLIKA ILINDENASE E MAQEDONISË"! A di kush me m'ftillu kush mund t'jenë këta ILINDENASIT?", ka shkruar inxhinieri dhe veprimtari i çështjes kombëtare Ahmet Asani në profilin e tij në Facebook.



MEDIA Citate

SHQIPTARËT E KOSOVËS E DUAN PASAPORTËN E SERBISË

Shqiptarët e Kosovës çdo ditë po vijnë në komunën tonë me kërkesë për nxjerrje të certifikatës për shtetësi të Serbisë e cila është e domosdoshme për marrjen e letërnjoftimit serb, përkatësisht të pasaportës, ka konfirmuar për gazetën e Beogradit "Novosti" Lubinko Karaxhiq, të cilin ky medium e prezanton si kryetar të "organit të përkohshëm të qytetit të Prishtinës me seli në Graçanicë". Karaxhiq thekson se për dokumente serbe vijnë shqiptarë të moshave të ndryshme dhe me profil të arsimuar e në Graçanicë vijnë banorë kryesisht të rajonit të Prishtinës. Për dokumente serbe kosovarët gjithnjë e më shpesh po shkojnë edhe në Novobërdë. Pos kosovarëve që kanë dokumente serbe e që shkojnë për t'i vazhduar ato, ka mjaft shqiptarë të cilët për herë të parë vijnë me këtë kërkesë, thotë Karaxhiq. Mediumi serb shton se me këto pasaporta shqiptarët mund të udhëtojnë në shtetet europiane që s'e kanë njohur Kosovën si Greqia e Spanja, ndërsa për të udhëtuar në vendet tjera, ata duhet të pajisen me vizë.

(Blic, 21 maj)

DUZYTAN E PRANON PUBLIKISHT SE ËSHTË SHQIPTAR

Duket e pabesueshme, por është e vërtetë. Aktori i njohuri serialit shumë të ndjekur në vend "Ertugrul" ka gëzuar të gjithë shqiptarët me pohimin e tij. Aktori kryesor i këtij seriali, Engin Altan Duzyatan, ka deklaruar se është me origjinë shqiptare. 36-vjeçari është aktor dhe prezantues shumë i njohur në Turqi, por që u bë shumë i famshëm edhe në Shqipëri, e shumë vende të tjera, për rolin e tij kryesor në "Ertugrul". Ai ka deklaruar për mediat turke se ka lidhje me Shqipërinë, pasi origjina e tij është shqiptare. Seriali "Ertugrul" flet për historinë e njeriut që përcaktoi fatin e botës "Ertugrul", djali i Sulejman Shahut dhe babai i Osmanit të I-rë që themeloi Perandorinë Osmane.

(Koha Ditore, 21 maj)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË ISHIN LIDHJET E MËSUESVE?

Lidhjet e mësuesve (1921-1924) ishin organizata profesionale të mësuesve të krijuara për mbrojtjen e interesave të tyre dhe për zhvillimin e laicizimit e arsimit kombëtar.

Lidhja e parë u formua në Gjirokastër me nismën e Avni Rustemit. Më pas, të tilla u ngritën në disa qendra kryesore të vendit dhe kishin shtrirje të kufizuara lokale sipas

prefekturave. Lidhjet e mësuesve botuan edhe programet e tyre. Kongresi Arsimor i mbajtur në Tiranë, me nismën e mësuesve, nga 12-21 gusht 1924, themeloi "Lidhjen e Përgjithshme të Arsimitarëve të Shqipërisë".

U botua edhe statuti i Lidhjes me 40 nene. Lidhja luftonte për zhvillimin e arsimit mbi parimet kombëtare e demokratike.

Se propozimi "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është definitivisht i papranueshëm për palën greke, është theksuar të hënën edhe nga ministri pa resor i Greqisë, njëherësh zëdhënës i Qeverisë, Dhimitros Xanakopulos. Ai ka thënë se pala greke insiston në njërin nga propozimet të cilat i parashtroi ndërmjetësuesi Methju Nimic

NEGOCIATAT E REJA PËR EMRIN BARTEN NË NJU JORK

I PRANUESHËM NJËRI NGA PROPOZIMET E NIMICIT



tiv për të dy shtetet. Shumë është me rëndësi ardhmëria që ta lëmë hapësirën e alternativës së mbyllur dhe të errët. Duhet fuqimisht t'i kundërshtohemi ndarjeve, populizmit, izolimit, mentalitetit se të gjithë i kemi armi. Shumë është me rëndësi që qytetarët ta kenë e qartë se zgjedhja nuk është mes opsionit të majtë dhe të djathtë politik, por mes shoqërisë së hapur dhe të mbyllur", tha kryeministri Zaev, duke ia uruar njëherësh jubileun 25-vjeçar FSHHM-së.

DIMITROV: NUK SHOH PROPOZIM MË ADEKUAT SE REPUBLIKA ILINDITASE E MAQEDONISË

Shefi i diplomacisë, Nikolla Dimitrov tha se nuk sheh propozim më adekuat për zgjidhje të kontestit se Republika Ilinditase e Maqedonisë. "Për momentin nuk shoh ndonjë propozim më të përshtatshëm rreth të cilit edhe të dy palët negociuese kanë rënë dakord për zgjidhje të çështjes së emrit", tha Dimitrov në emisionin "Shtyp i javës në 1TV". Theksoi se Ilinden ka në dy preambulat të Kushtetutës dhe se ato janë dy shtyllat e shtetësisë sonë. "Vështirë është të jesh për Maqedoninë, e të mos jesh për Maqedoni Ilinditase", tha Dimitrov. Shefi i diplomacisë, gjithashtu, tha se ai do ta konsiderojë veten përgjegjës nëse dështon procesi i negociatave për zgjidhje të problemit me emrin me Greqinë. "Menjëherë do të nënshkruajë dorëheqje, nëse mendoj se kjo do t'i ndihmojë Maqedonisë dhe nëse do të jetë më e mirë pa mua, nëse procesi do të ishte më i mirë pa mua. Çështja e përgjegjësisë sime personale është a ka pasur ndonjë gjë që mund të bëja, e nuk kam bërë dhe a kam bërë ndonjë gjë që nuk ndihmoi. Edhe pa përgjegjësi, nëse ka efekt që dorëheqja ima të ndihmojë, absolutisht jam i gatshëm në çdo kohë të tërhiqem", tha Dimitrov në pyetjen "ku e sheh përgjegjësinë e tij nëse nuk arrin sukses procesi negociues". Ai shtoi se në pakon për emrin, grekët pajtohen se njohin kombin maqedonas, ndërsa gjuha me këtë propozim duhet të jetë maqedonishte, me përkthim në të gjitha gjuhët, me çrast nuk kërcënohet identiteti maqedonas. Ndryshe, ditw mw parw edhe kryeministri grek, Alexis Tsipras u distancau nga propozimi "Maqedonia e Ilindenit", pasi ky emër ishte kundërshtuar nga të gjitha partitë në Greqi, me arsyetimin se paraqet vazhdimësi të tendencave irredentiste të Maqedonisë.

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 21 maj - Pas refuzimit që i bëri Greqia propozimit "Republika e Maqedonisë së Ilindenit", si opsion për zgjidhjen e kontestit të emrit, më 24 dhe 25 maj në Njork do të zhvillohen bisedime të reja mes ministrave të Punëve të Jashtme të dy vendeve, Nikos Kotzias dhe Nikolla Dimitrov, në prani të ndërmjetësimit të OKB-së, Mattheë Nimetz. Lajmin e ka bërë të ditura Ministria e Jashtme në Shkup ndërsa paraprakisht një gjë e tillë ishte kumtuar edhe nga pala greke, e të cilin e kishte kumtuar gazeta "To Vima". "Ky takim është i një rëndësie të veçantë për rrjedhën e bisedimeve. Ndoshta edhe shansi i fundit për përparimin pas dështimit të emrit 'Maqedonia e Ilindenit' dhe kthimin në tryezë të pesë emrave fillestar që ishin paraqitur nga ndërmjetësi Nimetz. Gjithsesi, si variante të mundshme mbeten emrat 'Maqedonia e Re' dhe 'Maqedonia e Epërme', dhe me siguri se bisedimet do të zhvillohet rreth këtyre skenarëve të mundshme", ka shkruar gazeta greke.

Se propozimi "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është definitivisht i papranueshëm për palën greke, është theksuar edhe të hënën nga ministri pa resor i Greqisë, njëherësh zëdhënës i Qeverisë, Dhimitros Xanakopulos. Në një konferencë për gazetarët grek, Xanakopulos ka thënë se pala greke insiston në atë se zgjidhje më e mirë është një emër nga propozimet, të cilat i parashtroi ndërmjetësuesi Methju Nimic në propozimet e tij. Ai e përshëndeti pranimin e "erga omnes", duke e theksuar si rezolutë pozitive dhe hap pozitiv nga takimi i dy kryeministrave.

"Sa i përket emrit, nuk kemi arritur deri atje. Gjithsesi ekzistojnë propozime të cilat janë vendosur në tavolinë por, megjithatë, pala greke insiston në atë se zgjidhje më e mirë është zgjedhja e një emri prej atyre që i ka parashtuar ndërmjetësuesi Nimic në propozimet e tij. Por, nuk kemi arritur deri atje, duhet të kalohet ende rrugë që të mund të bisedojmë për zgjidhje përfundimtare", thotë Xanakopulos, ndërsa shtoi se gjithsesi se bisedohet edhe për "propozi-

EMRAT PËR MINISTRAT E RINJ SOT DORËZOHEN NË PARLAMENT

Kryeministri Zoran Zaev paralajmëroi se sot (e martë) deri te Parlamenti do t'i parashtrojë emrat e rinj për rikonstruimin e Qeverisë.

"Rikonstruimin do ta propozoj nesër, pasi për shkak të aktgjykimit të sotëm nuk dija nëse do të ketë qeveri të tërë. Jam i gatshëm. Emrat janë konfirmuar dhe biografite e



ministrave dhe zëvendës ministrave në mëngjes do të procesohen deri te Kuvendi, me shpresë që deri nga fundi i muajit do të vendosen në rend të ditës në seancë plenare që të kompletohet Qeveria", tha Zaevi, duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve sot para Gjykatës penale.

met e fqinjëve tanë, por megjithatë, negociatat funksionojnë në një koronizë konkrete dhe është mirë të jemi në atë vijë".

"Ne e përshëndesim pranimin e 'erga omnes' nga fqinjët, me përgjegjësi i vazhdojmë negociatat, diçka që nuk shoh që e ndanë dhe e bënë opozita dhe flas për opozitën pothuajë në përgjithësi", tha zëdhënësi i Qeverisë greke dhe ministër pa resor, duke drejtuar kritike deri te Demokracia e Re se nuk ka disponim të funksionojë në mënyrë konstruktive.

ZAEV: ZGJIDHJA E EMRIT PATJETËR DUHET TË REALIZOHET

Nuk ka pasur moment më të mirë të flas për shoqëri të hapur sesa ai aktual i realitetit tonë politik-shoqëror. Këto ditë jemi të ballafaquar para hapave vendim-marrëse që ta zgjedhim kontestin 25-vjeçar për emrin. Po ballafaqohemi me këtë sfidë që Maqedonia dhe qytetarët të shkojnë përpara. Me qytetarët e vendit tonë

projektua se viti 2018 do të jetë vit i reformave të fuqishme dhe se Maqedoninë e dërgojmë në BE, e me këtë Evropën e sjellim në Maqedoni", tha kryeministri Zoran Zaev në fjalimin e tij në konferencën me rastin e 25 vjetorit Fondacioni i Shoqërisë së hapur Maqedoni, e quajtur "A ka gjasa shoqëria e hapur në Maqedoni". Ai theksoi se me energjinë kushtuar çështjeve të hapura me fqinjët, me nënshkrimin e Marrëveshjes me Bullgarinë dhe me thellimin e relacioneve me Greqinë e kemi ndryshuar perceptimin për Republikën e Maqedonisë. Me miqësinë mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, të cilën përkundër të gjitha këtyre pritjeve e ndërtuam gjatë këtij procesi delikat dhe të ndjeshëm, po zgjidhim kontest që ta përforcojmë dinjitetin dhe identitetin e qytetarëve të të dyja vendeve. "Rajoni nuk guxon t'i lejojë vetes cikël të ri të kthimit prapa. Për këtë shkak të ky tentim i përbashkët i Maqedonisë dhe Greqisë për zgjidhjen e konte-

stit 25-vjeçar duhet të realizohet. Kjo është luftë në të cilën në themet e së kaluarës do të ndërtojmë të ardhme me prosperitet. Jemi të vetëdijshëm se bota me kujdes e ndjek këtë iniciativë tonë të përbashkët. Jam falënderues për përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, gjithë miqve tanë që japin angazhim personal që të realizohet kjo mundësi historike për shtetet tona, për rajonin dhe për Evropën", tha kryeministri Zaev. Sipas tij, shoqëria e hapur ka mundësi në Maqedoni dhe të gjithë ne duhet fuqishëm të përpiqemi dhe ta shfrytëzojmë. "Në këtë frymë Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të vazhdojë me përkushtimin maksimal dhe të përqendruar deri në gjetjen e zgjidhjes definitive të kontestit 25-vjeçar. Asnjëherë nuk kemi qenë më afër zgjidhjes, ndërsa miqësia mes dy vendeve dhe dy popujve asnjëherë nuk ka qenë më e madhe. Do t'i investojmë të gjitha përpjekjet që të nxjerrim maksimum nga ky moment historik pozi-

REFORMAT NË ARSIM DO T'I VAZHDOJË MINISTRI I RI

Pa marrë parasysh se kush do të jetë ministër i Arsimit dhe Shkencës, ai do të jetë i obliguar dhe mendoj se do të ketë vullnetin për të zbatuar reformat që i kemi projektuar. Këtë dje e tha ministrja e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, në



promovimin e djeshëm të Strategjisë së Arsimit 2018-2025. E pyetur se si i komenton spekulimet për transferimin e saj në Ministrinë e Drejtësisë, Deskoska tha se "mendoj se është shumë e intensifikuar sa që nuk është në nivelin e spekulimeve sot".

Cjuhëtarët shpjegojnë se ky përkthim tekstual dhe jo i menduar mirë bënë ndesh me normat gramatikore të gjuhës shqipe. Fjala Ilinditase nuk shpreh asgjë, sepse është e përkthyer vetëm fjala ditë, por nuk e ka kuptimin e njëjtë me atë në maqedonisht...

Koha

Evis HALILI

Shkup, 21 maj - Propozimi për emrin e ri të shtetit që erdhi në variantin zyrtar shqip "Republika Ilinditase e Maqedonisë", ka shkakuar jo pak reagime në botën akademike e shkencore shqiptare. Kontestimi i këtij formulimi gjuhësor mëton të jep argument shkencore, ndërkohë që politika zyrtare institon në pandryshueshmërinë e këtij variant.

Sipas zëvendëskryeministri për Çështje Evropiane dhe njëherit edhe zëdhënës i Bashkimi Demokratik për Integritet, Bujar Osmani, partia e tij nuk ka qenë përkthyes në procesin negociues, por negociator, dhe ka sqaruar se emri i ri dhe ai përkthim, fonetiki, gramatiki dhe politikisht, janë preciz dhe korrekt.

"Kam përshtypje se reagimet e atyre që janë shqetësuar se versioni shqip i propozim emrit nuk qenka përkthim preciz i versionit në maqedonisht, janë reflektime të një mentaliteti të tejkaluar dhe anakronik, se gjithçka zyrtare në këtë vend është maqedonisht, kurse gjithçka shqipe duhet të jetë përkthim. Në nuk kemi qenë përkthyes në proces, por negociues, dhe kemi vlerësuar se ky emër, dhe formulim i ri reflekton më së miri përpjekjen e përbashkët maqedonoshqiptare për shtet multietnik, të anëtarësuar në NATO dhe BE, dhe si i tillë është fonetiki, gramatiki dhe politikisht preciz dhe korrekt", shkruan Osmani në një statusi të tij në Facebook.

Mirëpo se sa serioz është ky përkthim, flasin vetë ekspertët e njohur të lingistikës, të cilët njëzërit e hudhin poshtë variantin "Republika Ilinditase...", si një konstrukt semantik e gramatikor që nuk i shkon natyrës së gjuhës shqipe.

PËRKTHIM NË SHQIP NUK PËRKON ME FORMËN NË MAQEDONISHT

Pedagogia universitare, dr. Ajtene Qamili është e mendimit se ky emërtim apo përkthim në shqip nuk përkon me formën në maqedonisht edhe për shkak të topikës së përcaktimit, edhe për shkak të kuptimit semantik, sepse nëse nisemi në analogji me format e tjera të ditëve të shënuara si: - = Dita e Shën. Pjetrit, - = Dita e Shën. Mitrit, - = Dita e Shën. Spasit, - = Dita e Shën. Pavlit, - = Dita e Shën. Gjergjit; edhe emërtimi - - do të duhet të

SHKENCA KUNDËRSHTON POLITIKËN

"ILINDITASE", TERM I PAKUPTIMTË NË GJUHËN SHQIPE



përkthehet me = Dita e Shën. Ilos ose = Dita e Shën. Iliës ose alternativa tjera që dalin nga lashtësia e këtij emërtimi kemi edhe formën Dita Ilire, nënvizon Qamili, dhe sqaron se emri i shtetit tonë do të duhet të ishte: Republika e Maqedonisë së Ilindenit, ose Republika e Maqedonisë së Ditës së Shën. Ilos, ose Republika e Maqedonisë së Ditës së Shën. Iliës ose Republika e Maqedonisë së Ditës Ilire.

"Republika Ilinditase e Maqedonisë, së pari edhe në aspekt të përcaktimit që shpreh përkatësi, e cila në maqedonisht shprehet me (nga:) në maqedonisht dhe në anglisht qëndron para emrit, kurse në shqip përcaktori që shpreh përkatësi vendoset pas dhe në rastin konkret shprehet me rasën gjinore (e Ditës së Shën. Ilës, ose e Ditës Ilire, ose e Ilindenit), por edhe në aspekt të kuptimit, fjala Ilinditase nuk shpreh asgjë, sepse është e përkthyer vetëm fjala ditë nga , por nuk e ka kuptimin e njëjtë me atë në maqedonisht, ndërkaq të shprehurit të përkatësisë duhet të ndjekë këtë radhitje: 1. Republika 2. e Maqedonisë 3. së Ditës së Shën. Ilës, ose së Ditës Ilire ose së Ilindenit. Për këtë arsye, bëj thirrje që para se të miratohet ky emërtim, të shqyrtohen sugjerimet e lartpërmendura", nënvizon dr. Ajtene Qamili.

LEKSEMA 'ILINDITASE' ËSHTË TËRËSISHT E DESEMANTIZUAR

Edhe profesori universitar dhe një prej njohësve më të mire të gjuhësisë krahasimtare, dr. Arbër Çeliku spekon se sa i përket përkthimit në shqip si "Maqedonia ilindenase" (në versionin e parë) dhe "Maqedonia ilinditase" (versioni i dytë), duke i vënë në një marrëdhënie sinonimie mbiemrat ilindenase dhe ilinditase, mbase nga jokom-

petenca apo në mënyrë të pararenduar, s'do mend se këto leksema nuk kanë asnjë lidhje midis tyre as në rrafshin sintagmatik dhe as në atë paradigmatic. Ato nuk mund të quhen as sinonime dhe as antonime, madje leksema 'ilinditase' është një sajësë allasoj, tërësisht e desmantizuar, por që të lë të kuptosh se gjenezën e ka në dy vargjet e para të himnit maqedonas "

[...]", pra, në diskursin e ri të trasuar politik unë e kuptoj si: "lind një ditë e re" (mbase qytetare a shumëmetrike), kuptohet, me një përdorim të izoluar dhe populist vetëm ndër ne shqiptarët, sepse në përdorimin ndërkombëtar do të ishte për mrekulli: "Republic of Ilinden Macedonia", saktëson dr. Çeliku, duke shtuar se në gjuhën shqipe, në raste të emërtimeve të tilla, mbiemri maqedonas 'ilindenska', nëse përkthehet me po të njëjtin mbiemër 'ilindenase', nuk është asgjë tjetër, pos një përkthim kalk. Është njëjtë sikur "Betejën e Koshares" ta riformuloni në "Beteja Kosharase", apo "Betejën e Kosovës" në "Beteja Kosovarase", etj., pra ky emërtim në shqipe do të ishte: "Republika e Maqedonisë së Ilindenit", pra jo me mbiemër si në maqedonisht, por me një emër në gjinore, që ka funksionin sintaksor të përcaktimit, dmth. jep informacione shitesë për frazën emërore. Megjithatë, në diskursin politik gjithçka është e qëlluar dhe e pranueshme, përdorisht duartrokitet nga një numër i madh i spektatorëve shurdhmemecë.

SHQIP DO TË DUHEJ TË JETË DITA E ILISË DHE JO ILINDITASE

Profesori Vebi Bexheti duke elaboruar mënyrën se si duhet përkthyer propozimi i ri i emrit, shpjegon se ky version i tangon sh-

qiptarët në disa komponentë.

"Mendoj se nuk shkon dhe nuk i përshtatet natyrës së gjuhës shqipe Ilinditase sepse bëhet fjalë për një shenj që është Ilija. Nëse në gjuhën shqipe përkthehet sipas normave gjuhësore do të ishte dita e Ilisë dhe jo Ilinditase. Ky defekt i përpjekjes për të na imponuar një emër bazohet në tre komponentë. Njëri është gramatikor që e shpjegova, tjetri historik dhe ideologjik që nuk është në favor të shqiptarëve dhe i treti në aspektin fetar. Nëse i kthehem historisë dhe i shohim të gjitha ngjarjet që kanë të bëjnë me termin Ilinden neve si shqiptar nuk e shohim askund veten aty", thotë profesori Vebi Bexheti.

Ndërkaq profesori tjetër universitar, prof.dr. Fatmir Sulejmani shpjegon se në fjalorin e gjuhës shqipe nuk ekziston termi Ilinditase. Sipas tij, ky nuk është vetëm dëshitim i klasës politike shqiptare por edhe i asaj intelektuale.

"Edhe unë si gjithë shqiptarët e dëgjova për herë të parë këtë term. Natyrisht mu duk interesant, një përkthim që nuk ka domethënie të rëndësishme për ne. Siç e dimë, të paktën në të gjitha dokumentet historike Ilindenit i kemi thënë Ilinden dhe nuk e kemi përkthyer Ilindita. Duket pak interesant dhe jo adekuat. Mua absolutisht nuk më pëlqen kjo. Do të duhet të ishte një emër që reflekton muti etnik, multi konfesional dhe multi kulturor - thotë profesori Fatmir Sulejmani.

PËRKTHIM JO ADEKUAT "REPUBLIKA ILINDITASE E MAQEDONISË"

"Republika Ilinditase e Maqedonisë" nuk është përkthim adekuat bazuar në rregullat e gjuhës shqipe, sepse emrat dhe toponimet në gjuhën shqipe nuk përkthehen në

pjesën e tyre përbërëse, vlerëson gjuhëtari prof.dr. Asllan Hamiti.

Ai sqaron se gjatë përkthimit, duhet pasur kujdes sidomos në sistemin rasor, prandaj në këtë sintagmë emërore duhet të shkojë me emra të përcaktuar në rasi të duhura, përkatësisht në rastin konkret Republika e Maqedonisë së Ilindenit, që emri republikë të jetë në rasën emërore në trajtën e shquar, ndërsa e Maqedonisë së Ilindenit të jetë në rasën gjinore.

"Lidhur me propozim e ri për emrin e Maqedonisë në versionin e përkthyer shqip po qarkullojnë sintagma të ndryshme emërore, ndër to më të shpeshta: Republika Ilindenase e Maqedonisë, Republika Maqedonia e Ilindenit derisa edhe një përkthim tjetër edhe më i keq, Republika Ilinditase e Maqedonisë. Ritheksojmë se ky propozim duhet shqyrtuar me kujdes, maturi e përgjegjësi historike, ndërsa nga pikëpamja gjuhësore në natyrën e shqipes është të thuhet: Republika e Maqedonisë së Ilindenit ose shkurtimisht Maqedonia e Ilindenit. Emri Ilinden në funksion të përcaktimit në maqedonisht që i bie, "Ilindenska" nuk përkthehet në pjesët përbërëse në Ilija me Ilij, pastaj me "den", "ditë" edhe një prapashetë "enska" me "ase" për arsye se emrat dhe toponimet nuk përkthehen në pjesën e tyre përbërëse", prof.dr. Asllan Hamiti dhe sqaron se në çdo propozim për emrin, duhet të shikohet aspekti historik, juridik etimologjik dhe struktura gjuhësore. Sipas tij shqiptarët duhet të jenë pjesëmarrës në këtë problematikë, me qëllim që emri i ri të përfshijë autenticitetin, trashëgiminë, kulturën dhe civilizimin e shqiptarëve si popull që jeton në Maqedoni

Në vale të njëjta qëndron edhe prof. Xhelal Zejnli. Ai thotë se varianti në gjuhën maqedonase Republika Ilindenska Makedonija, në gjuhën shqipe duhet të thuhet, për të mos thënë të përkthehet vetëm si Republika e Maqedonisë së Ilindenit. Varianti maqedonas Ilindenska Makedonija, sipas tij, thuhet në shqip apo përkthehet në shqip si Maqedoni e Ilindenit. Në analogji me këtë, përdoret edhe emërtimi, shprehja apo sintagma Jugosllavia e Versajës, apo Jugosllavia e AVNOJ-it (KAÇKJ-së).

Prof. Zejnli është i qartë në konstatimin se propozimi i ri Republika Ilindenska Makedonija në shqip thuhet drejt dhe saktë vetëm si Republikë e Maqedonisë së Ilindenit.

MISTERET E LIQENIT TË SMILKOVËS

PSE HESHTIN PRINDËRIT E TË VRARËRËVE?



Përmendja e shpeshtë e ish kryeparlamentarit Trajko Veljanovski, si një prej politikanëve që ka njohuri për vrasjen në Liqenin e Smilkovës, deri më sot fare nuk është hetuar nga organet e drejtësisë. Përveç Veljanovskit, si politikan tjetër i cili mendohet se posedon të dhëna për këtë rast vite me radhe përmende edhe ish-ministri i Transportit, Mile Janakievski. Vrasja e pesë të rinjve maqedonas, po ashtu është përfolur se ka pasur lidhje me aksionin policor "Detonator" i realizuar disa javë para 12 prillit të vitit 2012

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 21 maj - Në mesin e dhjetëra të arrestuarve për "Monstrën" në prill të 2012-tës ishte edhe plaka Feride Bilalli, banore e fshatit Hotël, rrethinë e Kumanovës. Akuzat për "terrorizëm" ndaj asaj fare nuk u vërtetuan. Ndërkohë dhuna psikike dhe maltretimet e përjetuara i mbetën në kujtesën e saj të përhershme. Terrori mbi familjet shqiptarë të maltretuara në javën e parë të majit të vitit 2012, kurrë nuk u hetua.

U arrestuan 20 shqiptarë, bura e gra, për të cilët ish ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankulovska, tha se një pjesë e tyre kanë luftuar kundër forcave të NATO-s, në Pakistan dhe Afganistan. Vrasja e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës e realizuar në 12 prill të 2012 dhe më pas qasja tendencioze, selektive e organeve të policisë dhe drejtësisë në Maqedoni, ka ndikuar ky rast në opinion të cilësohet si një montim klasik politik. Në kohë kur gjykimi për "Monstrën" ka filluar nga e parë, tashmë nën përfaqësimin e Prokurorisë Speciale Publike (e cila deri më tani nuk ka publikuar asgjë të re për këtë ngjarje), opinionin ende nuk e ka të qartë se pse me gjashtë vite më parë u arrestuan shumë shqiptar, në mesin e tyre edhe gra të moshuara.

PSE NUK ZBULOHEM IDENTITETIN I AGJENTIT SEKRET?

Paqartësitë dhe dilemat për motivin e vrasjes së Filipçe Slavkovskit, Aleksanda Nacevskit,

Cvetanko Acevskit, Kire Triçkovskit dhe Borçe Stefanovskit, në Liqenin e Smilkovës, në prill të 2012, ende vazhdojnë të mbeten ta pa zbërthyer. Qëndrimi i MPB-së se shqiptarët "terroristë", e kanë kryer këtë vrasje me qëllim "frikësimin e popullatës maqedone" pas gjashtë pesë viteve, në nëntor të vitit e demantoi Gjykata e Lartë e Maqedoni, e cila i shfuqizoi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë në rastin "Monstra".

Në zbardhjen e rastit dhe zbulimin e të vërtetës gjatë këtyre fare pak kanë ndihmuar edhe familjarët e viktimave, gjegjësisht prindërit e të vrarëve me ndryshimet e deklaratave, kohë pas kohë kanë hedhur më dyshime shtesë mbi porositisit dhe organizatorët e këtij krimi. Kësisoj qëndrimi i tyre fillestar ishte se prapë vrasjes së bijve të tyre qëndrojnë shkaqe kryesisht afariste. Me kalimin e viteve ndryshuan edhe deklaratat e tyre. Rasti i fundit ishte ditë më parë kur Aleksandar Naqevski, prindi i njëri prej të vrarëve në Liqenin e Smilkovës, publikisht kërkoi nga organet e drejtësisë deklasifikimin e dëshmive dhe zbulimin e identitetit të agjentit sekret, celulari i të cilit është gjetur në vendngjarje. Ai, mes tjerash tha se Fejzi Aziri, të cilët prokuroria e ngarkon si organizator, ka pasur kontakte me funksionar të BDI-së, më konkretisht me ish kreun e Gostivarit, Nevzat Bejtën. Mirëpo, kjo deklaratë aspak nuk u kontestua nga familjarët e Azirit, të cilët shuan se e drejtë demokratike e se-

cilit qytetar të Maqedonisë është të kontakti me këdo. Lidhjen e Fejziut me Bejtën ata e sqaruan si një kontakt i rëndomtë, temë e të cilit ka qenë veprimtari e blegtorit që e ka ushtruar vëllai i tyre.

"MONSTRA" A KISHTE LIDHJE ME AKSIONIN "DETONATOR"?

Rasti "Monstra" asnjëherë nuk ka humbur nga aktualiteti ditor, megjithatë spekulimet për këtë vrasje kanë qenë nga më të ndryshimet. Përmendja e shpeshtë e ish kryeparlamentari Trajko Veljanovski, si një prej politikanëve që ka njohuri për vrasjen në Liqenin e Smilkovës, deri më sot fare nuk është hetuar nga organet e drejtësisë. Përveç Veljanovskit, si politikan tjetër i cili mendohet se posedon të dhëna për këtë rast vite me radhe përmende edhe ish ministri i transportit dhe lidhjeve, Mile Janakievski. Ndryshe, vrasja e pesë të rinjve maqedonas, po ashtu është përfolur se ka pasur lidhje me aksionin policor "Detonator" i realizuar disa javë para 12 prillit të vitit 2012.

Këto dhe shumë dilema tjetra, sipas të gjitha gjasave pritet të jenë lëndë hetimi nga Prokuroria Speciale Publike, e cila nga fundi i vitit 2015 i posedon "bomba" e LSDM-së, për rastin "Monstra". Serizoteti dhe pesha e këtyre materialeve, më së mirë mund të kuptohet nga deklarata e shefit të atëhershëm të opozitës, sot kryeministrit Zoran Zaev, i cili deklaroi "publikimi i materialeve për vrasjen në Liqenin e Smilkovës do të shkaktoi trazira të mëdha në vend".

PSP PRITET T'I DEMASKOJË DËSHMITË E FABRIKUARA

Kullën me prova dhe dëshmi të fabrikuara, në seancat e radhës për "Monstrën" pritet ta demaskoi PSP-ja. Në takimet jo formale me gazetarë, prokurorët e PSP-së shpeshherë ju ikin pyetje direkte për të ardhmen e "Monstrës". Mirëpo, një gjë me siguri është e vërtet se pasi me 23 maj të akuzuarit Haki Aziri e Sami Luta ti përsërisin edhe njëherë deklaratë e tyre pra Gjykatës dhe pas prezantimit të dëshmive që PSP-ja i ka marrë nga Prokuroria për krim të organizuar, opinioni do të këtë mundësi t'i dëgjoj provat e reja të kësaj prokurorie për rastin "Monstra". Marrja e lëndës për vrasjen e pesëfishtë në Liqeni ne Smilkovës, nga PSP-ja, disa ditë pas miratimit të Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, e vërteton tezën se prokurorët special, në fazat e mëtutjeshme të këtij procesi gjyqësor pritet të prezantojnë edhe dëshmitar të koduar. Në realitet një gjë e tillë shpesh herë është theksuar nga prokurorja Janeva, e cila Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve e vlerësonte si pikënisje për hetimet e rasteve "Monstrës", "A1", "Nikolla Mlladenov" e kështu me radhë. Ndryshe, zgjerimi i aktakuzës në rastin "Monstra", gjegjësisht rikualifikimi i saj, gjithsesi, siç flitet në opinion, pritet të përfshijë edhe të akuzuar tjerë, duke mos i përjashtuar prokurorët, gjykatësit si dhe inspektorët policor që e kanë shqyrtuar nga fillimi këtë lëndë.



Zaevi shpallet i pafajshëm

Shkup, 21 maj - Gjykatësi Darko Todorovski nga Gjykata Penale në Shkup e liroi nga përgjegjësia kryeministrin Zoran Zaev, i cili ishte i akuzuar në rastin "Ryshfeti". Në leximin e aktgjykimit, gjykatësi Todorovski theksoi se prokurori publik nuk arriti të dëshmojë se i akuzuari Zaev e ka kryer veprën që i ngarkohej dhe nga këto shkaqe solli aktgjykim lirues. Në seancën e kaluar për lëndën "Ryshfeti", prokurorja Valentina Bislimovska kërkoi ndërrim të aktakuzës dhe në vend të marrjes së rryshfetit, i akuzuari të gjykohej për kërkim të rryshfetit. Prokurorja për këtë vepër penale kërkoi nga Gjykata t'i shqiptojë aktgjykim dënues, që, sipas ligjit, është prej një deri pesë vite burgim. "Jam i lumtur që u soll aktvendim për lirim dhe që përfundimisht e dëshmova pafajësinë time dhe e prita drejtësinë", deklaroi kryeministri Zaev pas publikimit të aktvendimit për lirim për lëndën "Ryshfeti". Ai theksoi se Republika e Maqedonisë mund të jetë vend normal vetëm nëse ka gjyqësi të pavarur dhe procedura transparente, siç ishte edhe procedura për lëndën "Ryshfeti". Kryeministri tha se do ta presin edhe të drejtën e ankesës për aktvendimin nga Prokuroria. Para mediave Zaev përsëriti se ka pritur aktvendimi të jetë për lirimin e tij, pasi që siç tha, në procedurën dëshmuarëse i kanë dëshmuar të gjitha gjërat, ndërsa më pas ndodhi edhe rikualifikimi i aktakuzës. Zaev kërkoi prej institucioneve të cilat e kanë që publikisht ta publikojnë incizimin e masave të posaçme hetimore dhe siç tha nëse ia dorëzojnë, ai personalisht do ta publikojë që të shihet se nuk ka kërkuar rryshfet. "Në tri vendet ku është ndërprerë incizimi saktë do të shihet se për çfarë bëhet fjalë dhe se në mënyrë të lig është bërë shkurtimi i pjesëve kur bisedojmë për çimento, beton, hekur, për pagën e punëtorëve... Më vjen mirë që Gjykata e përcaktoi të vërtetën. Gjithçka kam bërë në Strumicë ishte transparente dhe kishte qasje në opinion. Apelova biznesmenët të jenë shembull për qytetarët dhe të dhurojnë për ndërtimin e kishës", tha Zaev.

POLITIKA FINANCIARE NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

PAGA ME OSCILIME TË MËDHA

Mjete më të mëdha për paga bruto dhe neto për punonjës në nivel mujor në vitin 2016 janë rezervuar për Agjencinë për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit, nga 96.071 denarë bruto pagë mesatare për punonjës, apo 63.854 denarë neto pagë mesatare për punëtor. Shpenzimet më të ulëta mujore për bruto dhe neto pagë në vitin 2016 janë realizuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ku mesatarisht për të punësuar janë realizuar 29.347 denarë bruto, ose 20.017 denarë neto pagë



PAGAT MË TË LARTA

Mjete më të mëdha për paga bruto dhe neto për punonjës në nivel mujor në vitin 2016 janë rezervuar për Agjencinë për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit, nga 96.071 denarë bruto pagë mesatare për punonjës, apo 63.854 denarë neto pagë mesatare për punëtor, pastaj vijon Ministria e Punëve të Jashtme me 80.033 denarë bruto pagë mujore e paguar për një të punësuar ose 53.317 denarë neto pagë mesatare

mujore e paguar për punëtor, të punësuarit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, ku bruto paga mesatare mujore për punëtor është 66.019 denarë ose 44.110 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës dhe Enti Shtetëror i Statistikës me bruto pagë mesatare mujore për të punësuar prej 64.257 denarë ose 42.953 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës.

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 21 maj - Paga mujore neto më e ulët e nëpunësve administrativ shtetëror në Maqedonisë është 13.148 denarë, kurse paga më të lartë neto marrin sekretarët shtetëror në vlerë prej 53.464 denarë. Kështu rezulton analiza e fundit e përgatitur në kuadër të projektit "Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë", financiar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Shkup. "Rrogë më të ulët bruto marrin nëpunësit administrativë shtetëror në Sekretariatit për implementim të marrëveshjes së Ohrit në vlerë prej 18.174 denarë, ndërsa rrogë më të lartë bruto deri më 90.215, marrin të punësuarit në trupat rregullator të Republikës së Maqedonisë", thuhet në analizën "Lëvizja e pagave të disa institucioneve në administratën publike në Maqedoni" përgatitur nga Fondacioni Westminster për Demokraci në Maqedoni.

Kjo analizë nxjerr në pah dallimin e madh të rrogave të nëpunësve shtetëror, varësisht nga detyra që ata e ushtrojnë. "Sekretarët shtetëror apo sekretar i nivelit të parë ka bruto të ardhura mujore më të larta prej 80.256 denarë, respektivisht 53.464 denarë neto të ardhura, ndërsa, nga ana tjetër, të ardhura më të ulëta kanë punëtorët ndihmës profesional të nivelit të katërt, për të cilët kërkohet arsim i mesëm dhe të cilët kanë minimum

bruto të ardhura mujore prej 18.892 denarë, respektivisht 13.148 denarë neto", thuhet në analizë. Nga viti 2010 deri më sot mund të vërehet tendencë e rritjes së pagës mujore mesatare bruto në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social, duke filluar nga 36.800 në vitin 2010, në 41.300 në fund të vitit 2017.

"Trendi i këtillë i rritjes është më i lartë se rritja e bruto pagës mesatare mujore, e cila nga 30.255 denarë në vitin 2010 u rrit në 34.079 denarë, që do të thotë se dallimi në mes të bruto pagës mujore mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social dhe bruto paga mujore mesatare në RM nga 6.575 denarë në vitin 2010 u rrit në 7.215 denarë në nëntor të vitit 2017", thuhet në analizë.

Trend të njëjtë të rritjes se rrogës mesatare shënon edhe shuma neto, e cila nga 24.855 denarë në vitin 2010 u rrit në 27.805 denarë

në nëntor 2017, që në raport me pagën neto mesatare mujore është për 4.300 denarë më tepër krahasuar me vitin 2010, gjegjësisht për 4.609 denarë në nëntor 2017. "Gjithashtu, është me rëndësi të përmendet se numri i të punësuarve në Sektorin administratë publike dhe mbrojtje, dhe sigurim i detyrueshëm social është në rritje të vazhdueshme dhe nga 42.474 në vitin 2010, është rritur në 47.364 në vitin 2016, që paraqet rreth 15% nga të punësuarit e përgjithshëm në Republikën e Maqedonisë gjatë periudhës së analizuar", thuhet në analizën "Lëvizja e pagave të disa institucioneve në administratën publike në Maqedoni".

Sipas të dhënave në buxhetin për vitin 2016, numri i të punësuarve që janë shfrytëzues buxhetor është 50.723 persona ndërsa shuma e shpenzimeve totale për paga dhe kompensime për vitin 2016 është 25.907.403.000, denarë që do të thotë se shuma mesatare për

paga bruto dhe kompensime për të punësuar është 42.563 denarë. "Kjo do të thotë se rritja e rrogës mestare është pothuajse për 10.000 denarë më e lartë në krahasim me pagën mesatare bruto në Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, ose neto paga mesatare mujore e paguar për të gjithë shfrytëzuesit buxhetor për vitin 2016 është 28.700 denarë, që nga ana tjetër, është më e lartë për 6.360 denarë sesa paga neto mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë", thuhet mesa tjerash në analizë.

Të dhënat e analizës për shfrytëzuesit buxhetor, kanë ardhur në përfundim se mjete më të mëdha për paga bruto dhe neto për punonjës në nivel mujor në vitin 2016 janë rezervuar për Agjencinë për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit, nga 96.071 denarë bruto pagë mesatare për punonjës, apo 63.854 denarë neto pagë mesatare për punëtor, pastaj vijon Mi-

nistria e Punëve të Jashtme me 80.033 denarë bruto pagë mujore e paguar për një të punësuar ose 53.317 denarë neto pagë mesatare mujore e paguar për punëtor, të punësuarit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë, ku bruto paga mesatare mujore për punëtor është 66.019 denarë ose 44.110 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës dhe Enti Shtetëror i Statistikës me bruto pagë mesatare mujore për të punësuar prej 64.257 denarë ose 42.953 denarë neto pagë mesatare mujore për punonjës. Nga ana tjetër, shpenzimet më të ulëta mujore për bruto dhe neto pagë në vitin 2016 janë realizuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ku mesatarisht për të punësuar janë realizuar 29.347 denarë bruto, ose 20.017 denarë neto pagë, pastaj vijon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me 28.601 denarë, respektivisht me 19.527 denarë neto pagë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me 28.243 denarë bruto, respektivisht me 19.292 denarë neto pagë mesatare mujore për të punësuar dhe Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit me bruto pagë mujore më të ulët për të punësuar prej 26.542 denarë ose 18.174 denarë neto pagë mujore për të punësuar. Sa i përket shpenzimeve për paga në trupat rregullator, gjykuar sipas analizës mund të vërehet se bruto paga mesatare dhe neto pagat të të gjitha 10 institucioneve janë më të larta se bruto dhe neto pagat mujore në shtet. "Pagat mujore lëvizin nga 58.291 denarë bruto pagë mujore për të punësuar, respektivisht 39.033 denarë neto pagë mesatare për të punësuar, në Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, deri në 136.194 denarë bruto pagë mujore mesatare për të punësuar ose 90.215 denarë neto pagë mujore mesatare për të punësuar në Komisionin rregullator për banim, që është për të paktën 25.469 denarë më tepër se bruto paga mujore mesatare ose për 16.733 denarë më tepër se neto paga mujore mesatare në RM, respektivisht për 18.658 denarë më tepër se bruto paga mujore mesatare në sektorin Administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social ose për 12.258 denarë më tepër nga neto paga mujore mesatare në sektorin administratë publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social", thuhet në analizën "Lëvizja e pagave të disa institucioneve në administratën publike në Maqedoni" përgatitur nga Fondacioni Westminster për Demokraci në Maqedoni.

PAGAT MË TË ULËTA

Shpenzimet më të ulëta mujore për bruto dhe neto pagë në vitin 2016 janë realizuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ku mesatarisht për të punësuar janë realizuar 29.347 denarë bruto, ose 20.017 denarë neto pagë, pastaj vijon Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës me 28.601 denarë, respektivisht me 19.527 denarë neto

pagë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale me 28.243 denarë bruto, respektivisht me 19.292 denarë neto pagë mesatare mujore për të punësuar dhe Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit me bruto pagë mujore më të ulët për të punësuar prej 26.542 denarë ose 18.174 denarë neto pagë mujore për të punësuar.

PARLAMENTI E VOTOI PROPOZIMIN E IVANOVIT

BEZHOSKA EMËROHET GUVERNATORE E BPRM-së

Angellovska-Bezhoska tetë vite ishte në funksionin zëvendës guvernatore e BPRM-së, e angazhuar për sferat e politikës monetare, hulumtimit dhe statistikës. Prej vitit 2004 deri në vitin 2010, Angellovska-Bezhoska ishte ekonomistja kryesore në BPRM



Shkup, 21 maj - Parlamenti i Maqedonisë e emëroi dr. Anita Angellovska Bezhoska guvernatore të Bankës Popullore të Maqedonisë (BPRM). Për të votuan 81 deputetë, të përmbajtur dhe kundër nuk pati. Angellovska Bezhoska është gruaja e parë guvernatore e BPRM-së, ndërsa në këtë pozitë vjen nga pozita e zëvendës guvernatores në Bankë. Koordinuesi i VMRO-DPMNE-së, Dragan Danev, tha se ata do ta mbështesin kandidaturën e saj, e më pas me mbështetje u paraqit edhe koordinuesi i grupit të deputetëve të kryesuar nga LSDM, Tomisllav Tuntev. Deputetja Daniella Rangellova, e cila është edhe kryeta-

re e Komisionit për mundësi të barabarta, shfaqti shpresë që në këtë pozitë vjen një grua. Presidenti Gjorge Ivanov e propozoi Angellovska-Bezhoska për guvernatore të BPRM-së pasi paraprakisht i propozuari Dimitar Bogov u tërhoq nga kandidatura, pas kritikave nga shumica në pushtet. Ivanov në propozimin e vet theksoi se Angellovska-Bezhoska, e cila vjen nga radhët e profesionistëve dhe strukturave udhëheqëse të BPRM-së, është zgjidhje për pozitën e guvernatorit, me çka do të vazhdohej kontinuiteti i punës pozitive dhe udhëheqjes së suksesshme të politikës mone-

tare të Republikës së Maqedonisë. Angellovska-Bezhoska tetë vite ishte në funksionin zëvendës guvernatore e BPRM-së, e angazhuar për sferat e politikës monetare, hulumtimit dhe statistikës. Prej vitit 2004 deri në vitin 2010, Angellovska-Bezhoska ishte ekonomistja kryesore në BPRM. Njëherësh, ka qenë e angazhuar në Fondin Monetar Ndërkombëtar në Uashington, në Sektorin për politika makroekonomike në vendet evropiane dhe në Sektorin për politika fiskale. Angellovska-Bezhoska ka marrë pjesë në disa misione negociuese të FMN-së për arritjeve të aranzh-

maneve mes fondit dhe vendeve-anëtare. Prej vitit 1996 deri në vitin 2004 ajo ka punuar në Ministrinë e Financave ku ka drejtuar disa sektorë, nga bashkëpunëtor profesionist për sistem financiar, këshilltare për përgatitje dhe ekzekutim të buxhetit, udhëheqëse e sektorit Trezor pranë sekretarit shtetëror të Ministrisë së Financave... Angellovska-Bezhoska u pajis me titullin doktore e shkencave në Fakultetin ekonomik në Lubjanë në vitin 2015, ndërsa tema e disertacionit të saj të doktoraturës është "Koordinimi i politikës monetare dhe fiskale në Republikën e Maqedonisë".

Biznesi i kënaqur me kthimin e TVSH-së

Shkup, 21 maj - Pas 10 viteve, për herë të parë komuniteti i biznesit i organizuar në Odat Ekonomike të Maqedonisë shprehet i kënaqur me punën e Qeverisë sa i përket kthimit të TVSH-së. Nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) thonë se janë të kënaqur se si Ministria e Financave në kohë po rimburson TVSH-në për kompanitë vendase dhe se asnjë kompani private anëtare e OEMVP-së, nuk është ankuar se ka vonesë sa i përket kthimit të TVSH-së. "Është për tu përshëndetur mënyra se si Ministria e Financave po ua kthen në kohë kompanive private TVSH-në. Rikthimi i TVSH-së po bëhet në kohë që nga fillimi i këtij viti. Mua edhe shumë kolegëve tjetër që jemi pronarë të firmave na është kthyer në kohë TVSH-ja. Ka edhe vonesa, por të gjitha këto janë në kuadër të limiteve për kthimin e TVSH-së", thotë Nazmi Ejupi, nënkryetar i OEMVP-së. Edhe nga Oda Ekonomike e Maqedonisë shprehen se nuk ka ankesa nga anëtarët e saj sa i përket kthimit të TVSH-së nga ana e Qeverisë. "Kohëve të fundit shohim se po rritet pagesa e tatimeve, gjegjësisht po kthehet në kohë TVSH-ja për firmat që dukshëm po kontribuon në likuiditetin e firmave dhe kapacitetin për të pasur një zhvillim sa më të lartë ekonomik. Askush nga anëtarët Odës deri më sot nuk është ankuar se shteti po u vonon kthimin e TVSH-së", thonë nga Oda Ekonomike e Maqedonisë. Ndryshe, një ditë më parë, ministri i Financave, Dragan Tevdovski, në një intervistë për Agjencinë Informativë të Maqedonisë, ka thënë se është përmirësuar pagesa e të ardhurave dhe se është rritur kthimi i TVSH-së në katër muajt e parë të vitit. Sipas Tevdovskit, nga muaji janar i këtij viti pagesa e tatimeve është për 4.7 për qind më e lartë se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe se ky është një lajm i mirë, sepse po ndodhë përmirësimi i aktiviteteve ekonomike në Maqedoni. (Z.V)

MASA PËR TË ZBUTUR TOLLOVINË

Regjim i ri i komunikacionit pranë spitalit

Tetovë, 21 maj - Kaosi në rrugën e Spitalit të Tetovës ka bërë që më në fund autoritetet e komunës në bashkëpunim me policinë e Tetovës të ndërmarrin hapa për ti dhënë fund këtij problemi që është mjaft akut këtyre ditëve, por që pritet të ketë edhe më tej probleme. "Në bazë të aksionit për rregullimin dhe vijëzimin e bulevardëve kryesore të qytetit, Sektori për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësorë gjatë vikendit ka rregulluar dhe vijëzuar edhe rrugën tek Spitali klinik i qytetit si pjesë e aksionit që do të realizohet në mbarë komunën e Tetovës e që pritet të përfundojë javëve në vazhdim. Me këtë rast janë vijëzuar disa kahje në drejtim të spitalit dhe rruga kryesore, e me këtë rast bëhet lehtësimi i lëvizjes së gjithë qytetarëve por edhe për veturat pasi e njëjta rrugë është një



nga më të frekuentuarat në mbarë qytetin", thotë Arsim Nuredini, udhëheqës i Sektorit për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësorë. Ky aksion është bërë në bashkëpunim me policinë dhe sektorëve të saj dhe pritet të ketë efekt pozitiv për të mundësuar komunikacion më efektiv. "Gjithë aksioni është duke u zhvil-

luar në rritëm të duhur, ne si sektor jemi duke e ndjekur punën në terren që po realizohet dhe urojmë që të mbarojë në kohë të duhur pasi vijëzimi është një nga rregullat kryesore në realizimin e komunikacionit dhe mos shkaktimin të problemeve në këtë drejtim", thonë nga Sektori për veprimtari komunale dhe mbrojtje të am-

bientit jetësorë. Megjithatë, do të ketë ndryshime edhe në regjimin e komunikacionit, sepse njëra rrugë do të jetë e ndaluar për automjete, por që ka qenë e kalueshme deri më tash. Kjo, sipas drejtuesve të këtij sektori, është bërë për shkak të kërkesave edhe të vet qytetarëve dhe institucioneve. "Për shkak të ngarkesës së madhe të rrugës

në drejtim të spitalit, me kërkesë të drejtorisë së Spitalit Klinik të Tetovës dhe në koordinim me Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë, është vendosur që rruga nga hyrja e fundit e spitalit në drejtim të AMCM-së të bëhet njëdrejtimëshe (njëkahëshe) pasi ka qenë e vetmja zgjidhje e ankesave të shumta që janë bërë në drejtimin tonë si komunë", theksuan nga ky sektor. Ndryshe, javën e kaluar policia ndaloi taksistët që të parkohen para hyrjes së spitalit. Problemi krijohet në hyrjen kryesore të Spitalit Klinik të Tetovës ku edhe veturat edhe automjetet e Ndihmës së Shpejtë shfrytëzojnë këtë hyrje që shpeshherë krijon kaos në këtë vend. Edhe pse tashmë kjo rrugë është shpallur njëkahëshe, megjithatë edhe gjatë ditës së hënë janë hasur kaos dhe tollovi para hyrjes së spitalit. (U.H)

Nikolloski pret vit të suksesshëm bujqësor

Shkup, 21 maj - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Lupço Nikolloski pret vit të suksesshëm bujqësor. Optimizmin e themelon në kushte të motit, në pagesë me kohë të subvencioneve, por edhe në informacionet nga kontaktet e përhershme dhe takimet me bujqit dhe shoqatat e tyre. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, tha se në mënyrë aktive e përcjell situatën, mban takime me të gjitha palët e prekura. "Këtyre ditëve kemi pasur takime edhe me përfaqësues të industrisë së mullinjve, prodhuesve e grurit dhe të gjitha kategoritë tjera prodhime bujqësore, mbi 90 përqind të subvencioneve do të paguhet në afatin ligjor konform të dhënave të përpunuara të agjencisë për pagesa në çdo pikëpamje", tha ministri Nikolloski duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve në konferencën për shtyp për ndërtimin e sistemit për ujtime në rrethinën e Vallandovës.

Rruga Shkup-Kaçanik lëshohet më 1 qershor

Prishtinë, 21 maj - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, dje informoi se rruga Prishtinë-Shkup, përmes Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, do të lëshohet në qarkullim me siguri më 1 qershor, lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Prishtina. Në konferencë për media pas seancës së sotme qeveritare, Haradinaj deklaroi se sipas informacionit që e ka marrë nga ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj, punët në këtë rrugë do të përfundojnë deri më 1 qershor, sepse punohet në dy turne. Kjo rrugë u mbyll më 8 maj me qëllim që të zgjidhen problemet me vende ku shpesh herë ka rrëshqitje të dheut dhe fillimisht është paralajmëruar se punët do të zgjasin një muaj.

RIKONSTRUIMI I TREGUT ZGJIDHJE PËR KAOSIN

VONOHEN PUNIMET NË BIT PAZAR



Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 21 maj - Mbulimi i tregut të Bit Pazarit dhe rikonstruimi i tij pritet ti jep fund kaosit mesjetar në pjesën veriore të Shkupit. Punimet e filluara muaj më parë, siç njoftojnë institucionet komunale, paraqesin fazën e parë të punimeve për ndërtimin nga e para të tregut më të madh në vend. Realizimi i këtij projekti i mbështetur nga shoqëria aksionare "Skopski Pazar", në tërësi sipas planit përfundimtar, duhet të realizohet në katër faza, gjegjësisht për momentin punimet janë duke u zhvilluar në rajonin 8 dhe 7. Kryetari i shoqatës së tregtarëve, Ekrem Dolek, për gazetën KOHA thotë se me punimet aktuale në Bit Pazar zhvillohen në drejtim të instalimit të infrastrukturës nën tokësore (gypa të ujit, kanalizimi, kablo të rrymës e kështu me radhë). Ai, mes tjerash tregon se afati kohor i rikonstruimit të tregut të Bit Pazarit pritet të zgjasë 14 muaj, respektivisht deri në prill të 2019. Pavarësisht se punimet për Bit Pazarin kanë fil-

luar në shkurt të këtij viti, Dolek shprehet i brengosur për ecurinë e ndërtimeve.

"Realisht kemi konstatuar ngecje në realizimin e aktiviteteve ndërtimore në Bit Pazar. Për këtë çështje i kemi njoftuar edhe drejtuesit e Qytetit të Shkupit dhe ata të Komunës së Çairit. Ua kemi bërë me dije se prolongimi eventuale i rikonstruimit me automatizëm do të ngjallë revoltën e tregtarëve. Sidoqoftë, ne jemi të kënaqur që ky projekt përfundimtar ka filluar dhe i cili pritet ti plotësoj standartet e kërkuara nga tregtarët dhe njëkohësisht krijimin e hapësirës për parkimin e mbi 200 vetura", tha Dolek.

Rindërtimi i Bit Pazarit ka filluar pas një dekade premtimesh. Gjatë dhjetë viteve të fundit, për këtë treg janë propozuar dhjetëra projekte dhe ide. Procedurat burokratike nga njëra anë dhe mungesa e vullnetit nga ana tjetër, kanë qenë pengesa kryesore se pse pikërisht në 2018 të fillojë rikonstruimi i tregut të gjelbër më të madh në Maqedoni. Tezgat e vjetruara dhe

"Realisht kemi konstatuar ngecje në realizimin e aktiviteteve ndërtimore në Bit Pazar. Për këtë çështje i kemi njoftuar edhe drejtuesit e Qytetit të Shkupit dhe ata të Komunës së Çairit. Ua kemi bërë me dije se prolongimi eventuale i rikonstruimit me automatizëm do të ngjallë revoltën e tregtarëve...", tha kryetari i Shoqatës së tregtarëve, Ekrem Dolek

kushtet e këqija në të cilët kanë punuar tregtarët, me rikonstruimin e Bit Pazarit, pritet ti takojnë të kaluarës. Sfidat e fundit të cilën duhet ta kalojnë tregtarët e Bit Pazarit është ajo e durimit. Dislokimi i tezgave kohë pas kohë brenda periudhës që vijon, siç thonë tregtarët, do të paraqet problem për mbajtjen e kontakteve me myshterinj të rregullt. Me qëllim respektimit të konkurrencës së drejtë, nga Komuna e Çairit theksojnë se gjatë periudhës së kaluar, në bashkëpunim me shumë institucione tjera, kanë kontribuar në

pastrimin e tregtarëve që veprimtarinë e tyre e kanë zhvilluar në trotuarë përreth Bit Pazarit. Duke komentuar revoltën dhe pakënaqësitë e shprehura nga një grup tregtarësh, të cilët gjatë javës së kaluar disa herë e bllokuan rrugën kryesore drejtë qendrës së Shkupit dhe anasjelltas, nga Komuna e Çairit thonë se janë tejet të interesuar që rendi dhe disiplina të mbizotëroj edhe në këtë pjesë të qytetit. Përveç punimeve të ngadalësuar që zhvillohen brenda hapësirës së Bit Pazarit, rikonstruimi dhe punime janë duke u zhvilluar edhe përkajë bulevardin "K.P. Misirkov". Autoritetet e Qytetit të Shkupit me kërkesë të Komunës së Çairit, duke synuar lirimin e hyrjes së Çarshisë, kanë vendosur që në afërsi të tregut të Bit Pazarit, konkretisht në vendin ku deri më tani janë shitur lule, të vendoset një taksistacion. Njëkohësisht, përpos 10 vendeve për taksistacione, përreth Bit Pazarit pritet të ndërtohet një korsi për biçikleta dhe këmbësorë, gjegjësisht hapësirë e gjelbërt.

HOTELIERËT KËRKOJNË RREGULL

Kontroll më të madh të objekteve të pa kategorizuara

Shkup, 21 maj - Organet inspektuese të angazhohen më shumë dhe të kryejnë kontroll të numrit të madh të objekteve të akomodimit të paevidentuara, të pa standardizuara, të pa kategorizuara dhe të pakontrolluara në shtet, kërkojnë nga Shoqata e Hotelierisë dhe Turizmit pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë. Zëvendëskryetari i Shoqatës, Goran

Damçevski dje në konferencën për media në Odën Ekonomike tha se në Maqedoni ka 450 hotele të evidentuara, të standardizuara dhe të kategorizuara, ndërsa në platformat për onlie publikime ose prenotime për Shkup ka 600 objekte të paraqitura dhe 1.500 për Maqedoni. Ai theksoi se duhet të vendosë rend në këtë pjesë të punës dhe të lehtësohet puna e

atyre të cilët janë të regjistruar legalisht. "Na pengon kontrolli i pamjaftueshëm nga ana e organeve inspektuese në kuptim të kontrollit që jep, se sa të hyra në vlerë denari ose të devizave kemi në Maqedoni. Ka mungesë të evidentimit të udhëtarëve gjegjësisht personave fizikë gjegjësisht të asaj se kush dhe ku qëndron. Shteti nuk ka parasysh se çka plasohet

përmes booking, airbnb", theksoi Damçevski. Ai shtoi se humbje pësojnë hotelet dhe akomoduesit e objekteve të cilat janë të regjistruara, të paraqitura legalisht, shteti i cili nuk i mbledh mjetet nga taksat për qëndrim... dhe mysafirët të cilët i nënshtrohen çfarëdo qëndrimi në kushte substandarde, sepse ka konkurrencë jolojale.

Daniella Mihajlovska Vasilev-

ska nga Oda Ekonomike e Maqedonisë tha se Shoqata në periudhën e kaluar ka realizuar më shumë aktivitete me iniciativa konkrete për ndryshime dhe plotësim të rregullativës ligjore në sektorin me qëllim realizimin e rezultateve më të mira të cilat duhet të tregojnë edhe impakt më të madh të hotelierisë dhe turizmit në ekonominë vendore.

KODRA E DIELLIT PA INVESTIME AS DIMRIT DHE AS VERËS



"MASTER PLANI" VETËM NË LETËR

Tre premtime madhore janë bërë për Kodrën e Diellit, por se asnjëra nuk u realizua deri më sot. Mungojnë rrugët, ndriçimi publik, ambulanca dhe ski-liftet...

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 21 maj - Më shumë se 20 vite në Kodrën e Diellit nuk është bërë asnjë investim. Ndërkaq, që nga koha e monizmit, në këtë pikë turistike mungojnë investimet kapitale. Rruga që çon në këtë qendër turistike në shumë vende është e dëmtuar. Problem në vete në Kodër të Diellit është edhe ndriçimi publik, infrastruktura rrugore, mbeturinat që hidhen gjithandej. Banorët e vikend-shtëpizave vite me radhë kanë kërkuar të rregullohet çështja e ndriçimit publik dhe rregullimi i infrastrukturës, por kërkesat gjithmonë kanë hasur në vesh të shurdhër. Që nga viti 2001 është jashtë funksionit edhe teleferiku kryesor nga Tetova për në Kodër të Diellit, i cili as që përmendet nëpër investimet kapitale dhe ka ngelur vetëm një relikto nga e kaluara. Qytetarë të organizuar në një shoqatë "Të shpëtojmë Kodrën e Diellit", disa herë ka kërkuar që Qeveria të ftojë investitorët e huaj që kanë përvojë në menaxhimin dhe zhvillimin e qendrave turistike. Qeveria ka bërë të ditur se kompania ELEM TURS, e cila menaxhon me Kodrën e Diellit, nga 1999 nuk do të jetë menaxhuese e

terreneve për skijatorë. Ndonëse është tërheqëse për dimrit për shkak të terreneve të përshtatshme për skijim, po ashtu gjatë verës karakterizohet me natyrën e bukur, ajrin e pastër dhe shumë bukuri tjetra të rralla që janë ideale për turizmin veror, por ky lloj i turizmit është pothuajse i vdekur në këtë pjesë të Tetovës.

Në vitin 2012, Qeveria kishte miratuar një master-plan për Kodrën e Diellit, e cila parashikonte ndërtimin e hoteleve të reja, vëndparkime dhe ski lifte. Por edhe përkaj kësaj, asgjë nuk u realizua sot e 6 vite. Para tre vitesh kishte edhe një tentim të pasuksesshëm që të krijohet një liqen artificial në pjesën qendrore të Kodrës së Diellit, i cili do të duhej që të përdorej për rekreim dhe për krijimin e dëborës artificiale, por që nuk u realizua asnjëherë.

Edhe para dy vitesh filloi të ndërtohet një ski-lift me gjashtë ulëse dhe në dy raste, për shkak të mos respektimit të ligjeve, punimet u ndërpre. Nga Këshilli iniciativ për shpëtimin e Kodrës së Diellit kohë më parë kërkoi nga kompania që menaxhon me Kodrën e Diellit të zgjohet nga gjumi dhe të rregullojë infrastrukturën e kësaj qendre turistike, të riaktivizoj telefe-

rikun Tetovë-Kodra e Diellit, të rregulloj ski liftet, qendra të ketë ambulancën e saj parkingje, infrastrukturë e kështu me radhë.

Rruga që kalon përmes vikend-shtëpizave është e dëmtuar dhe e parregulluar, ndërsa krahas kësaj mungon edhe ndriçimi publik. Banorët e janë ankuar për këtë gjendje duke kërkuar që sa më shpejtë të rregullohet kjo pjesë. "Rruga është e krejt me gropa, pothuajse e pakalueshme. Nëse kjo pjesë është vend turistik, atëherë duhet të rregullohet dhe asfaltohet, sepse kështu nuk i ngjan një vendi turistik. Kështu nuk tërhiqen turistët, por në këtë mënyrë i largojmë ata nga ky vend. Po ashtu, edhe ndriçimi publik nuk funksionon që moti, natën ka qen endacak dhe është frikë për banorët që vijnë gjatë vikendit këtu të pushojnë", thotë një banor në Kodrën e Diellit. Gjatë periudhës së kaluar, në Kodrën e Diellit mbahej manifestimi "Kupa e Malit Sharr", Festivali Ndërkombëtar i Çiklizmit malor dhe vrapim malor. Po ashtu edhe universitetet dikur organizonin gara në skijim, por pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve tashmë i kanë mbetur vetëm të kaluarës.

Shkupi do të punësojë 50 zjarrfikës të rinj



Shkup, 21 maj - Në stacionin zjarrfikës në Autokomandë dje edhe solemnisht u shënuar 20 Maji - Dita e zjarrfikësve. Shënimi filloi me rreshtimin solemn të zjarrfikësve, ndërsa komandanti i Brigadës për mbrojtje zjarrfikëse, Zvonko Tomeski i parashit raport kryetarit të Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, kumtoi shërbimi i Qyte-

tit të Shkupit. Shilegov ia uroi Ditën zjarrfikësve dhe u falënderoi për përkushtimin dhe sakrificimin në kryerjen e profesionit. Ai theksoi se Qyteti i Shkupit investon në pajisjen dhe në modernizimin e Brigadës zjarrfikëse. "Këtë vit nga buxheti i Qytetit të Shkupit për Brigadën për mbrojtje zjarrfikëse kemi ndarë gjithsej 134 milionë de-

narë. Në këto mjete është paraparë edhe furnizim i shkallës së re automekanike zjarrfikëse, minimum 75 metra të gjatë dhe furnizim të dy automjeteve autocisterna. Është porositur edhe simulator i ri për goditje të zjarrta, që përdoret për stërvitje përmes simulimit të kushteve reale të zjarrit. Këto janë vetëm një pjesë e nevojave vijuese të një Brigade bashkohore për mbrojtje zjarrfikëse", tha Shilegov. "Këtë vit në Brigadën për mbrojtje zjarrfikëse është paraparë të pranohen 50 zjarrfikës të rinj. Në pajtim me standardet evropiane, proporcioni është një zjarrfikës në 1.500 banorë, ndërsa gjendja momentale në Shkup është një zjarrfikës në 3.500 banorë", theksoi Shilegov. Në fjalimin e tij, Shilegov potencoi se këtë pajisje kohë të gjatë e kanë pritur dhe për këtë shkak, Qyteti e furnizon këtë vit, si dhe se janë të vetëdijshëm për nevojën e tyre për pajisje të re bashkohore, në pajtim me standardet evropiane.

KRONIKË

Dënohen

29 vozitës të dehur

Gjatë dy ditëve të kaluara të vikendit në rajonin më të gjerë të Tetovës, është kryer kontroll aksion ndaj vozitësve që drejtojnë automjete nën ndikim të alkoolit, në të cilën janë përfshirë gjithsej 348 vozitës, prej të cilëve 214 janë kontrolluar me alkotest. Tek 29 vozitës është konstatuar prezencë e alkoolit, gjegjësisht ata kanë drejtuar automjetet e tyre në gjendje të alkoolizuar. Me këtë rast, të gjithë janë përjashtuar nga trafiku, derisa 27 vozitësve u janë marrë përkohësisht lejet për vozitje, njofton policia e Tetovës. Krahas kësaj, vozitësve të dehur u janë përgatitur kundërvajtje adekuate, ku do të ballafaqohen me gjoba të parapara me Ligjin për siguri në komunikacion dhe rrugë, të cilat për këtë lloj kundërvajtje lëvizin prej 250 deri 500 euro në kundërvlerë të denarit. Në këto aktivitete, gjithashtu janë konstatuar edhe gjasthëdhjetë kundërvajtje të llojeve të ndryshme, të cilat janë përgatitur me gjoba adekuate.

20 vjeçarja

konsumon preparate, përfundon në spital

Të dielën në repartin urgjent të Spitalit të përgjithshëm "Ferid Murat" të Gostivarit, në gjendje të rëndë shëndetësore është pranuar 20 vjeçarja nga Gostivari, e cila paraprakisht ka konsumuar një sasi të caktuar preparatesh toksike higjienike. Pas dhënies së ndihmës mjekësore, është lëshuar për shërim shtëpiak, ndërsa shkaqet për helmimin kanë qenë mosmarrëveshjet familjare.

Aksidentohet

12 vjeçari

Në rrugën "Radovan Coniq" në Tetovë, të dielën rreth orës 15 e 50 minuta ka ndodhur aksident trafiku në të cilin kanë marrë pjesë vetura "Audi A4" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 44 vjeçari M.I. nga Tetova dhe biçikletës e tipit "Maks" e drejtuar nga 12 vjeçari nga Tetova. Lëndime trupore në aksident ka marrë 12 vjeçari, i cili është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës për marrjen e ndihmës mjekësore. Punohet në zbardhjen e këtij aksidenti.

Gjendet mjet shpërthyes në Gostivar

Të dielën rreth orës 11.00, personi F.B. 53-vjeçar nga Gostivari, ka denoncuar se në lagjen "Cigllana" në Gostivar ka vërejtur një mjet eksplozues. Menjëherë policia ka dalë në vendin e ngjarjes, ku janë kryer hetimet dhe është vërtetuar se bëhet fjalë për "minë trombloni" funksionale, të cilën përfaqësuesit e Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim për kohë të shkurtër e kanë marrë dhe transportuar nga vendi. Punohet në zbardhjen e rastit kush dhe pse e ka lënë minën në atë vend. (U.H)

E PANJOHURA "X"!

Nga

Adelina MARKU



Fuqia është tek misteri , tek e panjohura dhe dikur e panjohur ishte edhe politika për ne. Kishte ndikim, sepse kishte fuqi , sepse prodhonte mistere që të mbanin peng të vërtetën tënde! Sot gjërat janë ndryshe, sot fuqi ka ai/ajo që mban peng informacionet simuluese politike e që pak kanë të bëjnë me të vërtetën tënde, me të drejtën tënde! Sot, dy njerëz mund të jenë më të fuqishëm se vetë shteti. Si psh ata të dy të punësuarit e Ministrisë së punëve të brendshme që "zbuluan" aferën e bombave e që "rrëzuan" qeverinë e para do kohëve në Maqedoni. Ata të dy në esencë ishin fuqia vetë! Në momentin që u demistifikuan, në momentin që pengun (informacionin) e lëshuan në qarkullim, që të dy u shndruan në njerëz të zakonshëm! Fuqia ka nevojë të qarkullojë apo, po e mbajte vetëm për vete, ajo të mbytet, të armiqëson me veten deri në vetëdestrukcion. Pra këta njerëz, ishin burimi i një diçkaje të re që vijka! Janë paralajmëruarit apo! Pastaj vjen faza e re, faza e asaj "diçkasë që do vijke": mitet që krijohen për njerëzit që mbanin gjithë ato informacionet bombave në fakt ndihmojnë që të sajohet një tregim i ri, aty për aty. Fuuup konstruohet një paket qeveritar me një paket vizioni ndryshe nga ai i djeshit! Padiktueshëm ti gjen veten të pranosh edhe skandalin por edhe demistifikimin e skandalit! Pastaj, gjërat "i lëvizin " aq shpejt sa që ti gjen veten përsëri të ngarkuar me informacione që nevojitet t'i përpunosh disi. Pra, burimi "x" të jep informacion "y" për aq sa ti të ndjehesh i fuqishëm për t'u ngritur mëkëmbë sërrish! Psh, kujtoju për një çast se sa letargjik ishte para shpërthimit të bombave dhe krahaso veten me fazën e pas shpërthimit të bombave kur ti u ndje-

ve i ngopur me informacione shokuese të cilat çuditërisht të ngritën mëkëmbë e të shkëputën nga letargjia e djeshit! Dole jashtë dhe iu bashkangjite të tjerëve për të bërë "revolucionin". Ti i ishe dorëzuar atij diktati të asaj qeverie dhe i ishe lëshuar mëshirës së fatit , apo. Pastaj gjërat ndryshuan në momentin kur dikush të dha informacionin! Të bëni të ndjehesh të fuqishëm përsëri! Thu ti, ta dhanë FATIN t'a udheheqësh vetë përsëri!

Kjo pra është mënyra sot se si e bëjmë politikën. Ja, po e quaj teknologji bërje politikë! Njerëzit që me-

ren me këtë lloj profesioni e që ndërtojnë teknologjinë e politikës për shtetet e Ballkanit nuk janë Ballkanas. Kryesisht janë të atillë që e njohin mirë psikologjinë transformativë të shoqërive, e posaçërisht atyre shoqërive të cilat duke kaluar nëpër kriza e kriza të ndryshme politike, arrijnë aq shumë të demistifikojnë politikën dhe imazhin për veten dhe prandaj bëhen ELASTIKË, e si rezultat pranojnë ÇDOGJËNË me një lehtësi relativizuese.

Sot, shumë pak gjëra lëvizim vetë. Menaxhimi i shtetit është i tipit korporativ ndërsa liderët e rinj zgjidhen

Koha që kemi në dispozicion çdo ditë është elastike, pasionet që ndiejmë biles e zgjerojnë elasticitetin tonë, ato që na frymëzojnë të mendojmë mbi çështje të caktuara - si kjo mbi emrin e shtetit, pastaj na e ngushtojnë e paketojnë sërrish pasionin ndërsa neve gjejmë veten të kemi pranuar çdo gjë, ashtu siç na e kishin gatuar ATA!



përmes intervistave e jo votës direkte . Zgjedhja e atyre ka të bëjë me atë se sa elastikë janë para një paketi të ri për shtetin (shoqërinë) që duhet importuar sa më shpejt e distribuuar sa më qartë ndër "votues". Pra , liderët e rinj zgjidhen sipas përmasave të paketit të ri që duhet të rrëzojë qeverinë e vjetër me qëllim që energjia të qarkullojë e të mos krijojë diktat vetë-shkatërues apo. Kështu e lexojnë demokracinë ata që prodhojnë teknologjinë e politikës për Ballkanin. Po të na lenin pa këtë teknologji , ne do vazhdonim të zbraznim resurset e shteteve tona e do ia kishim mbathur diku të fshihemi! Pastaj për këta liderë thonë se janë të guximshëm , fundja e ardhmja iu takon atyre që e ndjehet se si po vjen dhe zakonisht këta tipa dijnë ti thonë PO të ardhmes, e të shkëputen nga e kaluara sikur të mos ketë ndodhur kurrë!

Përshebull, një teknologji të këntillë përdorin edhe ata që shqetësojnë shumë linguistë vendas të cilët reagojnë në ofertën për emrin e ri të shtetit. Hmmm, fatkeqësisht pak rrëndësi ka nëse linguistët kishin të drejtë ose jo , rrëndësi për ata që tani po distribuojnë këtë të vërtetë mbi ofertën e re të emrit të shtetit është se ajo po shitet si hallva dhe se targeti është "Sa Shitet" e shumë pak çë-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 21 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shtja se "Sa Tlyen e Sheqer" përmban hallvaja!

Le kthehem pak në retro e të kujtojmë se si deri dje në këtë shtet kishte një kryeneçësi pothuajse gomari mbi çështjen e emrit, ndërsa sot me një elasticitet të paparë komentohen variacionet mbi emrin e ri, pra thuhet: "Ku doli kjo tani, më të mira ishin ato tjerat, Maqedoni e re, ose Maqedoni e epërme, çështje kjo "Ilindenska?!..."

Ky pranim ka të bëjë me elasticitetin që përmenda më lartë. Fenomeni i "Krizë pas krizës" o të bën elastik o të shfarros! Janë gjithmonë vetëm dy skaje, apo!

Ndërsa ne shqiptarët pa gjene ngadalë ngadalë gjejmë veten të kyçemi vullnetshëm në këtë proces, sado deri dje thonim se i pranueshëm do ishte çfarëdolloj emërimi i ri për shtetin. Sigurisht që na provokuan përsëri ata që konstruojnë paketin e ri të së vërtetës që neve duhet t'a pranojmë me elasticitet, apo. Provokimi i tyre ishte vërtet i karakterit lingvistik, por qëllimi është tjetër, është i pastërt politik e besoj për këtë jemi dakord ne të dy i/e nderuar lexues. Pra ne u ngjitëm si ajo miza në mut apo, e pyetemi me hidhërim se çka në emër të zotit na qenka kjo "Ilindetase", ndërsa thellë thellë ndihemi komod e rrehat tek kuptuam se emri shtetit do përktheheshka edhe në gjuhën shqipe. Ja mendoje pak dhe më vërteto të kundërtën po munde!

Miq, koha që kemi në dispozicion çdo ditë është elastike, pasionet që ndiejmë biles e zgjerojnë elasticitetin tonë, ato që na frymëzojnë të mendojmë mbi çështje të caktuara - si kjo mbi emrin e shtetit, pastaj na e ngushtojnë e pake-tojnë sërish pasionin ndërsa neve gjejmë veten të kemi pranuar çdo gjë, ashtu siç na e kishin gatuar ATA!

Këtë bojë mban kompromisi, prandaj mos prish gjak kot! Ilindetase ose ndrysh', pak rrëndësi ka! Ktheju pyetjes fillestare miku im e pyet veten se sa e rrëndësishme ishte origjina, prandaj kultura e gjuha jote dhe testo veten sërish se pas gjithë këtyre krizave që na gatoi ky shtet, TI a dole më i fortë e u bërë më i zgjuar përmes elasticitetit prandaj do ngulmohesh shumë për kulturë vetanake, apo me elasticitet do pranosh hipokrizinë përsëri dhe do relativizosh origjinën tënde? Unë këtë do e nisja si debat...sepse kjo mbi emrin e shtetit do mbetet çështje trivial pwr mua edhe pwr ty...! Pastaj mos harro se ekzistenca jote kulturore mban rrënjë tjera e që nuk ka të bëjë me të panjohurën "x", aq më shumë me këtë lloj trivialiteti që të gatuan teknologjia e bërjes politike mbijetese.

Bëje dallimin dhe le mos të të ik diferencat!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

Ehe, miku! Ish komunisti u bë për "oturak!"



Nga
Fadil LUSHI

Disa ditë më parë takova shokun e klasës të viteve gjashtëdhjetë. Ishte bërë "hundë e buzë". Lëre që ballafaqohet me varfërinë e tij të skajshme, por të duket edhe i trishtuar. Që i ri ishte i tillë. Nuk mund të thuash se asokohe ishte i pavendosur për të bërë ndonjë punë. Komunistët, fillimisht e nëpërkëmbën, mandej e përjashtuan nga shkolla dhe, së fundi, e burgosën bashkë me ca anëtarë të fisit të tij. I thanë: "O do mbyllësh gojë o do ikësh nga këtej!". Ai asnjëherë nuk mbylli gojën, nuk ndërroi mendje e bajrak dhe as që iku nga këtej. Kur ai nuk veptoi ashtu siç i thanë, komunistët ia hëngrën kokën dhe ia zhvatën dhe "sikterisën" ëndrrat rinore. Ky shoku i klasës, sikur tek unë donte të kërkonte dëshmitarin e një të kaluarë të hidhur. Shoku i klasës e di fare mirë pse unë nuk bëj zhurmuesin..., ai e di se provat a argumentet për meselenë e tij dhe të tjerëve, të tillë si ai, janë tek unë.

Pasi u përshëndetëm, i thashë: "Ç'kemi shoku?". Ma ktheu: "Çka mund të kem, kur dihet se komunistët në vaktin e tyre m'i morën të tërë ato që ishin të miat. Më shndërruan në lëmoshar prej cigani!". Unë ende pa e mbyllur gojën, ai iku..., i bindur se nuk është më pjesë e atij regjimi diktatorial të shekullit që lamë pas. Mllëfin e tij e kuptova fare mirë, por nuk e "kuptova" krahasimin që bëri me ciganin dhe krye-komunistin gjegjësisht krye-gjykatësin e Tetovës, i cili dy herë ia "mori masën e samarxiut"! Mua më mbeti që të kërkoj a të gjej shpjegimin e fjalës cigan, sepse ky farë krahasimi i shokut tim, sikur e "ofendon" komunitetin e dashur rom që rron përreth nesh.

Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, nocionin CIGAN, e lakon kështu... Pjesëtar i një po-pullsie me prejardhje nga India Veriperëndimore, që veten e quan "Rom" dhe jeton zakonisht në mënyrë endacake a gjysmëndacake në Evropë dhe në disa vende të Azisë e të Afrikës. Këtejpari, ku unë gjithë ditën e Perëndisë bëj përpjekje të vegjetoj, duken edhe evgjitet. Unë bëj kujdes ta respektoj komunitetin në fjalë, shpesh takoj evgjitet të dashur e me mosha të ndryshme. Ca janë vendorë e të tjerët të ardhur nga trojet e tjera shqiptare..., kohë pas kohe këtejpari mëhallës sonë duken edhe evgjitet puro shqiptarë, të ardhur nga një shtet fqinj dhe këta janë më të sofistikuar..., uratat i kanë më allfrënga, jo si ato allaturka. Ata



Ky ish gjykatësi numëron ditët e fundit të jetës, gjegjësisht të turpit dhe tradhtisë së tij ndaj vatanit. Dhe sot e gjithë ditën e Perëndisë, nuk ka asnjë mundësi krahasimi mes ciganit tonë të dashur dhe krye-gjykatësit, krye-komunistit dhe krye-pederastit me nam të keq

kërkojnë lëmoshë. Para se t'u japësh ndonjë qindarkë, gjegjësisht denarë..., ata nuk përtojnë kurrë të të urojnë nga zemra. Të thonë: "Zoti të dhashtë shëndet, të dhashtë një nuse me mend, por pa gjuhë e gojë (pavarësisht se një të tillë "mund" ta kesh në shtëpi), Zoti ta ruajt mendjen, 'inshallah' nuk flet me vetveten!" e të tjera urata. Po në ia shave surratin me ngjyrë..., dije se do t'i futësh thonjtë në fyt. Historia e ciganit është humane, nuk është histori as e ngatërruar, nuk është e huazuar e as e sajuar..., rrjedhimisht, ciganët asnjëherë nuk e nëpërkëmbën historinë e tyre, nuk e turpëruan as fisin e as popullin..., ky cigan ynë nuk është i neveritshëm në pamje, po nuk të krijon përshtypjen se mund të jetë i urryer..., mbase është simpatik dhe human edhe përtej varfërisë së skajshme të tij. Keni dëgjuar ndonjëherë e dikund, që ciganit të

ketë futur dorë te thesari dhe pronat e shtetit, pavarësisht se ne me pa të drejtë i konceptojmë, po edhe i paragjykojmë si dilenxhinj, si dembelë, si qaramanë a edhe si qylaxhinj..., keni dëgjuar që cigani ynë i dashur, të jetë i denoncuar për korrupsion dhe krim të organizuar! Unë nuk kam dëgjuar..., ti, miku, nëse ke dëgjuar atëherë dije se e ke toptan gabim. Keni dëgjuar ndonjëherë e diku, që cigani a ciganesha jonë e dashur, të ketë keqpërdorur ndihmat dedikuar jetimëve. Unë nuk kam dëgjuar. Nëse ti, miku im, ke dëgjuar atëherë e ke gabim. Keni dëgjuar ndonjëherë që cigani dhe ciganesha të jenë dënuar për mitmarrje a ryshfet..., unë nuk kam dëgjuar..., ti, miku, nëse ke dëgjuar mos ma thuaj..., sepse s'kam për të të besuar. Keni dëgjuar që cigani dhe ciganesha, që i ke fqinj të parë, të kenë harruar të të ftojnë në dasmën e tyre..., unë nuk kam dëgjuar..., e ti, miku, që "surratin" nuk e ke me ngjyrë, si u bë që harrove të më ftosh mua dhe shokun e klasës në gezimin tënd familjar! Të lus, mos ma thuaj miku! Keni dëgjuar ndonjëherë, që cigani ynë i dashur, të ketë tradhtuar kauzën e popullit të vet..., unë nuk kam dëgjuar. E po, miku, nëse me të vërtetë nuk ke dëgjuar, atëherë pse të duhet gjithë ky paragjykim yti.

Unë kam dëgjuar për ca shqiptarë të korrumpuar, për disa shqiptarë të moderuar, për ca shqiptarë provincialistë, që hiqen hem allfrënga, hem allaturka, hem orientat e oksidental, hem me pushtetin, hem me shkaun, hem patriot, hem tradhtar, hem me fe, hem pa din e iman..., për ca shqiptarë që, hem hanë..., hem flasin jerm ..., ashtu thjesht, shkojnë kah fryn era! Miku im i dashur! Unë njoh ca shqiptarë

të cilët tallen me vetveten, të cilët shpërdorojnë besimin e të tjerëve..., njoh ca burokratë që veprojnë në kundërshtim me ligjin a me normat e moralit shoqëror! Miku im i dashur! Unë njoh ca politikanë nga mendja të hallakatur sa nuk janë në gjendje të të tregojnë ditëlindjen e tyre!? Miku im i nderuar! Unë mbaj në mend edhe kryekomunistin, kryekallauzin e poshtër të ish-dovletit dhe kryegjykatësin e Tetovës, i cili në vitet tetëdhjetë bëri gërdinë, duke përjashtuar nga puna shqiptarë të pafajshëm..., duke dënuar shqiptarët fukarenj..., të cilët me pa të drejtë i ngarkoi me faj..., shqiptari që shqiptarëve ua shiste sapunin për djathë, njeriu që u bë pjesë e "kurvizmit komunist" provincial..., njeriu që në opinionin publik njihet me lugën në brez e herë-herë edhe pa të..., kryemutkomunisti a krye-gjykatësi i famshëm, i cili dikur po edhe sot kur frekuenton restorantet nuk shfrytëzon haletë e tyre, thjeshtë nuk parapëlqen haletë e restoranteve, sepse aty vënë bythën lloj-lloj "in-sani", ai vë bythën në oturak..., e ka marrë si ves që nga vakti i komunizmit..., nga vakti kur ata hanin m... pa lugë e pirun..., këtë oturak ia kishte sjellë një ish-kurbetçi yni nga Gjermania, e kishte marrë veresie fare, oturakun!... Ky ish gjykatësi numëron ditët e fundit të jetës, gjegjësisht të turpit dhe tradhtisë së tij ndaj vatanit. Dhe sot e gjithë ditën e Perëndisë, nuk ka asnjë mundësi krahasimi mes ciganit tonë të dashur dhe krye-gjykatësit, krye-komunistit dhe krye-pederastit me nam të keq.

I gjithë ky shkrimi dedikohet shokut të klasës të viteve gjashtëdhjetë, shokut i cili do të pajtohet parimisht me konstatimin tim. Unë i besoj shokut të klasës!

“Republika Qendrore e Ballkanit”

Nga
Agim VINCA



Kontestit midis Greqisë dhe Maqedonisë për emrin e kësaj të fundit duket se po i vjen fundi. Shqiptarët, natyrisht, nuk mund të jenë indiferentë ndaj emrit të vendit në të cilin jetojnë (fjala është për shqiptarët në Maqedoni), ndonëse as shqiptarët e Shqipërisë dhe të Kosovës nuk do të duhej të jenë të painederuesuar për emrin e shtetit në të cilin jeton një pjesë e konsiderueshme e bashkëkombësve të tyre.

Propozimi i fundit nga pala maqedonase, i bërë nga kryeministri Zaev në samitin e Sofjes: “Republika Ilindenase e Maqedonisë”, të cilin dikush nga shqiptarët u kujtua pa përkthente si “Ilinditase” (!), po refuzohet nga Greqia, por lidhur me të pati reagime, sado të vakëta, edhe nga shqiptarët, kryesisht nga disa intelektualë të paktë dhe ndonjë politikan.

Meqenëse pala greke, sipas lajmeve më të reja, nuk po e pranon këtë propozim, mbetet në opsion propozimi i mëparshëm, i bërë para tij: “Republika Gorna Makedonija”, në gjuhën maqedonase, kurse në anglisht: “Upper Republic of Macedonia”. Po në shqip? “Republika Maqedonia e Epërme”. Megjithatë ky propozim ka pasur njëfarë përkrahjeje, aty-



këtu edhe nga ndonjë analist me emër (V. Surroi), as ky emërtim nuk na duket i përshtatshëm, madje jo vetëm nga prizmi shqiptar. Sepse, nëse paska “Maqedoni të Epërme”, a do të thotë se ka edhe një Maqedoni “të poshtme” dhe “të mesme”? Së këndejmi, ky propozim hap dilema të panevojshme. Pastaj, banorët e shtetit me këtë emër si do që quheshin: “Gornomakedonci”? Në gjuhën shqipe një emërtim si ky është jo vetëm i papërkthyeshëm, por edhe i pakuptimtë. Rrjedhimisht, emërtimi “Republika Gorna Makedonija”, së paku për shqiptarët, është dhe do të duhej të jetë i papranueshëm.

Shumë më i mirë se këto dy

Në Afrikë ekziston një shtet me emrin: “Republika Qendrore Afrikane”, i cili më parë (deri në vitin 1976) është quajtur: “Mbretëria Qendrore Afrikane”, prandaj emërtimi i një shteti evropian dhe ballkanik sipas këtij modeli, nuk do të ishte precedent

propozime do të ishte ai i para disa viteve: “Republika e Maqedonisë (Shkupi)”, të cilin me sa di e pati propozuar Athina zyrtare, kurse Shkupi zyrtar i atëhershëm, “radikal”, e pati refuzuar me pretekstin se cenon identitetin historik të vendit, sado që ky arsyetim nuk qëndron aspak.

Nuk është dëgjuar deri më sot një propozim, për të cilin kam menduar kaheër ta hedh në opinion dhe i cili do të ishte i pranueshëm besoj për të gjitha palët: edhe për grekët, edhe për shqiptarët, edhe për ndërkombëtarët e, pse jo, edhe për vetë maqedonasit: “REPUBLIKA QENDRORE E BALLKANIT” ose “REPUBLIKA QENDRORE BALLKANIKE”.

Ky emërtim reflekton pozitën gjeografike të shtetit dhe strukturën etnike të tij. Maqedonia shtrihet në qendër të Ballkanit, midis Shqipërisë, Greqisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Kosovës, me të cilat kufizohet, kurse popullsia e saj përbëhet nga: maqedonasit sllavë dhe shqiptarët etnikë, që paraqesin dy bashkësitë kryesore etnike të vendit, por ka edhe turq, vlllehë, romë, boshnjakë, serbë, grekë, bullgarë etj.

Emërtimi “REPUBLIKA QENDRORE E BALLKANIT” ose “REPUBLIKA QENDRORE BALLKANIKE” i sintetizon të gjitha karakteristikat gjeopolitike, etnike dhe, madje, edhe kulturo-historike të këtij vendi ballkanik, sikurse edhe rregullimin e tij shtetëror si republikë.

Në Afrikë ekziston një shtet me emrin: “Republika Qendrore Afrikane”, i cili më parë (deri në vitin 1976) është quajtur: “Mbretëria Qendrore Afrikane”, prandaj emërtimi i një shteti evropian dhe ballkanik sipas këtij modeli, nuk do të ishte precedent.

Përndryshe, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, e shpallur shtet i pavarur që nga viti 1991, do të vazhdojë udhëtimin e saj nëpër botë si FYROM, ashtu si po ndodh për gati tri dekada.

KRITIKA PËR INTERES PERSONAL

Nga
Xhelal NEZIRI



Kritika ndaj pushtetit dhe qendrave të fuqisë politike është e shëndetshme, në radhë të parë, për vetë ato. Nga kritikant mund të merret orientimi i duhur në politikë, kujtë e manovrave majtas-djathtas, të mësohet shpejtësia e nevojshme e lëvizjes drejt qëllimit dhe të detektohen pjesët jofunksionale të makinerisë politike.

Burrështetasi britanik i Luftës së Dytë Botërore, Winston Churchill, ka thënë se kritika për politikën është si dhimbja në trupin e njeriut - sado e pakëndshme që është, dhimbja është e dobishme pasi alarmon se një pjesë e trupit nuk funksionon si duhet. Kritika bëhet kur kemi të bëjmë me devijim nga principet, normat apo etikën e funksionimit të një shoqërie, komuniteti apo shteti. E njëjta ka për qëllim esullimin e atyre që kanë marrë fuqinë e legjitimitetit

Por, ka një dukuri që e dobëson fuqinë e kritikës. E devalvon duke e bërë joefikase dhe të neveritshme. E bën kritikën më të gërditshme se vetë devijimet e politikës

duke propaganduar qëllime dhe parime, të cilat i harrojnë apo shkelin për interesat e tyre personale. Pra, kur kemi të bëjmë me shitjen e idealit të përgjithshëm për përfitime personale apo klanore.

Por, ka një dukuri që e dobëson fuqinë e kritikës. E devalvon duke e bërë joefikase dhe të neveritshme. E bën kritikën më të gërditshme se

vetë devijimet e politikës. E shndëron në një zhurmë shurdhuese dhe të bezdisshme. Kjo dukuri është kritika e udhëhequr nga interesi personal. Kjo lloj kritike është shumë më e dëmshme sesa veprimi i devijuar që kritikohet. Ajo nuk ka peshë pasi vjen nga njerëz që kanë heshtur në kohët kur është dashur të jenë të zëshëm për shkak të përfitimit që kanë pasur nga heshtja. E bëhen të zëshëm, pra kritikojnë, vetëm kur e shohin se u është ndalur rrjedhja e parave në llogaritë personale.

Ky aktivizim i tyre është emotiv, i egër dhe pa limit. Këtu më nuk bëhet fjalë më për kritikë, por për tentim për asgjësimin e atij politikani apo partie politike që nuk i ka kënaqur apetitet e këtyre njerëzve. Ato bëhen agresivë, të pakënaqur nga të gjithë ato që nuk janë në horizontin e tij të përfitimit egoist. Bëhen nihilistë, jotolerantë ndaj

mendimit ndryshe dhe kërkojnë nga rrethi të vihet në shërbim të kauzës së tij, e promovuar si e një rëndësie të madhe për shoqërinë.

I gjithë ky frustrim i këtyre personave apo klaneve shfaqet në formën e kritikës me tendencë asgjësuese personale, e jo me qëllimin e përmirësimit të situatës politike. Dhe i njëjti përfundon kur personi/klani të marrë shpërblimin e kërkuar në formë pushteti, kandidature, funksioni, tenderi apo rehatimi. Këto kritika egocentrike dhe jo të sinqerta, në fakt, janë virusi më i rrezikshëm për debatin publik dhe demokracinë. Në këtë mënyrë kritikantat përgjithësohen si shantazhe për përfitime personale/klanore, si kërkesë shpërblimi për një një gurë të hedhur në protestë apo si hakmarrje për mosdhënien e një funksioni të dëshiruar.

Politikani amerikan i viteve të 20-ta të shekullit të kaluar, Frank

A. Clark, thotë se kritika duhet t'u ngajë goditjeve të pikave të shiut mbi trungun e një peme të njomëta ujit atë, por pa ia dëmtuar gjethet apo rrënjët.

Tani kur kemi afër një zgjidhje për emrin del në pah kjo kritikë e interesit personal, e kamufluar si e interesit të përgjithshëm. Nëse je pjesë e qeverisë, e tryezës së begatë të pushtetit, atëherë i përkrah edhe propozimet. Nëse je jashtë, i hedh poshtë pa ndonjë analizë më të detajuar. Vendime që, edhe në rastin e parë a sidomos në të dytin, bazohen në butësinë e kolltukut e jo fuqinë e argumentit.

Në kohën e lajmeve të rrejshme dhe portaleve fantome, kritika që buron nga egoja është një tjetër dukuri e padukshme, por njëjtë e rrezikshme për demokracinë. Edhe ky problem është çështje e etikës dhe nuk mund të rregullohet me ligj. Fatkeqësisht! (KDPolitik.com)



Koha, e martë 22 maj, 2018



Agron Tufa: Po ra gjuha, bie struktura e kombit

Duke marrë shembullin e revolucionit në veri të Sirisë, të shtunën ka nisur paneli i diskutimit që si temë kishte "Ndërtimi i shoqërive progresive: Gratë në revolucionin e Rojavas". Fillimisht moderatorja Svetlana Rakoçević ka marrë shembull revolucionin që deri tash nuk ka dhënë ndonjë rezultat tek populli kurd. Ajo ka shpjeguar sesi kurdët nuk ia kanë dalë qysh prej viteve '70 të arrijnë pikësynimin e tyre, shtetin e pavarur, shkruan "Koha Ditore". "Një vend nuk mund të jetë i lirë pa gruan e lirë", ka thënë ajo. Sipas Rakoçević, të paktën në përbërje prej 40 për qind gratë duhet të jenë pjesë e institucioneve të një vendi. Debatit ka vazhduar me pikëpamjet e shkrimtares katalunase Laura Huerga. Katalonasit nuk ia kanë dalë që të pavarësohen nga Spanja nëpërmjet referendumit që ishte mbajtur para disa muajsh. Huerga ka thënë se ka edhe slogane se Katalonja duhet të jetë një republikë feministe. "Ne po na quajnë gati terroristë", ka thënë ajo. Shkrimtari shqiptar, Agron Tufa më shumë është ndalur tek modelet e kombeve. Ka thënë se ekziston një komb qytetar siç e ka Franca, ku të gjithë janë bashkuar për të jetuar nën një ombrellë dhe ai gjerman ku nacionalizmi është në nivel më të lartë. "Tek shqiptarët gjuha është element ndër më kryesorët. Nëse bie ky element atëherë struktura bie. Unë mendoj se ku u bë shteti me ligjet e veta, gratë shpëtuan nga tradita apo edhe feja", ka thënë ai. E anëtarja e Lëvizjes Vetëvendosje, Tinka Kurti, ka thënë se para luftës në Kosovë, aktivistet e shoqërisë civile besonin se me lirinë do të vinte edhe barazia midis gjinive. Sipas saj, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe duhet të punohet shumë në këtë drejtim. Sa i përket nacionalizmit, ka thënë se jo gjithmonë ai është i dëmshëm për një shoqëri. E shkrimtari shqiptar, Bashkim Shehu i cili jeton në Barcelonë, ka thënë se identiteti katalonjas zë vend fillimisht tek gjuha e pastaj shtrihet në rrafshet e tjera kulturore.


FAIK KONICA, GJONI I KRUIJËS DHE DY ROMANE TË PANJOHURA

Sa herë që flitet për Faik Konicën ka gjithmonë kuriozitet dhe interes, ndaj, në festivalin Ditënetët e Librit, në stendën e shtëpisë botuese "Zenit" në MHK, ishte njoftuar një aktivitet mbi njohjen e dy romaneve të këtij autori.

Aty u fol mbi Faik Koncën dhe dy romanet e tij zbuluar pas 100 vitesh dhe sjellë në shqip. Profili i tij si botues, shtypshkrues, bibliofil koleksionist e hulumtues e hartues i mjaft simboleve heraldike kombëtare.

"Në këtë libër përfshihen dy romane të Faik Konicës, "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri dhe Mitka", të cilat deri pak kohë më parë e kanë pasur jetën e tyre në gjuhën frënge, ku autori ishte me pseudonimin "Jean de Kroia" ose Gjoni i Krujës. Falë punës kërkimore dhe përkthimit të bërë nga Fotaq Andrea, këto dy romane janë bërë pjesë e letërsisë shqipe. Edhe këto dy romane rrisin vlerat e Konicës dhe shndërrohen ikona të letrave tona" - tha Krenar Zejno.

Romanet, që duhet të jenë shkruar në vitin 1909, në bazë të një analize të fakteve, janë botuar në vitin 1911, në Paris, në një vëllim të vetëm, me titullin përmbledhës "Le mariage de Leila" (Martesa e Lejlës), shtypur nga një shtypshk-



ronjë e vogël, gjë që shpjegon edhe tirazhin e saj tepër të kufizuar, aq sa edhe Biblioteka Kombëtare e Francës, nga më të pasurat në botë, nuk e disponon një libër të tillë me tematikë të mirëfilltë shqiptare!

Në kopertinën e pasme të librit përmbledhës të dy veprave, shkruhet: "Dy romane misterioze- Dy ikona të Letrave shqipe". Mandej jepen të dhëna mbi secilin.

"MARTESA E LEJLËS- Të njëzet kapitujt e kësaj pastoraleje dashurore shkojnë në fjalë, pa përplasje as

pengesë, rrjedhin si një burim me ujë kristalor drejt një zgjidhjeje të dëshiruar, duke përbërë në tërësinë e tyre një akt të lartë, tek vërtetojnë (gjë e rrallë sot) që një roman mund të jetë interesant duke mbetur i ndershëm; ndërsa sa i takon pjesës "SOTIRI DHE MITKA" vihet në dukje se "është një tregim i shpejtë që të mban të lidhur dhe që fillon në Amerikë për të përfunduar në Shqipëri.

Mund të themi se kemi të bëjmë me një novelë të shekullit XVII, aq shumë janë pikturuar e treguar me hollësi e delikatesë portretet e dy miqve... ku jeta e re buthton, zhvillohet, shpaloset në rritje të shpejtë, gjersa dramatozohet më në fund nëpërmjet një rrethane të llahtarshme e tragjike, për të përfunduar siç duhet... lumturisht". Të dyja këto shënime, janë të Edmond de Gabory, për "L'Avenir d'Arcachon", më 8 tetor 1911.

Fotaq Andrea para se të merret me analizën e ideve dhe anës artistike të romaneve "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri dhe Mitka", sqaron sesi ra në gjurmë, dhe si i gjeti e i bleu këto dy vepra të mbledhura brenda dy kapakësh në një dyqan librash të vjetër në Belgjikë. Personazhet personifikojnë të

afërm të rrethit familjar të Konicës (por edhe atë vetë), krahas një morie personazhesh skenikë që Konica i ka pasur miq apo i ka njohur nga afër. Fotaq Andrea vëren se në romane autori ka vënë si personazhe të afërmit e tij, nga mbesa te e ëma, madje, një prej personazheve, është vetë ai.

Te "Martesa e Lejlës", Andrea thotë se (personazhi kryesor Lejla), është mbesa e shkrimtarit, e bija e vëllait të tij, Mehmet Konicës. Në roman përfshihen edhe nëna e Faik Konicës- Zeliha Delvina (Konica), vetë Faiku si personazhi Vangjel, ose princi Aladro Kastrioti - pasardhësi i Gjergj Kastriotit që pretendonte fronin e Shqipërisë, personazh pozitiv që gjendet në të dy romanet. Te romani tjetër, "Sotiri dhe Mitka", personazhi kryesor është Dominiku, i cili ka në fakt emrin e pagëzimit në fenë katolike të vetë Faik Konicës. Ky personazh sipas Andreas, pasi ka kryer studimet në Vjenë e Paris, kthehet në vendlindje në Vlorë dhe ngre fabrikën e parë të industrisë vajore. "Ekrem bej - është me gjasa Eqerem bej Vlora në rini", thotë Andrea, duke shtuar se Sotiri dhe Mitka janë emra krejt të zakonshëm shqiptarësh që mërguan nga Korça për në Amerikë, e po aty ka edhe emra Gjergj, Guri, Trifona, Trimi./Gazeta "Dita"

Artistë shqiptarë në ekspozitën "Join Dots" në Trieste

Një fije e kuqe e artit bashkëkohor që bashkon Mesdheun, Ballkanin dhe Lindjen e Mesme takohen në Trieste për ekspozitën "Join Dots" (Bashkojmë Pikat) për të njohur nga afër realitetet artistike nga e gjithë bota.

Mbi 6300 artistë kanë menduar të sjellin në këtë ekspozitë të përbashkët, artin dhe dialogun e tyre bashkëkohor, mes të cilëve edhe 163 shqiptarë.

Projekti që mban titullin "Imago Mundi", që në thelb sjell pak aromë nga e gjithë bota, kërkon të bëjë bashkë kulturat e ndryshme të konceptuara në 40 koleksione.

Realitetet imagjinare të pellgut të Mesdheut, frymëzimet nordike, legjendat e bukura të Danubit blu, ngjyrat e ndritura të



Lindjes së Mesme: një paraqitje e shkurtër e botës, gjestet e mijëra artistëve, të mbledhur së bashku në ekspozitën "Join the Dots", janë ato çka vijnë përmes këtij koleksioni.

Një itinerar i pashembullt i detit dhe tokës, do të mund të shihet në "Salone degli Incanti", nga 29 maji deri më 2 shtator 2018.

Ndër vendet që do të marrin pjesë në këtë ekspozitë janë: Sh-

qipëria, Algjeria, Austria, Belgjika, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Campania, Kroacia, Qipro, Çekia, Egjipti, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Iraku, Izraeli, Libia, Lituania, Maqedonia, Mali i Zi, Maroku, Holanda, Palestina, Polonia, Portugalia, Rumania, Serbia, Sicilia, Sllovenia, Sllovakia, Spanja, Siria, Tunizia, Turqia, Ukraina.

"Imago Mundi" është një projekt global, demokratik që duket në horizonte të reja në emër të bashkimit dhe bashkëjetesës së diversiteteve shprehëse të kohës sonë. Qëllimi i projektit është promovimi, hulumtimi dhe njohja e realiteteve artistike nga e gjithë bota dhe, mbi të gjitha, dialogu midis kulturave të ndryshme. /ATSH

Ai qante për të tjerët, vetes i luste vdekjen

Para nesh ngrihet si një Himalajë madhështore vargu i lirikës së Frederik Rshpes, mbase më i madhi lirik shqiptar në poezinë shqipe. Poezia e tij është brilante. Vargjet që të drithërojnë mbartin mbi vete realitetin tronditës të jetës së tij të vështirë, të papajtueshme asnjëherë me të rëndomtën.

Poeti Visar Zhiti shprehet për Reshpen: "... ky antikformist galant". Poezia e tij është një nga shprehjet më të thella të shpirtit poetik në shqip. Ungareti thoshte: "Poezia është poezi, vetëm nëse dikush duke e dëgjuar ndjehet menjëherë i goditur së brendshmi... Eksplorimi poetik është eksplorimi personal i një gjendjeje të vazhdueshme ferri... Vetëm në poezi mund të gjendet liria".

Lirika e Reshpes të kujton Esenin kur thoshte: "Që të jesh poet do të thotë që të plagosësh veten kurdoherë dhe me gjak të ndjenjave tuaja të ledhatosh në shpirt të tjerët". Vargu i Reshpes është kënaqësi që kthehet në dhimbje, është lot që shndërrohet në këngë, ndjesi që bëhet figurë, figurë që kthehet në simbol. Tematika e poezive të tij është përgjithësisht e trishtë, por e realizuar bukur, përmes detajeve të gjetura dhe të dhëna me kursim.

Parafytyrat e lirikave të Reshpes janë "fotografi" marramendëse për të cilat edhe nëse nuk je profesionist i sferës, mund të kapësh lehtë detajin, finesën, shijen, imazhin. Poezia e tij është krejtësisht e "mbytur" në figuracion poetik, që ndonjëherë ngjan si tragjizëm i artit antik grek.

Kadare në veprën "Mëngjeset në Kafe Rostand-motive nga Parisi", shkruan: "Frederik Reshpja, poet i shumë vargjeve brilante e befasuese...". Edhe kur shkruan për dashurinë e humbur apo të braktisur, Reshpja nuk kalon në dramizëm apo tragjizëm, përkundrazi poezia e tij merr ngjyra malli njerëzor. Poezia e tij del nga shpirti e i flet shpirtave, ashtu siç thoshte Hegeli "vjen nga shpirti dhe ka destinim shpirtin". Ai të kujton endacakun e Ungaretit.

Vetmia e tij ishte proverbiale. Ajo ishte e tillë siç thoshte Dymas: "Arti i madh ka nevojë o për vetminë, o për mizerjen, o për pasionin". Reshpja i pati të tria. Dritëhijet më të holla dhe më të thella të shpirtit njerëzor, ai i transfiguron në art. Në një poezi të ndërjerë deri në lodhje, përsërit disa herë si në një refren se është "i mallkuar me art". Ndonjëherë pushoi edhe së marruri frymë prej tij.

Sa rrugëtonte midis jvsh, rilindte përmes vargjeve që e yjzonin. Nuk mund të kishte në tokë vend për dy palë të tillë poetë, njëri duhej të ishte, natyrisht gjeniu i vargut, Frederik Reshpja. Donin ta shtypnin, ta deformonin, por në të vërtetë gdhendën tek ai tipare e fizionomi fisnike e trimërore. Ai qante për të tjerët, vetes i luste vdekjen.

Mund ta krahasojmë pa frikë me Bodlerin, Blejkun, Rembonë. I zaptuar nga poezia, ajo e kapte për dore e s'dihet se ku e çonte. Magma e krijimtarisë së tij është dhimbja. Ai nuk sajoi poezi, poezia materializohej përmes tij. Reshpja është një prej atyre poetëve që nuk kishin lindur për të jetuar në tokë, por ndërmjet yjeve të qiellit. Atij i shkon më së miri sentenca latine: "Primus inter paris"- I pari ndër të parët. Reshpja, si thotë edhe Marian Shestani në biografinë kushtuar këtij të fundit, mbeti deri në fund të jetës në një ngrysjë ekonomike e shpirtërore. Ai ishte modest në një kohë që kishte të drejtë ta mbyllte veprën e vet me fjalët e Horacit: "Exegi monumentum"- I ngrita vetes monumentin. Ndërsa ne na vjen ndër mend shprehja në latinisht e Krishtit: "Post fatam resurgam"- Pas vdekjes do të ringjallem. Reshpja pas vdekjes u kthye në legjendë.

Ndërroi jetë në moshën 66 vjeçare, i braktisur dhe në një varfëri të skajshme.



FREDERIK RRESHPJA

DASHURI E HUMBUR

*Dola nga guernika e kësaj nate
I vvarë egërsisht,
Kali i zi i pikëllimit
Në shtegun e vjetër më priste.
Kali i zi i pikëllimit ç'më rrëzoi
Dhe rashë si në ballada;
Gdhendur në gravurat e vjetra,
Përmbys mbi shaytin e natës.
I vvarë nga një pranverë e kotë,
Braktisur nga bota e tërë,
Vetëm kali i zi i pikëllimit vjen rrotull
Dhe qan për të zotin e vjetër.*

CAKU

*Të vdekurve u veshin këpucë të reja,
se duhet të shkelin në udhë pa krye,
mirazh shkretëtire në rendje pa fund,
pa semaforë e vija të bardha e shtylla,
pa policë trafikë e manekinë mode,
pa kalimtarë në sens të kundërt si duna,
për gjetjen e orës, adresës së saktë.
Mbi kalldrëme shtruar me gurë sizifi
trokasin shojet e ngrëna si patkoj kuajsh,
ciasin gomat si në përplasje veturash,
thyhet njëqind copash pasqyra e lustrës.
O sa këpucë të reja u shitën sivjet!
Ata shqiptojnë një fjalë ndërkombëtare,
non stop-in rraskapitës me theks modern,
në maloren si thikë, pa ndalesa biblike,
pa pemë, pa zogj lajmëtarë si dekor.
Poshtë lart majtas djathtas para mbrapa—qiell,
me engjëj merramendës, me djaj rrëshqitës,
sipas rregullave të qarkullimit të Dantes.
Shohin dyzimin e tyre mbi pluhur këpucësh
që tingëllojnë si një kor antik në boshllëk,
gjersa lëkura çahet, këmba rri zbatthur.
I largët është caku të mbërrihet tek Zoti,
me labirinthin e shpresës vetvetiu hapur.*

TESTAMENT

*Që fëmijë e kam kuptuar se kisha lindur
i mallkuar me art.
Gjërat i shihja ndryshe:
Nëpër shirat e vdekur peshqit fluturonin drejt
Çerdheve, te yjet. Në vend të borës binin zogj
Në çdo dru.
Era si ketër brente degët.
Qante mbi mua nëna, shënmëria ime. Ave nëna ime!
Mos e pastë njeri këtë fat!
Kam dashuruar një Afërditë në Olimp
e trëndafilave.
Pastaj erdhe ti tërë ikje.
Më vonë vije vetëm nëpër ëndrra, si perënditë ilire.
Kështu iku edhe rinia, filigrani i djalërisë,
i mallkuar me art.*

*Mos e pastë njeri këtë fat!
Tani që po vdes ëndërroj vetëm një kryq te koka
dhe të harrohem se nuk dua që edhe pas vdekjes
të më ndjekë mallkimi i artit.
Mos e pastë njeri këtë fat!
Po kur të vdes portreti im ka për t'u shfaqur nëpër gjethë,
se unë kam patur miqësi me çdo dru.
Në stinën kur bien gjethet
do të bien edhe sytë e mi.
Tani e tutje shirat do jenë lotët e mi.
Mos e pastë njeri këtë fat!*

RAPSODI

*Shqipëri, kur të dëgjojë kushtrimin tënd,
Portreti im u shpëradafte në vjeshtë dhe në hënë,
Bronxi i vdekjes sime do të kthehet përsëri te mineralet
Ku vringëllinjë armët e Lirisë.
Tokë e dashur, ku prehen ështrat e martirëve
Dhe fle mermeri i perendive ilire,
Tokë e miteve dhe e kështjellave të pafundme,
Zërin tim bëj kurorë për ty, enise!*

*Fole e fluturimeve të mia
Që asnjë qiell tjetër i botës nuk i zë,
Zëri im bie në gjuhë para teje,
Enise, enise!*

FËMINIA

*Aso kohe edhe ngjyrat ishin shpirta.
Në fund të kopshtit banonte mitologjia
Në një olimp prej trëndafilash.
Këndonin lulet dhe tregonin legjenda.
O! Tërë trëndafilave të botës do t'i bie në gjuhë,
Por ato legjenda s'kam për t'i dëgjuar më kurrë.
Yjet bëheshin trishtila në dritare,
Ngjyer me magjinë e pyjeve të largët.*

*Por fluturuan ato yje cicëronjës,
Yje tjerë u ngritën mbi kubënë e kohës
Dhe olimpian e trëndafilave e humba përgjithnjë,
Si perënditë e rrëzuara ilire.*

NATË

*Flenë fluturimet mbi drurë
flenë rrufetë në thellësi të reve;
Fusha ul supin te era.
Gjithkush e ka një dhembje ku të mbështesë kryet.
Gjithkush e ka një mall që vizatohet si vinjete
mbi gjumin e botës.
Por vjen ti dhe më zgjon te supi
çdo natë me rrëmbim.
Ah, s'e dija që gishtat e kujtimit
mund të shndërroheshin kështu, në thikë...*

Misteri i një qyteti në thrillerin psikologjik të Dolores Redondo

Vjen në shqip romani i famshëm i Dolores Redondo, "Rojtari i Padukshëm", përkthyer në shqip nga Diana Çuli, botimet IDK. Një thriller psikologjik që ka patur një sukses të jashtëzakonshëm në mbarë botën, duke u bërë bestseller për shumë muaj me radhë. Në qendër të tij një inspektore policie që kthehet në qytetin e saj të lindjes, për të zgjidhur një seri vrasjesh të mistershme.

Një thriller psikologjik që ka patur një sukses të jashtëzakonshëm në mbarë botën, duke u bërë bestselleri për shumë muaj me radhë. Në qendër të tij një inspektore policie që kthehet në qytetin e saj të lindjes, për të zgjidhur një seri vrasjesh të mistershme.

Kur trupi i një adoleshenteje gjendet në një vend të largët buzë një lumi, krimi duket krejt i ngjashëm me një tjetër vrasje të ndodhur veç pak muaj më parë, duke ngjallur frikë në bashkësinë e Elizondos. Për ta hetuar caktohet inspektoria Amaia Salazar, që e njeh më mirë se kushdo atë vend, sa i bukur aq dhe i izoluar, toka e të cilin dikur qe nginjur me gjakun e derdhur prej Inkuizionit, ku pas lustrës së modernitetit, vazhdojnë të




mbijetojnë besimet pagane. Dhe kështu, teksa numri i vrasjeve shtohet, ndër vendasit nis të përhapet fjala se ato s'janë vepër e dorës së një njeriu, por e një krijese të mitologjisë baste të njohur me emrin basajuan, apo Rojtari i Padukshëm. Amaia është profesioniste dhe s'pranon që besëtytnitë ta shpërqendrojnë nga detyra, por ndërsa hetimet thellohen, asaj befas nis t'i duket sikur çdo siguri që ka pasur nis të shkërmoqet: ankthe të vjetra që

zgjohen, sekrete që ajo shpresonte t'i kishte harruar, tashmë rikthehen, a thua se në një mënyrë të mistershme të kenë lidhje me vrasjet. Për ta zgjidhur këtë rast, Amaias i duhet të përballlet me anën e errët të shpirtit të vet, duke vënë në dyshim gjithçka që deri atëherë kishte besuar, teksa ndjek gjurmët e vrasësit nëpër shtigjet e ngatërruara të legjendave të lashta që flasin për ekzistencën e një fuqie atavike të pamposhtur...

Tashmë Amaias i duhet të luftojë me demonët brenda vetes së saj për të zbuluar nëse autori i vrasjeve është vërtet një vrasës serial, apo diçka tjetër më e errët...

Dolores Redondo, lindur më 1969, studioi drejtësi, pastaj gastronomi, duke hapur dhe një restorant me kuzhinë baste. Sot, në sajë të suksesit të jashtëzakonshëm të romanit të saj 'Rojtari i padukshëm' dhe, më në përgjithësi, të 'Trilogjisë së Baztanit', ajo është një ndër shkrimtarët më të famshme spanjolle, e përkthyer në mbarë botën.

Romani i saj 'Rojtari i Padukshëm' është bërë film nga i njëjti producent i 'Milenium' bazuar në romanin e Stieg Larsson-it.



Dostojevski i përkthyer në burgun e Burrelit

Asht i pari përkthim i babës që botohet, mbasi u vetëdijësua për randësinë e tyre kur shpëtuen nga përmytja e dhjetorit 2010. Tuj i pa herëmbasheret, ishte njohja dhe këshillë-mësimet e Astrit Canit që m'nxitën me u marrë me to gjallnisht. Leximi i herëmbashershem tuj i hedhë në kompjuter, rishikimet, ndonjë presje, frazeologjia, kaligrafia, të tana kanë kenë një lloj përsiatjeje e vazhdueshme e raportit që ka njeriu me gërmën: dhe rasti-mbret don që ky njeri t'i shte im at dhe m'u skalit në mbrendi bash ky raport i tij, në kushtet e burgimit. Për qasjen e ndërtime për si me e ba parathanien m'ka vye fort urtia e paqtë që m'ka dhanë me bujari Edin Q. Lohja. Si kapak, shpreh mirënjohjen teme për znj. Brikena Çabej që bani të mujtun këtë botim. Afërmendsh mirënjohje për emnencën gri që ishte Anna(Shkreli), me tanë inxhinierinë editoriale që ka në krye".

Sait Saiti i ka përzgjedh' fjalët një e nga një, si në një kërkim thesari për të përcjellë shkurtimisht, historinë e atij që është një dorëshkrim i vyem, i rrujtun në dy kohë e tri situata: nga bodrumet e errëta të burgjeve komuniste, në bodrumet e errëta gjatë komunizmit e mandej nga përmytja e vitit 2010-ës. Nuk është vetëm një dorëshkrim e një përkthim i çfarëdoshëm, është dorëshkrimi i përkthimit të babës—është në një farë mënyre historia e tij, e jeta e tij mes bodrumesh, burgjesh e kthinash t'u ju fshehë dëshirës për liri. Ma shumë se historia 40 vjet pas kohës ku fjalët pas fjalë Dostojevski fliste shqipen e Nazmi Saitit, një gegnishte e amël, libri i shkruem me dorë, tani është radhit, është redaktu, faqos e me logon e Botimeve "Çabej", udhëtimin e parë e ka kry në Prishtinë.

Tirana ende do presë për promovimin e një vepre të veçantë. "Përkthimi i saj asht ba në kushte edhe ma të skajshme nga ç'kuptohet me amulli: përkthyesi e ka tejbartë nga ruishtja në standardin me bazë gegnishten gjatë kohës që viente dënimin në burgun e Burrelit, më 1978. Prezantimin do ta bajnë Sait Saiti, i biri i përkthyesit, me një sprovë trajtuese të përkthimit në kushtet e një regjimi totalitar—dhe posaçërisht në realitetin e regjimit komunist në Shqipni, tuj përshkrue elemente nga elementët biografikë të përkthyesit dhe qasjet e tij mbi gjuhën", shënon faqja zyrtare e Botimeve "Çabej". Ka mes autorit e përkthyesit si autor i dytë në një gjuhë të re—një përkim të dhembshëm në dy kohë e në dy botë—Dostojevski "u çmend" prej burgimit dhe ky përkthim vjen po në po atë mënyrë të çmendun, ma shumë se ironik asht diktues i njëfarë fatum-i a kismet... për të cilin sekush asht i ftuem me e zbulu. Anna Shkreli (më lart e referuar nga Saiti si emnencia gri)nga botimet "Çabej", në kushtimin e saj për librin, thotë se është një libër më i pabindur se 'ti', e përemri në këtë rast asht edhe në shumë.

"Nëse do rekomandoja një libër padyshim do ishte ky. Më ka goditur në stomak më fort se grushti. Nuk e di nëse kjo që shkruaj është faktikisht publicitet, po në këtë pikë s'më intereson kështu që: Për të gjithë ata që leximin nuk e kanë escapism të pastër po i "pëlqen me vujt", pra me u rrit... ja ku është. Gëlltiteni". Vepra është përkthyer nga Nazim Saiti gjatë kohës kur vuanë dënimin për AGJITACION e PROPAGANDË në Burgun e Burrelit. Burgu i Burrelit duhet t'i ketë përkthyer përkthyesit me Bodrumin e Dostojevskit, duke mëtuar kësioj errësirën, mungesën e lirisë apo mungesën e kushteve minimale të jetesës. Pra, vetë bodrumin a burgun e madh në të cilin ishte shndërruar Shqipëria e kohës./GSH

Përkthimet e Selfos nën presionin e vdekjes


Nga Guliveri shqiptar te robinsonada e përkthimit: me 'Djemtë e rrugës Pal', "Rreth botës për 80 minuta". Zor se një fjali ia del të përmbledhë jetën e stuhishme të një 46-vjeçari, që kur u nda nga jeta la pas tre fëmijë të mitur dhe 50 vepra të përkthyer.

Vetëm "Udhëtimet e Guliverit", ndër vise të largëta të dheut, i përkthyer nga Halit Selfo, që qe botuar nga Ndërmarrja Shtetërore e Botimeve në Tiranë më 1958 e pati tirazhin 10 mijë kopje.

Ai kishte përkthyer nga disa gjuhë, frëngjishtja, italishtja, anglishtja, ndaj kishte shqipëruar "Zemra" të De Amicis, "Djemtë e rrugës Pal" të Ferenc Molnar, "Udhëtimet e Guliverit", "Konti i Monte Kristos" të Dymasë dhe një seri veprash të Zhyl Vernit, nisur nga "Djemtë e rrugës Pal".

Në shtëpizën e vogël ku jetonte, kishte marrë edhe familjen e së shoqes, edhe ajo e përndjekur politike. Jetonin 10 veta në një dhomë, ndaj shpesh, kur Halit Selfo donte qetësi, e kishte zakon të shkonte në hotel Vollga, të merrte një dhomë e të përkthente si duhej, kur dhimbjet e linin.

"Kur përktheu '20 mijë lega nën det' kishte specie që nuk i njihte. Haliti shkoi në Durrës e gjeti peshkatarë të vjetër, foli me ta gjerë e gjatë, derisa sa mësoi ç'i duhej për detin. Përktheu 50 vepra para se të vdiste, të fundit e përktheu me dhimbjen e katër tumoreve në kokë, ashtu i qetë, i



pafjalë". Përshkrimet e Diana Omarit, kunatës që Haliti e pat marrë në shtëpinë e tij dhe e pat rritur, të flasin për një burrë që përkthente e punonte, sikur gjithë dhimbja e botës, të fashitej vetëm prej punës. Atëkohë, ia patën pushkatuar dy vëllezër, e njërin, për bombën në Legatën Jugosllave. Ditën pas pushkatimit, Haliti kish vënë një kravatë të kuqe, e kish shkuar në punë, duke i pritur ngushëllimet me fjalën "mirëmëngjes". Por dhimbja e shtrënguar fort vetëm për vete, e mundi shpejt dhe ai ndërroi jetë në moshën 46-vjeçare. Sapo kish dorëzuar "Kontin e Monte Kristos" për botim.

Ai kishte lindur më 1918 në një familje tregtarësh gjirokastritë. Kishte ndjekur Liceun Francez në qytetin e Korçës, e mandej pat shkuar të kryente studimet e larta në Padova për Eko-

nomi-Biznes. Pushtimi fashist i Shqipërisë e detyroi të kthehej në atdhe dhe të merrte pjesë në luftën antifashiste. Pas çlirimit pat punuar redaktor në gazetën ushtarake "Luftëtari". U burgos si "Armik i Popullit" dhe e vuajti dënimin në burgun e në kampin famëkeq të Maliqit. Pas lirimit nisi përkthimet e letërsisë botërore, fillimisht si punonjës i jashtëm i ndërmarrjes "Naim Frashëri" dhe më pas i përhershëm. Sot renditet ndër mjeshtrit e përkthimit mes Sotir Cacit, Vedat Kokonës, Spiro Çomorës etj. Në 100 vjetorin e lindjes së tij, "Botimet Zenit" kanë risjellë veprat e Selfos dhe një përkujtimore që u mbajt në stendën e Zenit, në Festivalin "Ditënetët e Librit" që u mbajt në Muzeun Historik Kombëtar (16-20 maj)./Gazeta Shqiptare

Beogradi mund ta rinisë trenin "Kosova është Serbi"

Të gjitha punët dekorative për trenin "Kosova është Serbi", që është dashur të qarkullonte në relacionin Beograd-Mitrovicë, kanë kushtuar 498 mijë dinarë (rreth 4.000 euro), ka deklaruar zëvendësdrjetori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Du-

shan Kozarev. Ai ka vlerësuar se ky çmim është simbolik dhe se ky tren ka mundur të jetë një gjë e bukur për Serbinë, sidomos për të rinjtë. "Fakti se diku nuk i pëlqen mesazhi, nuk do të thotë se ne nuk do ta përsërisim... Kosova për ne gjithmonë do të jetë zem-

ra e Serbisë", citon b92 të ketë thënë Kozarev dhe duke raportuar për punën e Zyrës për Kosovën në vitin 2017. Treni me mbishkrimet në 21 gjuhë "Kosova është Serbi", më 14 janar 2017 ishte nisur nga Beogradi për në Kosovë. Pas parajshmëri me



nga Qeveria e Kosovës se atij nuk do t'i lejohej hyrja në territorin e saj, treni ishte ndaluar në stacio-

nin e fundit afër kufirit me Kosovën, në Rashkë dhe ishte kthyer në Beograd.

Pika e fundit për të cilën foli Kurti ka të bëjë më personat që do ta drejtojnë këtë proces, duke thënë se në asnjë rast ata nuk duhet të jenë presidenti Hashim Thaçi apo ish-ministria për dialog, Edita Tahiri

Lëvizja Vetëvendosje propozoi një plan për institucionet e Kosovës për procesin e dialogut me Serbinë. Kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, e prezantoi atë që Vetëvendosje e quajti "Plan 4+1". Kurti tha se e vetmja formë për të pasur një përfundim të mirëfilltë të këtij procesi është implementimi i propozimit të Vetëvendosjes që përmban këto pika:

1) Të bëhet bilansi shtetëror i dialogut 2011-2017: të raportohet në Kuvend dhe të ketë debat parlamentar;

VV PROPOZON PLAN PËR DIALOGUN MES KOSOVËS E SERBISË



2) Të realizohet dialogu i brendshëm, i hapur e demokratik, në institucione dhe shoqëri. Debate në Kuvend para dialogut e për dialogun me Serbinë, për parimet dhe agjendën, për qëllimet dhe formatin;

3) Të zhvillohet një dialog me Bashkimin Evropian për dialogun me Serbinë, për natyrën, përmbajtjen dhe qëllimin e atij dialogu;

4) Të ketë pajtim që të mos ketë asnjë shmangie në Kosovë nga prioritetizimi i punësimit dhe drejtësisë, si

dhe nga dialogu me serbët e Kosovës dhe pakicat tjera për zhvillim.

Pika e fundit për të cilën foli Kurti ka të bëjë më personat që do ta drejtojnë këtë proces, duke thënë se në asnjë rast ata nuk duhet të jenë presidenti Hashim Thaçi apo ish-ministria për dialog, Edita Tahiri. Kurti e akuzoi presidentin Hashim Thaçi për mosngritje të temës së të pagjeturve dhe të dëmeve të luftës në bisedime. Drejtuesi i Lëvizjes Vetëvendosje po ashtu tha se presidenti Thaçi për gjashtë vjet e heshti çështjen e krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit të Serbisë në Kosovë dhe nuk e paditi Serbinë për to.



Haradinaj në Vatikan te Papa

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, është nisur për një vizitë në Vatikan. Lajmin për Koha.net e kanë konfirmuar nga zyra e kryeministrit, ndërsa është thënë se Haradinaj do të pritë në audiencë nga Papa Françesku. Gjithashtu, portali ka mësuar se Haradinaj do të takohet edhe me Sekretarin e shtetit të Vatikanit, Paul Richard Gallagher.

Publicitet



Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për kulturë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98; 49/03; 82/05; 24/07; 116/10; 47/11; 51/11; 136/12; 23/13; 187/13; 44/14; 61/15; 154/15, 39/16 dhe 11/18), Kryetari i Qytetit të Shkupit publikon

SHPALLJE PUBLIKE për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit Publik „Qendra informative kulturore“ – Shkup

- Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;
 - ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave për punë;
 - ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFL IBT – më së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - më së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) – të përfunduar
 - BULATS (BULATS) - më së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) - më së paku nivel B2 (B2)
- Kandidatët janë të obliguar përveç dëshmive për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të deponojnë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
 - Dëshmi për stazh pune
 - Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit
- Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët janë të obliguar ta deponojnë në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri.
- Afati për deponimin e dokumentacionit të nevojshëm është 10 ditë nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.
- Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, i pakompletuar dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet e shpalljen publike deponohen në adresën e mëposhtme:

Institucioni publik „Qendra informative kulturore“ – Këshilli drejtues
(për konkursin)
Adresa e institucionit: rr. „Filipi i parë i Maqedonisë“ p.n.
1000 Shkup, Maqedoni

Kryetari i Qytetit të Shkupit



Republika e Maqedonisë

INSTITUCIONI PUBLIK PËR PËRKUJDESJE TË FËMIJËVE ME PROBLEME SOCIO-EDUKATIVE DHE SJELLJE TË PAHIJSHME SHKUP

Në bazë të nenit 110 e të Ligjit për mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18) dhe rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësim të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe paraqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së udhëheqjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna jo të vërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15), UD Drejtori i IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme socio-edukative dhe sjellje të pahijshme Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 1/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 18 (tetëmbëdhjetë) ofruesve të shërbimeve publike të kategorisë A profesionale (edukatorë) në Institutin publik për përkujdesje të fëmijëve me probleme socio-edukative dhe sjellje të pahijshme në vendet e punës në vijim

- SOZ0303A05014 Edukator – nëpunës i pavarur profesional në USZ të nivelit të pestë, 18 (tetëmbëdhjetë) realizues:
 - Shërbimi për jetesë të përbashkët të fëmijëve me probleme socio-edukative
 - Njësia organizative 1 – 4 (katër) realizues
 - Njësia organizative 2 – 4 (katër) realizues
 - Njësia organizative 3 – 4 (katër) realizues
 - Njësia organizative 4 – 4 (katër) realizues
 - Njësia organizative 5 – 2 (dy) realizues
 - Kushtet e përgjithshme
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Në mënyrë aktive e përdorë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës së rritur,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - Kushtet e posaçme
 - Për nivelin A5 të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (për realizuesit në njësinë organizative 1, njësinë organizative 3, njësinë organizative 4, njësinë organizative 5 – Punë sociale dhe politikë sociale, Psikologji dhe Pedagogji, për njësinë organizative 2 – Punë sociale dhe politikë sociale, Psikologji dhe Defektologji) dhe së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale,
 - Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Kompetencat e përgjithshme të nevojshme të punës në nivel të mesëm:

- Mësim dhe zhvillim,
- Komunikim,
- Rezultate të arritura,
- Punë me të tjerë/punë ekipore,
- Orientim ndaj palëve/palëve të prekuara dhe
- Menaxhim financiar

Orari i kohës së punës:

- Diët e punës: E hënë deri të dielën
- Orët e punës: 40 orë në javë,
- Orari i punës:

- Ndërrimi i parë: prej ora 07:00 deri në ora 14:00,
- Ndërrimi i dytë: prej ora 13:00 deri në ora 20:00,
- Ndërrimi i tretë: prej ora 20:00 deri në ora 07:00

Orari i punës mund të përshtatet në pajtim me nevojat e punëdhënësit.

Neto shuma e pagesës në të holla: 23.197,00 denarë
Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e

ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar ditën e publikimit të shpalljes).

Fletëparaqitja për shpallje mund të merret në arkivin e institucionit ose të merret nga interneti faqja e IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme socio-edukative dhe sjellje të pahijshme – www.domzadeca.mk.

Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike do të informohen për kohën dhe vendin për kontrollim të besueshmërisë së dëshmive dhe realizim të intervistës, në internetin faqen e IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme socio-edukative dhe sjellje të pahijshme – www.domzadeca.mk.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e RM të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen obligohen që të parashtrajnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në original ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrajnë dokumentet e nevojshme për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme:

- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Vërtetim/Certifikatë se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Dëshmi për përvojën përkatëse të punës,
- Dëshmi-diplomë/certifikatë për arsim të mbaruar,
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim për vitin 2018, punësimet parashihen për 9 (nëntë) shqiptarë, 3 (tre) maqedonas, 1 (një) turk, 2 (dy) rom, 1 (një) serb, 1 (një) boshnjak dhe 1 (një) – të tjera.

Dokumentacionin e nevojshëm kandidatët ta parashtrajnë në arkivin e institucionit rr. „Petar Manxhukov“ pn Shkup, me shenjë „Për shpalljen publike 01/2018“

Dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Kontakt telefoni: 02 2 611 016/ 070 244 725,
E-mail adresa: juzdvsp-sk@msp.gov.mk ose violetamasevska@gmail.com

UD DREJTOR
Daniel Aleksovski

Sipas "Bloomberg", ekzistojnë 355 shkrirje, investime apo sipërmarrje të përbashkëta, kushtet e të cilave nuk janë shpalosur. Ndër këto është edhe blerja e aksioneve në vlerën e 9 miliardë dollarëve të "Daimler", prodhuesin e "Mercedes-Benz", nga kompania kineze, "Geely Holding". Duke e ndarë në kategori, firmat kineze kanë zotërimi kryesisht në: skuadra futbollit, aeroporte, porte detare, nxjerrjen e naftës, energjinë e rinovueshme, centrale bërthamore dhe prona të paluajtshme. Blerjet janë më të dukshme në Britani, ku firmat kineze zotërojnë 7 ekipe futbollit dhe një numër të madh të pronave të paluajtshme në qendrën financiare të Londrës

KINA BLEN EUROPËN



përmasën e vërtetë të ambicieve të Kinës në Europë.

Sipas "Bloomberg", ekzistojnë 355 shkrirje, investime apo sipërmarrje të përbashkëta, kushtet e të cilave nuk janë shpalosur. Ndër këto është edhe blerja e aksioneve në vlerën e 9 miliardë dollarëve të "Daimler", prodhuesin e "Mercedes-Benz", nga kompania kineze, "Geely Holding". Duke e ndarë në kategori, firmat kineze kanë zotërimi kryesisht në: skuadra futbollit, aeroporte, porte detare, nxjerrjen e naftës, energjinë e rinovueshme, centrale bërthamore dhe prona të paluajtshme. Blerjet janë më të dukshme në Britani, ku firmat kineze zotërojnë 7 ekipe futbollit dhe një numër të madh të pronave të paluajtshme në qendrën financiare të Londrës.

KU ËSHTË PËRQENDRUAR PARAJA KINEZE

Viti më i rëndësishëm për arritjen e ujdivë nga firmat kineze në Europë është 2016-a, ku Korporata Kombëtare e Kimikateve në Kinë, e njohur si "ChemChina", lajmëroi se do të blejë prodhuesin zviceran të pesticideve, "Syngenta", për 46.3 miliardë dollarë. Duke përjashtuar peshën e madhe që zë blerja e "Syngenta",

ekziston një trend rritës në vitet e fundit, në mbi 20 miliardë dollarë çdo vit, pas 2014-ës. Duke përfshirë vetëm marrëveshjet, kushtet financiare të të cilave janë publikuar, mesatarja është dukshëm më e ulët.

Më shumë se gjysma e totalit të investimeve është përqendruar në 5 ekonomitë më të mëdha të Europës, ndërkohë që kinezët kanë marrë pjesë në marrëveshje prej 70 miliardë dollarë vetëm në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, janë vendet periferike ku Kina ka ndërmarrë disa nga investimet më strategjike, si blerja e portit të Pireut në Greqi. Ekziston një ndasi në vendet europiane mbi hapjen ndaj investimeve kineze. Gjermania, Franca dhe Italia kanë bërë thirrje për një mekanizëm të mbikëqyrjes së këtyre investimeve për të gjithë Bashkimin Europian, ndërsa Greqia, Portugalia dhe Qipro, kanë treguar qasje skeptike mbi këtë lëvizje, duke argumentuar se do të cenonte aftësinë e vendeve të tyre për të tërhequr kapitalin.

Në Shtetet e Bashkuara dhe Australi ekziston një mekanizëm i tillë, që shpjegon se pse Europa po "fiton" pjesën më të madhe të investimeve kineze.

Edhe pse blerjet variojnë nga pronat tregtare në Londër, kompanitë e teknologjisë në Gjermani, si prodhuesi i robotëve, "Kuka AG", e deri te prodhuesit skandinavë të makinave si "Volvo", investimet kineze janë përqendruar në disa industri kryesore.

Sipas "Bloomberg", industritë ku përqendrimi është më i dukshëm janë: financat, energjia tradicionale, ndërtimi dhe ushqimi. "Fosun International", mori pjesë në një nga marrëveshjet më të mëdha të privatizimeve në Portugali, duke blerë 80% të njësisë së sigurimeve të bankës së dytë më të madhe në vend, "Caixa Geral de Depositos", në vitin 2014. Në 2013-ën, Korporata Kombëtare e Naftës në Kinë, bleu aksione në vlerën e 4 miliardë dollarëve në njësinë e Afrikës Lindore të gjigantit italian të energjisë, "Eni". Konglomerati kinez, "HNA", që zotëron edhe një pjesë të "Deutsche Bank", pagoi 2.8 miliardë dollarë për ofruesin e shërbimit të mirëmbajtjes së aeroporteve, "Swissport International". Një tjetër blerje që ndan qasjen kineze në kategori, është marrëveshja prej 1.2 miliardë dollarë e "Bright Food Group" në vitin 2012, për kompaninë e drithërave në Britani, "Weetabix".

FIRMAT KRYESORE JANË TË MBËSHTETURA NGA SHTETI

Në total, më shumë se 670 ente kineze kanë investuar në Europë që prej vitit 2008. Prej tyre, më shumë se 100 janë kompani të mbështetura nga shteti, që në mënyrë kolektive kanë ndërmarrë transaksione prej të paktën 162 miliardë dollarë, apo 63% të vlerës totale të këtyre ujdivë. Por, linja mes ndërmarrjeve shtetërore dhe private është më pak transparente në Kinë se sa në Europë. Grupi "Cosco", që po sfidon dominimin e Europës në transportin detar të malrave, përbëhet nga degë të tregtuara në publik të kompanisë shtetërore, "Ocean Shipping Group". Kjo e fundit ka blerë aksione dhe operon në porte nga Bosfori e deri në Detin Baltik.

Tetë nga dhjetë blerësit më të mëdhenj janë kompani të mbështetura nga shteti. Ndër kompanitë shtetërore me prezencën më të madhe në blerjet në Europë janë: Korporata Kombëtare e Kimikateve e Kinës, Korporata e Investimeve e Kinës, Korporata e Aluminit dhe "Avic Capital". Kompanitë kineze kanë shprehur interes në shumë marrëveshje europiane që nuk janë lajmëruar ende në mënyrë zyrtare. Sipas të dhënave të Këshillit Europian mbi Marrëdhëniet e Jashtme (ECRF), këto përfshijnë; ndërtimin e reaktorëve bërthamorë në Rumani dhe Bullgari, blerjen e një terminali të konteinerëve në Kroaci, ndërtimin e një porti në Suedi, marrjen në zotërim të prodhuesit çek të makinave, "Skoda", krijimin e një prodhuesi të naftës dhe gazit në Irlandë, një operator të energjisë elektrike në Gjermani, ofrimin e financimit për një urë në Kroaci si dhe një linjë hekurudhore mes Budapestit dhe Beogradit.

Edhe Paraguai hap ambasadën në Jerusalem

Paraguai hapi dje ambasadën në Jerusalem si vendi i dytë pas Guatemalës, e cila ka ndjekur hapat e SHBA-së dhe vendosi që përfaqësinë diplomatike në Izrael ta zhvendosë nga Tel Avivi në qytetin për të cilin palestinezët pohojnë se duhet të jetë kryeqyteti i tyre. Presidenti i Paraguait Horasio Kartes dhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu morën sot pjesë në hapjen solemne të ambasadës, transmeton Reuters.



Deri në prill, Ramadi, kryeqyteti i provincës Anbar, ishte në rrezik të bjerë në duart e ISIS. Në Bagdad, milicitë Shiite - të njohura zyrtarisht si el-Hashd al-Shaabi, "Njësitë Popullore të Mobilizimit" - po shumëzoheshin me çdo fitore të ISIS. Megjithëse shumë prej milicive kishin lidhje me Iranin, ato u financuan nga qeveria irakiane dhe morën mbështetje nga ajri nga SHBA, gjë që bëri që të ligen keq në luftën kundër ISIS



Nga Anand GOPAL

Falah dhe familja e tij arritën në Hayy al-Xhihad, një lagje e stërbanuar në Bagdadin perëndimor. Shtëpia e tyre e re kishte para një deponi të madhe dhe të hapur, në mes të së cilës, në mënyrë të pashpjegueshme, qëndronte një shesh lojërash. Shtëpia e re e Abu Latifit ishte disa blloqe larg.

Ministria e Brendshme lejoi djalin më të madh të Falahut, Salam, që të rifillonte detyrat e tij të policisë. Për dy javë çdo muaj, ai do të kthehej në Haditha për të ndihmuar në trajnimin e luftëtarëve fisnorë. Ndonjëherë, ai shkoi në linjat e para për të luftuar ISIS. Djemtë e tjerë gjetën punë si punëtorë ditorë. Në ndërrime tetë orësh, ata mbushën fino në muret me kalldrëm në vendet e ndërtimeve rreth qytetit. Pas çdo dite rraskapitëse, 13-vjeçari Basim u ulte para televizorit të shihte filma vizatimorë. Por, atij më shumë i pëlqente të punonte se të shkonte në shkollë. Paguhej 27,000 dinarë irakian në ditë - afërsisht 25 dollarë - dhe përzihet me punëtorë të tjerë të zhvendosur. Ata flisnin për fqinjët që i kishin lënë prapa, ose tregonin thashethemet e vendeve të reja të ndërtimeve me pagë më të mirë. Por ata kurrë nuk i sollën posterët që lartësuan martirët shiitë të vrarë në Irak dhe Siri. "Askush nuk guxonte", më tha Basim. Mendimet e Falahut u kthyen shpesh në fushat e tij të elbit, hurmat e datës që hijëzonin shtëpinë e Abu Ammar, garat e Wissam dhe Salam nëpër ujë dhe gjelbër të Eufratit - një kartografi e humbjes

FEJTON: FERRI PAS ISIS-IT (7)

VRASJA E REFUGJATËVE NGA MILICIA SHIITE



Në Bagdad, Milicitë Shiite të njohura zyrtarisht si el-Hashd al-Shaabi, po shumëzoheshin me çdo fitore të ISIS. Megjithëse shumë prej milicive kishin lidhje me Iranin, ato u financuan nga qeveria irakiane dhe SHBA

që kurrë nuk mund të zëvendësohet nga qyteti i tij i ri. Ai dhe Xhemali shpesh flisnin vonë natën, duke imagjinuar të panjohur që kalonin nëpër shtëpitë e tyre të fëmijërisë.

Për Umm Salamin, mungesa e hapësirës ishte problemi më i madh. "Ishte si një burg," tha ajo. "Ne nuk dinim asgjë. Ne po i ndiqnim vetëm katër muret"... Deri në prill, Ramadi, kryeqyteti i provincës Anbar, ishte në rrezik të bjerë në duart e ISIS. Në Bagdad, milicitë Shiite - të njohura zyrtarisht si el-Hashd al-Shaabi, "Njësitë Popullore të Mobilizimit" - po shumëzoheshin me çdo fitore të ISIS. Megjithëse shumë prej milicive kishin lidhje me Iranin, ato u financuan nga qeveria irakiane dhe morën mbështetje nga ajri nga SHBA, gjë që bëri që të ligen keq në luftën kundër ISIS.

Kur Abu Ammar erdhi për vizitë në fillim të prillit, ai ishte i habitur kur pa lagjen që festoi me flamuj të të gjitha ngjyrave. "E pyeta Falahun," kujton ai, "a është kjo milicia e Kombeve të Bashkuara?". Nuk kaloi shumë kohë kur, në natën e 28

prillit 2015, njeriu në xhinse erdhi në derë dhe u tha të largohen.


Kishte pak për tu paketuar: rroba, shtroja, disa jastëkë të hollë, një frigorifer, një kazan dhe një filtër portativ uji. Umm Salami gjithashtu mbledhi fotografitë e saj, të shpëtuara nga Zweiya. Aty ishte Wissam si 10 ose 12 vjeç, duke luajtur volejbol në një fushë. Një tjetër fotografi tregonte se si familja ishte ulur me këmbë në një batani të bardhë, duke shijuar një piknik nën një kulm të palmave.

Pasi kishin mbledhur gjithçka dhe i kishin lënë në oborr, Hassan, djali i tretë i Falahut, u ngjiti në çati për të fjetur nën qiell të hapur me kushërinë e tij Samir, i cili jetonte me Abu Latifin dhe po kalonte natën. Samiri sapo ishte kthyer nga vizita e Abu Ammar në malet kurde, pushimi i parë i 18 viteve të tij, dhe udhëtimi e kishte lënë atë me një shije për të udhëtuar.

Brenda, Umm Salami nuk u vendos pranë Falahut deri pas orës 3 të mëngjesit. Kur u zgjua dikur më vonë, pa një burrë që qëndronte mbi të. Ajo thirri dhe Falah u zgjua.

Para se të mund të thoshte diçka, njeriu vuri një armë në të dhe e urdhëroi të qëndronte. Fytyra e njeriut ishte e mbuluar, dhe mbante pantallona të maskuar dhe çizme lëkure. Umm Salami bërtiti: "Kush je ti?" Dy figura të tjera u shfaqën teksa lidhnin duart e Falahut pas shpinës së tij. "Askush nuk guxoi të thoshte asgjë", kujton Umm Salami. "Nuk e dinim se çfarë po ndodhte. Ata mbyllën sytë e Falahut me një shtrëngim të verbër dhe i vunë rroba në gojë".

Umm Salami u kthye pas dokumenteve të Falahut dhe mori letrën zyrtare të identitetit, që e kishte marrë nga Policia Federale Irakiane. Ua dorëzoi atë te një prej burrave, që e shikoi atë dhe e hodhi në tokë. "Ju jeni policë, por ju jeni ulur këtu, ndërsa djemtë tanë në Hashd" - lëvizja e milicisë - "po luftojnë në Anbar?" Umm Salami u përpoq t'i tregonte atij se djali i saj më i madh, Salam, ishte në Anbar në atë moment, në luftë kundër ISIS. Por njeriu nuk e dëgjoi dhe ia ktheu armën në kokë. "Ju jeni nga Anbar", tha ai. "Ju jeni ISIS. Ju jeni terroristë".



Policët shiitë i sollën të gjithë burrat e rritur në dhomën e ndenjes dhe i futën gratë dhe fëmijët në korridorin e poshtëm. Ata grabitën nëpër shtëpi, duke marrë para dhe bizhuteri. Nga shkallët, Umm Salami mund të shihte që burrat i rresh-tonin pranë një muri. Burri i saj prapë u ndriçua nga një blic i kameras. Pastaj burrat u nxorën jashtë. Umm Salami provoi të ndiqte situatën përmes perdes në oborr. Ndërsa drita e parë në mëngjes u ngrit në qytet, ajo pa burrat e jetës së saj duke u zhdukur nëpër portën e përpame. Pak para se të mbyllej, ajo pa një shikim të shkurtër të djalit të saj, Wissam, i cili u hodh në një makinë. Pasi ata ishin larguar, ajo arriti të këmisha e saj, ku e kishte fshehur telefonin. "Duart e mia po dridheshin," tha ajo. "E thirra shtëpinë e Abu Latifit për ndihmë".

Kishte dy, ndoshta tre makina, që bartnin Falahun dhe shtatë burrat të tjerë nga familja e tij Sabarvëllai, djemtë dhe nipërit e tij. Ai ndjeu që makina bie rreth një cep, të bëjë një kthesë të dytë të mprehtë, dhe të tërheqë në një ndalesë të papritur. Ata nuk kishin shkuar shumë larg. Para se të mund të thoshte diçka, dera u hap dhe ai u hodh nga prapa. "Dil jashtë! Dil jashtë! Dil!", bërtiti një militant. Zjarri shpërtheu e ai u rrëzua. Ata ishin në oborrin e shkollës dhe militantët po gjuanin mbi to. Ai pa Wissam të zbriste, pastaj Jamal, dhe pastaj Samir. Pastaj gjithçka u errësua.

Në vitin 2015, shtatë anëtarë të familjes Sabar të zgjeruar u vranë nga militantët shiitë. Kjo është historia e asaj që ndodhi atë natë. Kur Falah u zgjua, pa tuba dhe tela dhe dëgjoi zhurmën e makinave. Abu Ammar mori dorën dhe i tha se do të ishte mirë, familja e tij ishte e sigurt tani. Ata u trajtuan nga mjekët, tha ai, dhe ai do t'i shihte ato së shpejti. Por Falahu, i cili nuk mundi të flasë, nuk tundi kokën por ngriti shtatë gishta.

Tre ditë kishin kaluar që nga vrasja, dhe Abu Ammar u ndje sikur ai nuk kishte fjetur aspak. Në mëngjesin e 29 prillit, ai kishte marrë një thirrje telefonike nga Abu Latif. Nxënësit kishin gjetur tetë burra - Falah, Jamal, djemtë e tyre dhe Samir-shtrirë në pishina të gjakut në një shesh lojërash dhe policia kishte sjellë Falahun në spital. Abu Ammar kaloi shtatë orë në Bagdad atë pasdite dhe shkoi direkt në shtëpinë e Falahut. Kur Umm Salami e pa atë, ajo pyeti nëse ai kishte dëgjuar nga Falahu apo djemtë. "Po luftoja", më tha ai. "Nuk e dija si ta thosha". Ai vendosi t'i tregonte se burri dhe djemtë e saj ishin arrestuar dhe së shpejti do të liroheshin. (vijon)

Ky shkrim është shkruar nga Anand Gopal, autor i librit "Asnjë njeri i mirë mes të gjallëve: Amerika, talebanët dhe lufta në sytë afgane". Teksti është botuar në "The Atlantic", i përkthyer dhe përshtatur nga "KDPolitik.com".

PËRFUNDOI SEZONI FUTBOLLISTIK NË LIGËN E PARË

FESTË E MADHE NË TETOVË, SHKUPI DREJT EVROPËS

Vetëm pas rikthimit të Qatip Osmanit në ulësen e trajnerit, ekipi tetovar arriti që ta ripërsëritë suksesin e sezonit 2010/2011, kur për herë të parë në histori të saj, u shpall kampion i Maqedonisë



Shkup, 21 maj – Skuadra e Shkëndijës dhe FC Shkupi, kanë qenë skuadrat të cilat e kanë shënuar javën e fundit të Ligës së parë futbollistike të Maqedonisë. Kuqezinjtë në prani të 15 mijë shikuesve morën trofeun dhe rikthyen atë në Tetovë pas shtatë vitesh pritje. Cekim, titullin e parë kuqezinjtë e fituan në sezonin 2010/11. Ndryshe, këtë sezon të përzgjedhurit e trajnerit Qatip Osmani kanë qenë superior, duke e mbyllur sezonin me 29 ndeshje të fituara, tre humbje dhe katër barazime, ndërsa pas fitores ndaj Pelisterit me 4-0, e kaloi kuotën e 100 golave. Me të përfunduar ndeshja, spektakli filloi si në fushë, poashtu edhe në

tribuna, ndërsa e njëjta më pas vazhdoi në sheshin në Tetovë. Ndërkaq, KF Shkëndija këtë sezon do të na përfaqësojë në garat e Ligës së Kampionëve, ku së shpejti pritet ti mësojë kundërshtarët.

Festë ka pasur edhe në Çair, ku FC Shkupi me fitoren e thellë ndaj rivalit të madh Vardarit prej 4-1, ka hedhur një hap tepër të rëndësishëm drejt pjesëmarrjes në kualifikimet e Liga Evropës.

Bardhekaltërit renditet në vendin e katërt dhe në rast se Shkëndija arrin të fitojë Kupën ndaj Pelisterit, atëherë skuadra shkupjane do të luajë në Ligën e Evropës. Cekim, herën e fundit Shkupi (ish-Sloga J.) ka qenë pjesë e garave evropiane para 14 viteve. Dhe kjo nuk ka mundur të mos shënohet me një festë nga tifozët e saj "Shvercerat", të cilët ishin edhe më të lumtur duke marr parasysh mposhtën ri-

valin e tyre të madh Vardarin.

Në fund, të përmendim edhe atë se Pelisteri dhe "Skopje" janë skuadrat të cilat nuk arritën të mbijetojnë në elitën e futbollit vendor dhe nga sezoni i ri do të jenë pjesë e Ligës së dytë, ndërsa Pobeda do të jetë skuadra e cila qëndrimin e saj në Ligën e parë do ta kërkojë nëpërmjet balotazhit, ku do të pret fituesin e përballjes mes Gostivarit dhe Borecit. (B.K.)

LISTË ME SURPRIZA E RISI PËR DY NDESHJET MIQËSORE

Panuçi lë jashtë Sadikun

Kristian Panuçi ka gati listën e lojtarëve, të cilët do të grumbullojnë për dy miqësoret me Kosovën dhe Ukrainën. Tekniku italian ka vendosur të lërë jashtë Armando Sadikun, ndërsa ka ftuar për herë të parë Sindrit Gurin dhe Egzon Binakun, mbrojtës i majtë i suedezëve të Malmes. Gjithashtu janë rikthyer në skuadër edhe sulmuesit, Armando Vajushi dhe Rej Manaj, që nuk grumbulloheshin prej disa kohësh. Shqipëria do të luajë me Kosovën më 29 maj në Zvicër dhe më 3 qershor me Ukrainën. Lista e plotë e Panuçit: Portë: Berisha, Strakosha, Hoxha; Mbrojtje: Hysaj, Lika, Gjimshiti, Ajeti, Veseli, Mavraj, Binaku, Memolla; Mesfushë: Ramadani, Qaka, Ndoj, Lilaj, Roshi, Lenjani, Vajushi, Gavazaj; Sulm: Abazaj, Manaj, Balaj, Cikallesi, Guri



“Lumë” ofertash për Januzajn

Rikthehen zërat e merkatos për Adnan Januzaj. Pas një sezoni pozitiv me Real Sociedad ku në 34 ndeshje shënoi 4 gola për fantazistin me origjinë shqiptare kanë mbërritur disa oferta nga Italia dhe Anglia dhe është vetë lojtari që e pohon. Januzaj deklaroi se ditët e fundit është kontaktuar nga disa klube të cilat nuk i bëri të ditur por shtoi se nuk do ta kishte problem të qëndronte me ekipin bask për 2-3 sezone të tjera. Sipas Januzaj në një ekip të tillë ai ka mundësi të vazhdojë rritjen si lojtar dhe të zbrësë në fushë rregullisht ndaj dhe qëndrimi duket opsioni më i mirë për momentin.



Berisha, “shqiponja” që po çmend Austrinë drejt një klubi të madh

Kur Valon Berisha shënon dhe fillon të festojë golin, ai hap krahët e tij para gjoksit, sikur në një ekstatë, përhap gishtërinjtë dhe lëviz duart ngadalë e pa problem, ashtu si krahët, lart e poshtë. Gjesti i kujton krahët e një shqiponje. Një shqiponjë, si ajo e zeza me një sfond të kuq, e cila, gjithashtu, zbulon flamurin shqiptar. Prindërit e Valon Berishës janë nga Kosova dhe u arratisën në Skandinavi para lindjes së djalit. “Shtëpi do të thotë familje për mua, – thotë ai. – Në zemër, ajo është gjithmonë afër meje, sepse pa mbështetjen e saj, unë nuk do të isha aty ku jam sot”. Një nga tregimet prapa “mrekullisë së Salzburgut” të mirënjohur është edhe ajo e motorit të mesfushës, Valon Berisha. Është historia e një ish-fëmije refugjat, që nga kushtet modeste, shumë të pasigurta, tani është gati për të pushuar botën shumë të madhe të futbollit. I angazhuar nga klubi norvegjez, Viking Stavanger, gjashtë vite më parë, Berisha, tani 25 vjeç, është zhvilluar në një nga lojtarët më të qëndrueshëm në Bundesligën Austriake, si pjesë e Red



Bull Salzburg. Por, pasi klubi i Mateshitz (pronari i RedBull) marchoi deri në gjysmëfinale të Ligës së Evropës, klubet më të mira, të tillë si Liverpooli, apo të tjerë nga Gjermania dhe Italia, u bënë të vetëdijshëm për lojtarin teknik. Nëse tarifa e transferimit është e lartë, atëherë një ndryshim joshës për lojtarin dhe klubin në merkaton e verës është i sigurt. Berisha është loj-

tari i huaj me më shumë ndeshje në ekipin e Salzburgut, me 167 të tilla. 5 herë kampion radhazi dhe fitues i 4 Kupave të Austrisë radhazi. 2 herë “Lojtari i Viti” në Kosovë. Berisha zbulon edhe një fakt tjetër. Ai nuk do të jetë pjesë e Kosovës në miqësoret e radhës, njëra prej të cilave ndaj Shqipërisë, në tokën zvicerane, sepse është i dëmtuar në kavigje.

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74 të datës 08.05.2015), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 22-1865/2 të datës 23.02.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04-204/1 të datës 18.05.2018 nga U.D Drejtori i IPSH Institutit për shëndet publik – Prilep, publikohet

SHPLLJE PUBLIKE

për punësimin e punëtorëve për kohë të pacaktuar

- IPSH Institutit për shëndet publik – Prilep ka nevojë për punësim të:

1. Doktor të medicinës për kohë të pacaktuar – 2 (dy) realizues

- Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të vërtetuara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore, dhe
 - të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- Përveç kushteve të përgjithshme të vërtetuara me ligj kandidatët duhet ti plotësojnë edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

Për kandidatët në pikën 1.1

 - Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të Fakultetit të medicinës,
 - provim të dhënë profesional,
 - licencë për punë,
 - me ose pa përvojë pune.
- Orari i punës është 40 orë në javë, 8 orë pune në ditë, prej ora 07:30 deri në ora 15:30
- Neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës është 25.960,00 denarë.
- Me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar ti dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
 - biografi të shkurtë (CV)
 - dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, frënge ose gjermane)
 - certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë – diplomë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter).
- Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Institutit për shëndet publik – Prilep, rr. Oktomvriska pn, përmes postës ose në arkivin e IPSH Institutit për shëndet publik – Prilep me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Institutit për shëndet publik – Prilep

Në bazë të neneve 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për sigurim shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pajtuemshëri në punësim nga Ministria e financave numër 18-13179/2 të datës 02909.2016, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02- 337 të datës 21.05.2018 u.d Drejtor i IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar, publikon

SHPLLJE PUBLIKE

për punësim

- IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar ka nevojë për punësim të:
 - doktorë të medicinës për kohë të pacaktuar 5 (pesë) kandidatë për dërgim në specializim në sferat në vijim:
 - Kirurgji e përgjithshme 1 kandidat
 - Anesteziologji dhe reanimacion 2 kandidatë
 - Ortopedi 1 kandidat
 - Pediatri 1 kandidat
 - farmaceut i diplomuar – një kandidat
 - Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për sigurim shëndetësor:
 - të jetë shtetas i RM,
 - të jetë i moshës së rritur,
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
 - të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
 - Krahas kushteve të përgjithshme nga pika 2 të përcaktuara me ligj kandidatët për:
 - Doktor i diplomuar i medicinës duhet të përmbush **kushtet e posaçme** në vijim:
 - arsim sipëror të mbaruar (VII/1) ose 300 kredi sipas SETK pranë Fakultetit të mjekësisë
 - Farmaceuti i diplomuar duhet të përmbush kushtet e posaçme në vijim arsim sipëror të mbaruar (VII/1) ose 300 kredi sipas SETK pranë Fakultetit të farmacisë.
 - Provim të dhënë profesional
 - Licencë për punë
 - Me dhe pa përvojë pune.
 - Orari i punës është 40 orë. Pagesa fillestare e doktorëve të diplomuar të medicinës dhe farmaceutit të diplomuar është 25.969,00 denarë.
 - Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për **Doktor të diplomuar të medicinës dhe Farmaceut të diplomuar** obligohen që të paraqesin dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt dhe gjuhë të zgjedhur ndërkombëtare të cilin do ta japë kandidati (angleze, gjermane ose frënge)
 - Biografi të shkurtë (CV)
 - Diplomë me suksesin mesatar
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës për doktorët e diplomuar të medicinës dhe fakultet të mbaruar të farmacisë për vendin e punës farmaceut i diplomuar, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
 - Afati për paraqitje në shpalljen publike është 7 (shtatë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni jo në kohë, i pakompletuar dhe pa rregulluar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
- Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3 të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 të Ligjit për sigurim shëndetësor.
 - Fletëparaqitja së bashku me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, të parashtrihen deri në IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar rr. Shishka nr. 35 përmes postës ose në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Spitali i përgjithshëm Kavadar

Në bazë të nenit 116 paragrafi 1 alineja 5 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18 dhe nenit 35 paragraf 1 alineja 6 të Statutit të Institucionit publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Aco Karamanov" - Radovish, ndërsa në pajtim me Vendimin nr. 09-34/43 të datës 03.05.2018 për fillim të procedurës për publikim të shpalljes publike dhe realizim të procedurës për zgjedhje të drejtorit në Institucionin publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Aco Karamanov" – Radovish, të sjellë nga kryetari i komunës së Radovishit, Këshilli drejtues i IPKÇF "Aco Karamanov" -Radovish, publikon

SHPLLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPKÇF "Aco Karamanov" -Radovish

Për drejtor të çerdhës publike për fëmijë mund të emërohet, gjegjësisht të zgjidhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj dhe kushteve të përcaktuara në nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve është me arsim sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar) dhe minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit, posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English:Legal) – së paku niveli A2, FCE (Cambridge English:First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë, gjegjësisht APTIS – së paku niveli B2 dhe posedon licencë valide për drejtor të institucionit për fëmijë

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të paraqesin edhe dokumentet në vijim:

- diplomë për arsim të mbaruar:
- certifikatë të shtetësisë:
- certifikatë të mjekut:
- vërtetim për përvojë të punës:
- certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar me vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes ose keqpërdorim të personit të mitur, ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese,
- certifikatë se nuk i është shqiptuar masë për siguri, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës ose sanksion kundërvajtës
- licencë për drejtor të institucionit për fëmijë.

Kandidati për drejtor të institucionit publik për fëmijë obligohet të paraqesin edhe program për punë të çerdhës për fëmijë.

Kushtet për parashtrim të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht ose certifikatës për njohje të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet do të aplikohen prej më 1 shtator 2018.

Kandidati i cili do të zgjidhet për drejtor obligohet të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej 1 viti duke konsideruar nga data 01.09.2018.

Drejtori zgjidhet gjegjësisht emërohet për periudhë prej 4 vjet.

Shpallja zgjatet tetë ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet nga ana e kryetarit të komunës në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit nga Këshilli drejtues.

Dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri te Këshilli drejtues i IPKÇF "Aco Karamanov" - Radovish, rr. "Aco Karamanov" nr. 54, me shenjë "për shpallje publike për zgjedhje të drejtorit".

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Këshilli drejtues,
Kryetar,
M. Janeva

Në bazë të nenit 166, 176, 217 paragrafi 2 dhe 227 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018); nenit 9, 10 dhe 13 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/2013 – tekst i pastruar) dhe nenit 46 të Rregullores për organizimin e brendshëm dhe punën e Fakultetit Pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, dekani i Fakultetit pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje të një mësimitshëni në të gjitha titujt mësimit-shkencor

- Publikohet konkurs për zgjedhje të një mësimitshëni në të gjitha titujt mësimit-shkencor, nga sferat:

1.1. Metodika e artit figurativ, për lëndët:

- Bazat e artit figurativ dhe Arti figurativ me metodikë (lëndë e domosdoshme për grupin studimor Edukimi parashkollor për mësimit në gjuhën maqedonase) dhe
- Bazat e artit figurativ dhe Arti figurativ me metodikë (lëndë e domosdoshme për grupin studimor Mësim klasor për mësimit në gjuhën maqedonase);

1.2. Teatrogji për lëndët:

- Kukullat dhe skenografia (lëndë zgjedhore për grupin studimor Edukimi parashkollor dhe Mësim klasor për mësimit në gjuhën maqedonase);

1.3. Pikturim dhe vizatim, për lëndët:

- Teknikat e pikturimit dhe vizatimit të artit figurativ (lëndë zgjedhore për grupet studimore Mësim klasor dhe Edukimi parashkollor, për mësimit në gjuhën maqedonase) dhe

1.4. Krijim për lëndët:

- Punëtori kreative e artit figurativ (lëndë zgjedhore për grupet studimore Mësim klasor dhe Edukimi parashkollor, për mësimit në gjuhën maqedonase).

2. Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme nga Ligji për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/2018), si dhe kushtet në pajtim me kriteret ekzistuese të dhëna në Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/2013 – tekst i pastruar).

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të paraqesin:

- fletëparaqitje;
- biografi të shkurtë, me fotokopje të vendimit për zgjedhje në titull nëse kanë zgjedhje të mëhershme në titull;
- diplomë për shkallën e arritur shkencore doktor shkencë nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet;
- formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues, që mund të merret në arkivin e Fakultetit;
- Deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe listë të punimeve të publikuara të recensuara shkencore në publikime shkencore referente, në 5 vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje dhe
- certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve parashtrihen të rekomanduara përmes postës ose në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor..

Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune për kohën që do të zgjidhet.

Dekan
Prof. d-r Emil Sulejmani

Guardiola nuk ka ndërmend të bëjë përforsime me shumicë këtë verë, ndaj u ka thënë bosëve të klubit se dëshiron dy lojtarë të klasit botëror. Hazard është një prej tyre, me Guardiolen duke e parë atë si zëvendësim afatgjatë për David Silva

Trajneri i Manchester Sittit, Pep Guardiola, e ka bërë Eden Hazard përparësinë e tij absolute në merkaton e kësaj vere, thotë "Daily Star". Pavarësisht fitores së titullit të Premier Ligës në sezonin 2017-2018, trajneri është i gatshëm të përforsojë sulmin e tij me yllin e Çellsit. Por, Hazard nuk do të jetë i

GUARDIOLA PËRGGATIT OFERTËN E ÇMENDUR PËR HAZARDIN



libër, por kushton 100 milionë euro dhe pagë javore 300.000 euro, çka duhet për të hyrë në negociata me "Blues" dhe vetë belgun sferimeve në Premier Ligë. Hazard ka edhe dy vite të mbetura në kontratën e tij me Çellsin dhe ka qenë

i lidhur ngushtë me një lëvizje drejt Real Madridit, por edhe Paris Sen Zhermen është në gjueti për të. Por, ish-trajneri i Barcelonës, Guardiola, dëshiron t'i mundë rivalët e tij të vjetër në këtë rast, duke e kthyer Hazardin në kryetransferimin e verës. Belgu ishte në formë mahnitëse për të ndihmuar ekipin e tij, që të mundë Manchester Junajtedin në "Embley", të shtunën, për të fituar "FA Cup". Ai shënoi golin e fitores me një penalti. Por, 27 vjeçari ka refuzuar të zotohet për të ardhmen e tij afatgjatë të "Blues", pas një sezoni kryesisht frustrues në "Stamford Bridge". Vetë ai është në dijeni të interesit të fortë të Pep Guardiols. Guardiola nuk ka ndërmend të bëjë përforsime me shumicë këtë verë, ndaj u ka thënë bosëve të klubit se dëshiron dy lojtarë të klasit botëror. Hazard është një prej tyre, me Guardiolen duke e parë atë si zëvendësim afatgjatë për David Silva.

Publicitet

REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti për elektroteknikë dhe teknologji informatike

Në bazë të nenit 172 dhe 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2008, 103/2018) dhe vendimeve 02-1005/7, 02-1005/9, 02-1005/10 dhe 02-1005/11 të këshillit mësimor-shkencor të NNS të datës 16.05.2018, si dhe nenit 51 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe punën e Fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, dekani i Fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike ka sjellë vendim për publikim

KONKURS
Për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore:

Publikohet konkurs për zgjedhje të gjitha titujt mësimor – shkencor për lëndët në sferën mësimore – shkencore:

1. **20409 – matjet dhe instrumentet dhe 21300 metrologjia,**
2. **10900-matematika**
3. **20206-elektromagnetika**
4. **20300-rrjetet dhe sistemet elektroenergetike.**

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Së bashku me kandidatët duhet të paraqesin: dokumente për arsim të mbaruar, biografi të shkurtë, formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, Deklaratë për përbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme nga vendi i punës, listë për punimet profesionale dhe shkencore, nga një kopje të punimeve, vërtetim për njohje të gjuhës së huaj dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës është në pajtim me orarin e orëve në semestër, ndërsa pagesa bazë varet nga angazhimi mësimor në semestër. Mësimdhënësit e zgjedhur themelojnë marrëdhënie pune për kohën që kanë zgjedhur.

Fletëparaqitjet me dokumentet e kompletuara paraqiten përmes arkivit të Fakultetit, ose përmes postës në adresën rr. Rugjer Boshkoviq 18 – Shkup.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Nga FETI

ОУ ЈОСИП БРОЗ ТИТО

С. Жирновци - Мавровци - Ростуш

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 pika 7, 8 dhe 9, 128 paragrafi 3 dhe nenit 132 paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18), nenit 75 paragrafi 1 pika 8, nenit 77 dhe 80 të Statutit të, Këshilli i shkollës së Shkollës fillore "Josip Broz Tito" në fshatin Zhironicë, komuna Mavrovë dhe Rostushë, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

Kushtet:
Për drejtor të shkollës fillore mund të zgjidhet personi Shtetas i Republikës së Maqedonisë i cili ka së paku arsim sipëror dhe i cili përbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore dhe nëse ka së paku pesë vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore, provim të dhënë për drejtor, në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen dhe dokumentacion të kompletuar, duhet të paraqesin edhe program për punë për periudhë prej katër vjet.

Shpallja zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes në mjetet e informimit.

Lutjet me të gjitha dokumentet të paraqitura në adresën:
Shkolla fillore "Josip Broz Tito" 1255 fshati Zhironicë
Dokumentet e pakompletuara dhe të paraqitura pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHF "Josip Broz Tito" f. Zhironicë
Këshilli i shkollës – Kryetar,
Anife Elezoska

URGJENTISHT
Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 – Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 pika 7, nenit 128 pika 3 dhe nenit 132 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 56/12, 100/12, 24/13, 14/14, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), nenit 8 të LMP, ndërsa në lidhje me Vendimin e Kryetarit të komunës së Karbincit numër 09-678/1 të datës 21.05.2018, Këshilli i shkollës së SHFK "Strasho Pinxhur" – Karbinci më datë 21.05.2018 publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHFK "Strasho Pinxhur" – KARBINCI

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme në vijim, në pajtim me Ligjin për arsim fillor:

1. Të kenë të mbaruar arsimin sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar);
2. Të përbushin kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore.
3. Të kenë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore;
4. Të kenë të dhënë provim të dhënë për drejtor në shkollë fillore;
5. Në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
6. Të jenë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
7. Kandidatët në pajtim me nenin 128, paragrafi 6 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 24/13, 14/14, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), të mos jenë të emëruar në funksionin drejtor i shkollës "Strasho Pinxhur" Karbincë, në dy mandate.
8. Të kenë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet.

Kandidatët duhet të paraqesin dokumentet në vijim në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter:

1. Fletëparaqitje;
2. Diplomë për arsim sipëror të mbaruar;
3. Vërtetim për përvojë të punës prej së paku 5 (pesë) vjet në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;
4. Certifikatë për provim të dhënë për drejtor në shkollë fillore;
5. Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
6. Program për punë për periudhë prej 4 (katër) vjet;
7. Vërtetim se nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes.
8. Dokument për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet.
9. Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore

Orari i punës është 40 orë në javë në një ndërrim prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 07:30 – 15:30. Mandati i drejtorit është me kohëzgjatje prej 4 vjet.

Për punën e realizuar do të pranohet pagë fillestare në shumë prej 28.266,00 denarë.

Shpallja publike zgjatë 8 (tetë) ditë pune dhe fillon të rrjedhë nga dita e ardhshme e ditës së publikimit.

Afati në të cilin do të realizohet zgjedhja është 30 ditë nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në pajtim me dispozitat nga nenit 128 dhe nenit 132 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 14/14, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17).

Anëtarët e Këshillit të shkollës dhe përfaqësuesit i Byrosë për zhvillim të arsimit kryen intervistë me kandidatët të cilët i përbushin kushtet për drejtor.

Dokumentet e nevojshme të paraqiten deri në Këshillin e shkollës së SHFK "Strasho Pinxhur" Karbinci, 2207 Karbinci ose në arkivin e shkollës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Këshilli i shkollës së SHFK "Strasho Pinxhur" Karbinci
Kryetar
Viktorija Andova Gollubova

Në bazë të nenit 33 të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 46/08; 103/08; 24/11; 80/12; 24/13; 147/13; 41/14; 25/15; 154/15; 30/16), nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015), nenit 30 të Statutit të IPSH Institutit për kulturë të vjetër sllave – Prilep dhe Vendimit të Këshillit të Institutit nr. 02-172/4 të datës 21.05.2018, publikohet

KONKURS PUBLIK
Për zgjedhje të DREJTORIT të Institutit

Kandidatët e paraqitur duhet të plotësojnë kushtet të përcaktuara në nenin 33 të Ligjit për veprimtari shkencore-hulumtuese dhe nenit 30 të Statutit të Institutit, gjegjësisht:

- të kenë **titull shkencor gjegjësisht mësimor-shkencor;**
- të jenë **punëtorë të theksuar shkencor nga fusha e veprimtarisë së Institutit;**
- të **posedojnë aftësi për organizim;**

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët janë të obliguar që të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- **Diplomë (Certifikatë) për doktorë të shkencave nga fusha e veprimtarisë së Institutit;**
- **Vendim për zgjedhje në titull shkencor gjegjësisht mësimor-shkencor nga fusha e veprimtarisë së Institutit;**
- **Biografi me Bibliografi** për punimet e publikuara ose të recensuara;
- **Program** për punën e Institutit në periudhën mandatare.

Konkursi do të zgjatë 10 ditë pune nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e kërkuara të dorëzohen në adresën e Institutit "Kičevsko xhade" pn Fahu postal 162 Prilep me shenjë "për konkurs publik" ose personalisht në arkivin e Institutit.

UD. DREJTOR
D-r Branislav Risteski

SHFK "Metodi Mitevski – Brico" – Llozovë në pajtim me nenin 22 dhe nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 (teksti i pastruar)) dhe Ligjit për të punësuarit në sektorin publik nenin 20-g dhe 20-d (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16), publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për praninë të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

- 1 mjeshtër – menaxhues të kazanëve për ngrohje në SHP "M.M Brico" f. Llozovë

Kandidatët duhet të përbushin kushtet nga nenit 9 i Rregullores për organizim dhe sistematizim të punëve dhe detyrave të punës së punëtorëve në SH.F "M.M. – Brico" dhe të paraqesin dokumentet në vijim:

1. Dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuara në noter);
2. Certifikatë të shtetësisë;
3. Certifikatë se nuk është i dënuar;
4. Certifikatë të mjekut, pas pranimit të kandidatit;
5. Licencë si menaxhues të kazanëve për ngrohje.

Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhjen do ta realizojë Drejtori në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

SH.F "M.M. – Brico"
Llozovë

Interi fiton 2-3 ndaj Lacios në sfidën e fundit dhe më të rëndësishme të sezonit dhe fiton të drejtën për të luajtur në "Champions" sezonin e ardhshëm. Zhgënjim total në radhët e Lacios, pasi futbollistët bardhelkatër nuk mundën të kurorëzonin me pjesëmarrjen në "Champions" një sezon ku janë shfaqur gjithmonë protagonistë

Interi tregohet edhe njëherë i çmendur duke përmbysur gjithçka në 15' minutat e fundit të ndeshjes ndaj Lacios dhe arrin të triumfojë 3-2 në "Stadio Olimpico". Ishte një ndeshje plot emocione në kryeqytet, dhe kur dukej sikur Lacio e kishin siguruar kualifikimin në "Champions League". Interi merr hak nga jo disfatë e vitit 2002, kur Lacio i hoqi titullin. Mauro Icardi ka thënë se kualifikimi i Interit në Ligën e Kampionëve ishte i merituar, teksa ka folur edhe për të ardhmen e tij, duke shtuar se do të shohin se çfarë është më e mira për klubin. "Lacio luajti mirë, por kemi treguar forcë dhe dëshirë për ta kthyer rezultatin. Ne e bëmë atë", ka thënë fillimisht Icardi për "Mediaset Premium" pas ndeshjes. "Ky ishte qëllimi jonë. Arritja në fund. Ekipi ishte në gjendje të mirë, loja nuk po shkonte në rrugën e duhur, por ne tre-

ZIKALTRIT HAKMERREN PËR 5 MAJIN DHE SHKOJNË NË ÇAMPIONS

IKARDI: KUALIFIKIM I MERITUAR NË LIGËN E KAMPIONËVE



Mauro Icardi

Tani do të flas me klubin, ku mund të gjejmë zgjidhjen më të mirë dhe të vendosim së bashku. Dëshira ime është të qëndroj te Interi. Unë jam tifoz i Interit

guam forcë për ta rikthyer atë në rrugë të mbarë. "Ja kushtoj këtë shokëve të mi, sepse ne të gjithë kemi besuar në objektivin tonë, nga lojtarët tek stafi e kit dhe gjithë punëtorët në klub. Ky është një shpërblim për të gjithë ne dhe punën tonë të madhe, sepse e merituar. "Ne do të flasim me klubin

dhe do të bëjmë atë që është më e mira për Interin. Qëllimi ishte Liga e Kampionëve, atë e arritëm dhe do të shkojmë atje", deklaroi Icardi. Në anën tjetër Simone Inzaghi, trajneri i Lacios nuk e fsheh zhgënjimin për humbjen në javën e fundit të kampionatit ndaj Interit, që i kushtoi pjesëmarrjen në "Champions"

Lacios. Tekniku bardhekaltër gjithsesi theksoi se ka mbetur shumë i kënaqur për atë që ka dhënë skuadra në tërësi gjatë sezonit, duke duartrokitur të tijtë. "Mëkat që nuk do të jemi në 'Champions', pasi kemi zhvilluar një sezon fantastik. Kemi qenë një nga skuadrat më argëtuese në fushën e lojës dhe për

këtë duhet të duartrokas të gjithë lojtarët e mi, për përkushtimin dhe vullnetin e treguar në fushën e lojës", tha Inzaghi. Trajneri i Lacios pranon se "Championsi" nuk u humb vetëm në ndeshjen ndaj Interit, ndërsa nuk ka asnjë polemikë me gjykimin e arbitrit Roki. "Në fakt ndaj Interit bëmë një ndeshje mjaft të mirë dhe nuk mbaj mend ndonjë pritje të vështirë të Strakoshës, por mendoj se duhet ta kishim siguruar më herët pjesëmarrjen dhe të mos linim gjithçka për këtë ndeshje të fundit. Nuk kam ç'të komentoj për arbitrimin, pasi ne i patëm rastet tona dhe mund ta kishim mbyllur ndeshjen më herët, por episodet nuk i patëm në favor", deklaroi trajneri i bardhekaltërve.

LAMTUMIRA EMOCIONALE E INIESTAS



Erdha fëmijë, po largohem si burrë

Një lamtumirë emocionale e Andres Iniesta nga Barcelona u përplas me lot, ndërsa mbajti një fjalim në "Camp Nou", pasi luajti ndeshjen e tij të fundit me skuadrën katalanase. Kampionët e La Ligas dhe 4 herë fituesi i Ligës së Kampionëve, Iniesta, iu drejtua tifozëve. "Sot është një ditë e vështirë, por kanë qenë 22 vite të mrekullueshme. Është krenari dhe kënaqësi për të mbrojtur dhe për të përfaqësuar këtë fanellë-simbol për mua, të skuadrës më të mirë në botë, - tha Iniesta, i cili

u largua nga fusha nën duartrokitjet e zjarrta, pasi i dha dorën e kapitenit Lionel Messit. Pas ndeshjes dhe momenteve tejet emocionale, 9 herë kampioni i La Ligas dhe 4 herë fituesi i Ligës së Kampionëve, Iniesta, iu drejtua tifozëve. "Sot është një ditë e vështirë, por kanë qenë 22 vite të mrekullueshme. Është krenari dhe kënaqësi për të mbrojtur dhe për të përfaqësuar këtë fanellë-simbol për mua, të skuadrës më të mirë në botë, - tha Iniesta, i cili

bëri debutimin e tij me ekipin e parë katalanas në vitin 2002. - Ju faleminderit tifozëve, për gjithë dashurinë e tyre, për gjithçka që më keni bërë të ndihem, sepse kam ardhur këtu si fëmijë dhe po largohem si burrë. Jam i kënaqur me të gjithë shokët e skuadrës sime, do t'ju mbaj në zemrën time përgjithmonë. Për të përfunduar, këtë javë më keni lënë pa fjalë. Rroftë Barça, rroftë Katalonja, rroftë Fuentebilla (qyteti i tij lindjes)", tha Iniesta.

Bedoja, futbollisti më i "pisët" i planetit

Gerardo Bedoja është një emër që pjesa më e madhe të tifozëve të futbollit në Evropë nuk e ka idenë kush është, por gjyqtarët në Amerikën e Jugut e njohin thuasht të gjithë. Bedoja ka luajtur plot 49 ndeshje me kombëtaren e Kolumbisë dhe luajti një rol thelbësor në Kupën e Amerikës 2001, e vetmja veprimtari madhore e fituar nga ky vend. Por jashtë Kolumbisë do të mbahet mend për një gjë të vetme: kartonët e kuq. 47 të tillë gjatë karrierës për të qenë më të saktë. Kjo e bën zyrtarisht lojtarin më të pisët në historinë e futbollit. Gjatë karrierës së tij 20-vjeçare, nga viti 1995 deri në vitin 2015, ku ka luajtur me 12 klube të ndryshme në Kolumbi, Argentinë dhe Meksikë,

Bedoja u nxor nga fusha 45 herë, ndërsa dy përjashtime të tjera i ka marrë tani që është bërë zëvendës trajner. Kartoni i kuq numër 46 i erdhi në minutën e 25-të të ndeshjes së luajtur nga Independiente Santa Fe, kur për dhjetë minuta me radhë ofendoj gjyqtarët e ndeshjes, derisa këta të fundit e detyruan ta çojnë në tribunë. Javën e kaluar, Bedoja u nxeh tmerrsisht në derbin ndaj Millionarios dhe ja tek erdhi përjashtimi i 47-të, i tmerrshëm, jo më kot në Kolumbi e thërrasin "bisha". Ata që nuk do ta harrojnë kurrë mesfushorin e dhunshëm janë tifozët e Deportivo Cali, ku luajti 138 ndeshje dhe mori 14 kartonë të kuq, mesatarisht një i kuq çdo 10 aktivizime.





DASHI 21. mars - 20. prill

E hëna do të nisë e qetë. Sa i përket dashurisë pritet një ditë e vështirë për përmirësimin e një marrëdhënieje e cila po kalon vështirësi. Mirë është të organizoni një mbrëmje të qetë, të dilni për pak qetësi shpirtërore. Edhe miqtë tuaj janë të shqetësuar. Këshilla është të qetësoheni. Në marrëdhëniet në punë ju duhet pak takt për raportet me kolegët. Tregohuni diplomatë në punë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Ditën e hënë ju do ndiheni energjik dhe duket sikur kërkon "të fluturoni". Në dashuri duhet të hiqni dorë nga tronditjet e zemrës, ky është sugjerimi i jveve për juve. Nuk duhet të frikësoheni për të ardhmen, çështjet e zemrës do të zgjidhen. Ndërkohë sa i përket punës, nuk do të keni asnjë ndërlikim. Gjithçka do shkojë mirë.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Mund të themi se kjo do jetë shenja e ditës. Një ditë spektakolare për të lindurit me këtë shenjë, me diellin në favor. Në dashuri kjo shihet si një ditë mjaft e mirë ndaj duhet ta shijoni. Nëse jeni beqarë, kjo është dita që duhet shfrytëzuar për të lënë takime. Në punë do keni më shumë kënaqësi se sa e prisnit. Çdo problem ju do ta zgjidhni me qetësi dhe inteligjencë.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kjo e hënë do jetë një ditë e shkëlqyer për juve. Pritet një ditë mjaft e bukur për ata që janë në një lidhje ndaj gëzojeni këtë ditë. Për beqarët, ajo që mund të themi është se "një botë e tërë" ju pret. Hidhuni në sulm. Nëse nuk keni asnjë "kandidate" apo "kandidat", organizoni në mbrëmje me miqtë, mund të jetë mundësi për njohje të reja.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Ditë perfekte për fillimin e javës. Në dashuri çdo gjë do të vijojë pozitivisht për personat e kësaj shenje. Ju do të dini se si të krijoni situata romantike për marrëdhënien në çift. Për beqarët do ketë një "shteg" për të gjetur njeriun e zemrës. Në punë do merrni kënaqësi të vogla që do ju bëjnë më dinamikë.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Një ditë mjaftueshëm e këndshme për juve. Duhet të përfitoni nga ato pak shanse, por të mira që ju ofrohen për punët e zemrës. Në fund dita do jetë pozitive, veçanërisht pasditja. Ju do të kaloni një ditë të lumtur pranë të afërmeve. Në punë do të keni disa fjalosje me kolegët, por mos u shqetësoni, do jetë diçka kalimtare. Nuk duhet të nervozoheni.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

E hëna do të sjellë disa probleme për të lindurit e kësaj shenje. Në dashuri duhet të jeni të kujdesshëm, xhelozia e tepruar mund të sjellë disa probleme për ata që janë në lidhje. Për beqarët nuk pritet një ditë e mirë. Do të kaloni një ditë delikate dhe ndiheni të lodhur. Në punë këshillohet që ju të dini se si t'i përshtateni situatave të reja.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo ditë do të nisë pozitivisht për juve, e në fund të ditës do ndjeni kënaqësi të mëdha. Sa i takon dashurisë, yjet do ju ndihmojnë për të gjetur ekuilibrin e brendshëm. Pritet të jetë ditë e ekuilibrit të rinj për të lindurit e kësaj shenje. Merrni më seriozisht mirëqenien fizike tuajën. Në punë kjo do jetë një ditë e mirë dhe me mundësi për marrëveshje të reja.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Kjo ditë do të jetë mjaft pozitive për juve. Kujdes nga provokimet negative, mos u ndikoni aspak. Yjet i keni në mbështetje sa i takon dashurisë në këtë fillim javë. Ju do të jeni të zhytur në mendime që mund t'ju krijojnë vështirësi në familje. Në punë jeni në një moment delikat. Do të jeni përballë situatave që kërkojnë strategji dhe aftësi të mira për tu tejkaluar.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Një ditë jo e këndshme për personat e kësaj shenje. Yjet nuk janë favorizues për personat e kësaj shenje këtë ditë në dashuri. Disa pengesa do ju duken të pakalueshme. Por para se të bini në panik, ajo që duhet të bëni është të relaksoheni. Largoni mendimet tuaja nga problemet dhe do shikoni që gjithçka zgjidhet. Në punë ju mund të ndiheni i rrezikuar. Mbani moralin lartë.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo mund të cilësohet një ditë e pashembullt në fushën sentimentale. Sigurisht për mirë. Në mbrëmje do të kaloni një atmosferë shumë romantike, si në përralla. Ju do të merrni emocione të reja në dashuri. Në punë sigurohuni që të jepni më të mirën tuaj. Duhet të zbatoni me përpikmëri detyrat tuaja.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Java do të nisë mjaft mirë për të lindurit e kësaj shenje. Kjo ditë është mjaft e favorshme për ata që kanë plane për jetën në çift ndaj mos hezitoni. Kjo ditë do jetë e këndshme dhe intensive për të dashuruarit. Në punë do të keni disa oferta mjaft të mira në pozicione të rëndësishme. Ju do të jeni mjaft i kthjellët për të bërë zgjedhjen e duhur.

shummë i lehtë

1	4								
	6					9			7
			5	7	3				4
		9	8	5		6			
		1	9		6	3			
		4		3	1	2			
9			3	8	4				
7		6						3	8
									2

SOT PO MBUSHEN GJASHTË MUAJ NGA NDARJA NGA BABAI, BASHKËSHORTI, KOLEGU DHE MIKU JONË



REXHEP LAMA
(22 MAJ 1947 – 22 NËNTOR 2017)

Me zemër të thyer, por njëkohësisht krenar që të patëm, e përkujtojnë me mall këtë ditë familja, kolegët e shkollës fillore periferike "Kirili dhe Metodi" në Straçincë dhe miqtë e tij I përjetshëm qoftë kujtimi për Ty

Mensur Mamuti	FILM I ANIMUAR I ULIAM SHTAJGUT	POSEDON (VETA 2 NJ.)	ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ, MAJKELL	ENË BALTE	AUSTRIA	KOHA	ATLASI I PARË NË FOTO, "TEATRI I BOTËS" (LATINISHT)	PËRMBLEDHJA E 70 HARTAVE, E BOTUAR PËR HERË TË PARË NË V. 1570 (SHIH FOTON)	ISH POLITIKANI TURK DENKTASH	MENDJEHOLLËSI, SHKATHËTESI
GRISA						THARTIRË, MAJË CIENCE FICTION ENCYCLOPEDY				
SHFAQJE ESTRADË PARADË					KONFIGURIM I PROGRAMEVE KOMPJUTERISTIKE LLOJ DRURI					
ENERGJIA		QË NUK ËSHTË FALE OKSIGJENI								
TRUP GJEOMETRIK				KLUB SPANJOLL						
						REPUBLIKA SOCIALISTE EROI I DIKENSIT, OLIVER			HIDROJENI QENI I UOLLIT DIZNIT	
						T				
						ARMË SHPËRTHYESE				
						TËRËSIA E VEPRAVE TË NJË AUTORIT AUTORI YNË, FATOS				
						A				
						PJESË KOCKORE NË KOKËT E DISA KAFSHËVE				KANTON NË ZVICËR
						I.Ë. FUTBOLLISTI MALAZËZ, DROBNUAK			AUSTRIA QË ËSHTË I NJESUAR, UNIK	
KOHA	SHKRUI NË UJË	JEVGE, EVGJITE	ANGSTREMI	MOLIBDENI	ASTATI BALENA, VRASESE			QYTET-SHTET I LASHTË NË MESOPOTAMI LLOJ ECJEJE KALI		
TREGIM I GABRIEL GARSIA MARKEZIT										
SHKRONJË GREKE			KRIJUESI I ATLASIT TË PARË, ABRAHAM ARI							
KËNGËTARIA SHOËPTARE, QAZIMI				MUAJ VITI TEMPERATURA						1000 ROMAK
MBRETËRËSHA ILIRE						AFARISTI AMERIKAN, THEMELUES I "TOP RANK", BOB				

ZGJIDHJET: SHKOQA, THARM, REVY, SET AP, E, E PAFALUR, KON, HETAFE, RS, H, TUIST, MINË, OPUS, ARAPË, BRI, IË, A, AS, UR, TRAMONTANA, RO, ORTELIU, EMA, KORRIK, TEUTA, ARUM.

Kafshët shtëpiake reduktojnë rrezikun e sëmundjeve mendore



Njerëzit që rriten në qytete pa kafshë shtëpiake kanë një rrezik më të lartë për sëmundje mendore dhe stres

kronik, ka gjetur një studim i ri. Një gjendje e tillë lidhet me bakteret: fëmijët e rritur në fshat me kafshë

janë të ekspozuar ndaj pluhurit më të ngarkuar me baktere që përforcojnë sistemet e tyre imune dhe i bëjnë ato të qëndrueshme ndaj stresit.

Studiuesit në Universitetin e Kolorados Boulder thonë se gjetjet e tyre janë akoma më shumë dëshmi se fëmijët duhet të shpenzojnë më shumë kohë duke luajtur në natyrë, meqë mjediset tepër sterile rrisin ironi çështjet shëndetësore.

Autorët thonë se nevojiten më shumë kërkime, por mund të thonë me siguri se banorët e qytetit do të përfitonin mentalisht nga të ngrënit më shumë probiotikë, duke shpenzuar më shumë kohë jashtë, duke marrë kafshë shtëpiake.



"Plaken" burgjet e Zvicrës

Burgu i Schaffhausenit është i vogël dhe i vjetër, të burgosurit mund të arratisen shumë lehtë. Për fat të keq nuk është rast i vetëm, pasi shumica e burgjeve rajonale e të qarkut janë në gjendje të ngjashme. Benjamin Brägger, ekspert i çështjeve ndëshkuese, për SRF ka pohuar se në Zvicrën Perëndimore kemi shumë burgje të vjetra kantonale. Por edhe të gjithë burgjet që janë përgjegjës për Zvicrën Perëndimore, janë vjetruar. "Në Zvicrën gjermanofolëse kemi probleme të shumta me burgjet rajonale e të qarkut. Ata janë zakonisht më të vjetër se 100 vite dhe shumë pak investohet në ta. Në burgjet e mëdhenj, Qeveria zvicerane merr pjesë me 35 për qind në riparimin dhe rindërtimin e tyre. Rasti i tillë nuk është edhe me burgjet më të vegjël. Kjo është arsyeja që kantonet kanë probleme për ta përshtatur infrastrukturën", ka përfunduar eksperti zviceran. Të përkujtojmë se para dy ditësh, nga një burg i Gjenezës u arratisën tre persona, pasi alarmi nuk ishte vënë në funksion.

Policia indiane largon 106 kapsula të kokainës nga stomaku i një gruaje


Policia indiane ka thënë se ka larguar me sukses nga stomaku i një gruaje 106 kapsula të kokainës, e cila dyshohej se ishte duke tentuar të kontrabandojë drogë në këtë shtet.

Gruaja 25 vjeçare me shtetësi të huaj është arrestuar në Aeroportin Ndërkombëtar në Delhi më 14 maj, ka njoftuar policia. Ajo është raportuar të ketë kaluar javën e kaluar në një spital duke u trajtuar si pasojë e kokainës. Droga është

thënë se ka vlerën e 50 milionë rupeve, apo 734,160 dollarëve. Policia ka thënë se beson që gruaia ka përlytur kapsulat në Brazil dhe po aty i janë dhënë udhëzimet për të dërguar drogën në Delhi.

Zyrtarë nga Departamenti i Narkotikëve, i kanë thënë gazetës, Hindustan Times se ky ka qenë "numri më i madh i kapsulave të kokainës" që kanë gjetur ndonjëherë në një person.

I zhveshin në brekë që të mos kopjojnë



Në Bihar të Indisë, kandidatët për ushtarë janë detyruar të zhvishen vetëm në brekë, që të mos kenë prej nga të kopjojnë teksa përfundojnë testin me shkrim. Në fotografimin e botuar në Indian Express, shihen dhjetëra meshkuj këmbëkryq, teksa plotësojnë testet të mbikëqyrur nga ushtarët në uniformë. Kjo formë e pazakontë e nënshtimit të testimit është arsyetuar nga autoritete ushtarake si "parandalimi më i mirë nga kopjimet". "Me rastet e shpeshta të kopjimit përmes letrave dhe pajisjeve të mençura, e kemi zgjedhur këtë formë që të zbulojmë dijen e secilit", thuhet në deklaratën e ushtresë.

334 BC - Ushtria e Aleksandrit të Madh të Maqedonisë mund Darin e III të Persisë në Betejën e Granikut.

1176 - Tentim vrasje ndaj Salahudinit nga ana e "Assasinëve" afër Apelos.

1570 - Publikohet Atlasi i parë me 70 harta.

1746 - Rusia dhe Austria nënshkruajnë Traktat të bashkëpunimit.

1906 - Mbyllet përvjetori i 10 i Lojërave Olimpikë në Athinë të Greqisë.

1941 - Trupat britanike sulmojnë Bagdadin.

1942 - Meksikojë i shpall luftë Gjermanisë dhe Japonisë.

1959 - Benjamin O Davis Jr bëhet zezaku i parë gjeneral-major në Forcat Ajrore Amerikane.

1990 - Microsoft lëshon në përdorim Windows 3.0.



Don Gorske, i cili thotë se presioni i tij i gjakut dhe kolesteroli janë normale, ka ngrënë pothuajse dy hamburgerë në ditë që nga viti 1972. Një burrë i cili thotë se ka ngrënë tashmë 30.000 hamburgerë nga McDonald's. "Kjo është një gjë e madhe për mua," tha nëpunësi i burgut në pension, Don Gorske, ndërsa arriti kulminacionin e kuzhinës në Fond du Lac, Wisconsin. Sipas raportuesit Fond du Lac, 64-vjeçari dha një "prezantim gjysmë ore" për një turmë që u mbledh për ta parë atë të konsumonte hamburger.

PORDHA

Në një banjo publike hyn një çun i ri dhe një plak. Duke bërë nevojat e tyre, xhaja i fut një alamet pordhe saqë çuni i ri fillon të qesh dhe i thotë:
- E xhaje pordhe.
Dhe xhaja i përgjigjet:
- Pse more çun, çfarë do me dëgju këtu, Vaçe Zelen?



Të gjithë ëndrrat e tua mund të bëhen realitet, nëse ke kurajën t'i ndjekësh.
(Walt Disney)



KALENDARI HISTORIK 22 MAJ



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS